RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

Auditim Financiar

Tiranë, shtator 2026

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AK	Autoritet Kontraktor
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
AZHT	Agjencia e Zhvillimit të Territorit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
PF	Pasqyrat Financiare
PMNZSH	Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtim
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
USH	Urdhër Shpenzimi
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 4

1. Përshkrim i shkurtër i institucionit 4
2. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij. 4
3. Objektivat dhe qëllimi i auditimit: 4
4. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave 4-5
5. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve 5
6. Paraqitja e gjetjeve kryesore 5-7
7. Paraqitja e rekomandimeve kryesore 7-8
8. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit 8-9

II. HYRJA 9

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit 9-10
2. Identifikimi i çështjes 10
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese 10
4. Përgjegjësia e audituesve 11
5. Kriteret e vlerësimit: 11-12
6. Standardet e auditimit 12
7. Metodat e auditimit 13-14
8. Dokumentimi i auditimit 14

III. PËRSHKRIM I AUDITIMIT 14-15

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin 15

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit 15

2.1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik……. 15-26

2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit. 26-36

2.2.6 Auditim mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të paarkëtuara… 37-45

2.3 Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025. 45-74

2.4 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditim e mëparshëm. 74-125

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME 125-137

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i institucionit

Bashkia e Beratit kufizohet në veri me bashkitë Kuçovë dhe Ura Vajgurore, në lindje me bashkinë Gramsh dhe Skrapar, në jug me bashkinë Poliçan, ndërsa në perëndim me bashkinë Mallakastër. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Beratit. Sipas Censusit të vitit 2024, Bashkia Berat numëron 62,232 banorë. Bashkia e Beratit ka një sipërfaqe prej 379.98 km^2. Industritë kryesore në qytetin e Beratit, janë turizmi, biznesi fason, si dhe prodhimi dhe tregtimi të produkteve të konservuara.
Në Bashkinë e Beratit, krahas qytetit janë dhe katër njësi administrative rurale, ku NJA Velabisht dhe Otllak, janë zona kryesisht fushore dhe pjellore, ku të ardhurat kryesore sigurohen nga prodhimi i perimeve, ullinjve dhe vreshtarisë. Ndërkohë që dy njësitë e tjera administrative, Rroshnik dhe Sinjë, kanë reliev kodrinoro-malor dhe të ardhurat kryesore sigurohen nga pemëtaria dhe blegtoria.

2. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e qeverisjes vendore" nenit 50 "Auditi i jashtëm" pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: "*1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose audituesë të tjerë ligjore".* Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Berat si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

3. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe aktet ligjore dhe nënligjore për periudhën 01.01.2025-31.12.2025.
Në Auditimin Financiar, qëllimi është të jepet një opinion i pavarur dhe profesional, me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2025 transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë pasqyruar saktë dhe drejtë në pasqyrat financiare të subjektit, në përputhje me kuadrin ligjor të zbatueshëm të raportimit financiar.
Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:
1. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.
2. Burimi i krijimit të të ardhurave, planifikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave
3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar.
4. Vlerësimi i funksionit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar dhe Vlerësimi i Auditimit të Brendshëm.
5. Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, kryer në Bashkinë Berat.

4. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. ***Vlerësimi i riskut të kontrollit;***
Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në

konsideratë faktorët e riskut prej 0,7% për shpenzimet dhe 2% për investimet. Për vitin 2025 niveli i materialitetit pranohet në vlerën 24,475 mijë lekë dhe gabimi i lejuar *(10% - 20%)* në vlerën 2,447 mijë lekë për t'u konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Mbi transaksionet u aplikuan: - teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (u analizua menaxhimi financiar dhe kontrolli);
Grupi i auditimit ka audituar transaksione të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

5. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve

Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 15 gjetje dhe ka dhënë 17 rekomandime, nga ku masa organizative me 11 gjetje dhe 12 rekomandime, për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës për arkëtimin e detyrimeve janë konstatuar 4 gjetje dhe 5 rekomandime dhe për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve.

6. Paraqitja e gjetjeve kryesore.

- ***Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave***

- Nga auditimi u konstatua se nga Bashkia Berat nuk janë ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve të paarkëtuara (borxhi) dhe për të gjithë subjektet, pasi nga auditimi i të dhënave, rezultoi se :

a) Deri në datën 31.12.2024 nga mospagesa e detyrimeve tatimore janë debitorë abonentët familjarë në vlerën 164,793,256 lekë. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025 janë paguar nga debitorët familjarë 18,116,824 lekë dhe është krijuar borxh i ri në vlerën 27,638,713 lekë për abonentët familjarë. Borxhi tatimor progresiv për abonentë familjarë në datën 31.12.2025, është në vlerën **175,315,145 lekë.**

b) Në lidhje me detyrimet e tatimpaguesve biznes që kanë ndaj Bashkisë Berat konstatohet se deri në datën 31.12.2024, borxhi tatimor është në vlerën 151,711,887 lekë. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025, janë paguar nga debitorët biznes detyrime të prapambetura në vlerën 6,565,550 lekë dhe është krijuar borxhi tatimor në vlerën 20,086,751 mijë lekë për abonentët e biznesit. Borxhi tatimor progresiv për abonentët privatë në datën 31.12.2025, është në vlerën **165,233,088 lekë**.

- Nga auditimi i dokumentacionit të administruar nga Drejtoria e Planifikimit Urban lidhur me legalizimet e ndërtimeve pa leje, si dhe listat për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezultoi se Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Dega Berat, ka përcjellë zyrtarisht listat e qytetarëve të pajisur me leje legalizimi. Detyrimi për këtë taksë deri në datën 31.12.2025 i përket 180 personave dhe është në vlerën 5,883,010 lekë.

- Nga auditimi i dokumentacionit mbi pajisjen me autorizim tregtimi për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, konstatohet se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve. U konstatua se në Bashkinë Berat, figurojnë 13 subjekte që ushtrojnë veprimtari tregtare në fushën e hidrokarbureve. Nga subjektet e hidrokarbureve 11 subjekte janë pajisur me

licencë, nga të cilat 1 subjekt ka detyrim të papaguar në vlerën 400,000 lekë, 1 subjekt i palicencuar si dhe 1 subjekt në proces për pajisjen me autorizim.

- ***Procedurat e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit***

- Nga auditimi i procesit të hartimit të PBA-së dhe dokumentimit të hapave të ndjekura rezultoi se:

Raporti për vlerësimin dhe parashikimin e të ardhurave afatmesme nuk është paraqitur në Këshillin Bashkiak. Vlerësimi i të ardhurave nuk është paraqitur në Këshillin Bashkiak në kundërshtim me afatet e përcaktuar në pikën 58 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".*

Tavanet Buxhetore për PBA 2025-2027 janë paraqitur dhe miratuar me VKB nr.37, datë 29.04.2024 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 311/1 prot., datë 02.05.2024 në kundërshtim me afatet e përcaktuara në pikën 63 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".*

Udhëzimi i Kryetarit për përgatitjen e buxhetit afatmesëm nuk është hartuar.

Tavanet përfundimtare të PBA 2025-2027 janë miratuar me VKB nr.56 datë 30.07.2024 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr.540/1 prot., datë 05.08.2024 në kundërshtim me ligjin nr.68/2017, neni 37, pika 1 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore".*

Faza e dytë e PBA 2025-2027

Kalendari i konsultimeve publike nuk është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak.

- Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Berat së bashku me transfertat e pakushtëzuara dhe specifike, për vitin 2025, ka devijime me vlerën e planifikuar.

Për vitin 2025, planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pakushtëzuar dhe specifiken ka vlerën 1,759,789 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 1,461,690 mijë lekë ose në masën 83%.

Për vitin 2025 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 637,974 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 532,165 mijë lekë ose në masën 83%.

Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulëta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2025 investimet me të ardhurat e veta dhe transfertat janë planifikuar në vlerën 264,583 mijë lekë, realizuar 112,743 mijë lekë, ose në masën 42.6%.

Mosrealizimi i të ardhurave, do të thotë se nga Bashkia Berat në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore.

- Nga auditimi rezultoi se totali progresiv i detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2024 janë në vlerën 66,204 mijë lekë, nga të cilat për investime janë në vlerën 16,496 mijë lekë, për mallra dhe shërbime në vlerën 1,159 mijë lekë dhe për vendime gjyqësore janë në vlerën 48,547 mijë lekë. Gjatë vitit 2025 janë likuiduar detyrime të prapambetura në vlerën 66,204 mijë lekë dhe janë krijuar detyrime të reja në vlerën 107,274 mijë lekë. Detyrime të prapambetura në datën 31.12.2025 janë në vlerën 107,274 mijë lekë, nga të cilat për investime janë në vlerën 15,742 mijë lekë, për mallra dhe shërbime në vlerën 1,274 mijë lekë për vendime gjyqësore janë në vlerën 85,550 lekë dhe nga buxheti i shtetit për investime në vlerën 4,706 mijë lekë.

- Nga auditimi rezultoi se totali i detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2024 për vendimet gjyqësore është në vlerën 48,547 mijë lekë. Gjatë vitit 2025 në buxhetin e miratuar me VKB nr. 108, datë 18.12.2024 janë planifikuar për t'u likuiduar detyrime në vlerën 21,432 mijë lekë. Gjatë vitit 2025 janë kontabilizuar 14 (katërmbëdhjetë) vendime të reja gjyqësore me vlerë detyrimi 85,550 mijë lekë. Referuar pasqyrës së pozicionit financiar të konsoliduar llogaria 150 *"Shuma të parashikuara për rreziqe dhe shpenzime"* është kontabilizuar me vlerë 0 lekë. Bashkia Berat për vendimet gjyqësore të cilat janë në shkallët e gjykimit dhe nuk ka vendim përfundimtar por për të cilat ekziston probabilitet i lartë humbje dhe njihet vlera duhet të krijohet provigjon në llogarinë e mësipërme.

- ***Auditimi i llogarive vjetore për vitin 2025***

-Llogaria 231 *"Investime për aktive afatgjata"* është paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 1,326,329 mijë lekë.
- Llogaria 466 *"Kreditorë për mjete në ruajtje"* është paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 48,573 mijë lekë.
- Llogaria 486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*" është paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 107,274 mijë lekë.

7. Paraqitja e rekomandimeve kryesore

- ***Planifikimin dhe realizimit i të ardhurave***

- Bashkia Berat, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore deri më datën 31.12.2025 nga subjektet e biznesit debitorë në vlerën 165,233,088 lekë, nga debitorët familjarë në vlerën 175,315,146 lekë. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të paarkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve. Gjithashtu Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Berat, për mos kalimin e subjekteve debitore me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.
- Bashkia Berat, Drejtoria e Planifikimit Urban në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 180 persona me vlerë **5,883,010 lekë.**
- Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave Transportit dhe Shërbimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave, të ndjekë të gjitha rrugët ligjore për pajisjen me autorizim të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, si dhe arkëtimin e tarifës për këtë licencë në vlerën **400,000 lekë për 1 subjekt,** konkretisht:

1- B. O, të arkëtohet vlera 400,000 lekë.

Bashkia Berat, Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave Transportit dhe Shërbimeve në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrë masa të menjëhershme për pezullimin e subjektit, që ushtrojnë aktivitet për tregtimin karburanti pa u pajisur me autorizim.

- ***Procedurat e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit***

- Kryetari i Bashkisë Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masat e nevojshme që të ndjekë të gjitha fazat e planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor duke e miratuar brenda afateve ligjore.
- Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Bashkisë Berat, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime reale. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi

të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.
- Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.
- Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të planifikojnë në buxhet fondet e nevojshme për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të pritshme, bazuar në vlerësimin e riskut dhe ecurinë e proceseve gjyqësore për të mos krijuar detyrime të prapambetura.

- ***Auditimi i llogarive vjetore për vitin 2025***

- Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të kryejë sistemimet kontabël të llogarisë 4342 *"Të tjera operacione me shtetin"* dhe llogarinë 7206 *"Financim i pritshëm nga buxheti"* për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.
- Kryetari i Bashkisë Berat në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të ngrenë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin dhe vlerësimin e pronave të Bashkisë Berat të kaluara me VKM për llogarinë 210 "*Toka, troje terrene*". Gjithashtu nga ana e Drejtorisë Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të merren masa për kontabilizimin e saktë të kësaj llogarie.
- Kryetari i Bashkisë Berat të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin dhe vlerësimin e pronave të Bashkisë Berat për llogarinë 211 "*Pyje Plantacione*" në lidhje me gjendjen fizike për hartimin e regjistrit fizik të aktiveve që Bashkia zotëron.
- Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të mos kryejë kontabilizimin e llogarisë 486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*", në pasqyrën e pozicionit financiar. Detyrimet e prapambetura duhet të kontabilizohen në llogarinë 4342 "Operacione me shtetin" me kundëparti llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm"

8. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

I. Opinioni i pasqyrave financiare viti 2025:

Ne kemi audituar, pasqyrat financiare të konsoliduar të Bashkisë Berat për vitin e fundit ushtrimor 01.01.2025 deri më 31.12.2025, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinioni:

"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Berat pasqyrat financiare nuk paraqesin në mënyrë të drejtë disa elementë të përshkruara në paragrafin "Baza për Opinionin e kualifikuar", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe

*justifikojnë dhënien e një **opinioni të kualifikuar**", e shprehur kjo në bazën për opinionin.*

Baza për opinionin e kualifikuar[1]:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale por jo të përhapura, ato prekin disa prej llogarive financiare dhe sipas gjykimit tonë, kanë efekt në rezultatin financiar të Bashkisë Berat. Materialiteti i Bashkisë Berat për vitin 2025 është në vlerën 24,475 mijë lekë Për këto arsye kemi dhënë opinion të kualifikuar, sipas shpjegimeve në paragrafin e më poshtëm:

Përshkrimi i çështjeve kryesore:

Gabimet materiale në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 dhjetor 2025, paraqiten si më poshtë:

Nga auditimi ka rezultuar se në disa raste, nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave janë kryer veprime kontabël që kanë sjellë pasqyrim jo të drejtë të këtyre ngjarjeve, konkretisht:

- Llogaria 4342 "*Të tjera operacione me shtetin (të drejta)*" është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 107,387 mijë lekë.
- Llogaria 486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*", është paraqitur e mbivlerësuar pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 107,274 mijë lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 547/1 prot, datë 22.05.2026, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 25.05.2026 deri më datë 06.07.2026 në subjektin Bashkia Berat për periudhën nga data 01.01.2025 deri më datën 31.12.2025, u krye *auditimi "Mbi auditimin financiar"* nga grupi i auditimit me përbërje:

1. K. H, Përgjegjës Grupi
2. A. D, Auditues
3. K. F, Auditues

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit.

Objekt i këtij auditimi është auditimi financiar i subjektit, ku do të përcaktohet niveli i zbatimit të kritereve të vlerësimit, referuar kuadrit rregullator të cilësuar në paragrafin nr. 5 "Kriteret e vlerësimit". Ky auditim ka si qëllim:

Dhënien e një vlerësimi objektiv e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjera që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj. Promovimin e qeverisjes së mirë, duke identifikuar dhe

[1] *Një "Opinion i kualifikuar", jepet në rastet kur: - audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë;*

raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikohen personat përgjegjës për veprimet e tyre. Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve, nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

2. Identifikimi i çështjes.

Përcaktimi i nivelit të duhur të materialitetit, për të mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Ky Raport Auditimi, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Berat, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do të përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim, ne besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Berat.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Kryetari i Bashkisë Berat në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Berat, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar të aktivitetit e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen

e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.[2]
Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

4. Përgjegjësia e audituesve.

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Bashkisë Berat dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.
Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.
Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si përkatësia, plotësia, saktësia dhe vlerësimi, periudha, klasifikimi dhe kuptueshmëria, ligjshmëria dhe rregullsia, ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi, transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.
Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Berat është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.
Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.
Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik", paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit:

Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjerë ligjorë sa më poshtë:

[2] Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, neni 15

- Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar*; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 *"Për auditimin e brendshëm publik";* Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;* Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes Vendore"*; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 *"Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik"*; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues";* Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 *"Për miratimin e manualit të MFK";* Urdhri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 *"Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik".*

-Në fushën e buxhetit: Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 *"Për huamarrjen e qeverisjes vendore";* Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 *"Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" i ndryshuar*; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"* etj.; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar;* Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 *"Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura" i ndryshuar*; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore".*

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar;*

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 *"Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar";* Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 *"Për sistemin e taksave lokale"*, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, *"Për taksat kombëtare", i ndryshuar;* VKM nr. 170, datë 25.4.2002 *"Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", me ndryshime*; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, *"Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave" i ndryshuar*; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.09.2008 *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.*

6. Standardet e auditimit.

Auditimi është kryer në përputhje me ISSAI 100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 "*Udhëzues të Auditimit Financiar*"; ISSAI 2300 "*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*"; INTOSAI GOV 9100 "*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*" si dhe INTOSAI GOV 9110 "*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*"; ISSAI 400 "*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*", i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 "*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*"; si dhe ISSAI 4200 "*Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë*"; INTOSAI "*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*" etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 246, datë 29.12.2022 dhe Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 245,

datë 29.12.2022; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metodat e auditimit.

Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efiçencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit[3]. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).
- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.*
- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim:

[3] **ISSAI 1320 (ISA 320)** trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit.

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të auditimit financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 "Dokumentimi i Auditimit", i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, nga grupi i auditimit janë mbajtur akt-konstatimet të cilat u dorëzuan në zyrën e protokollit të Bashkisë Berat në datë 06.07.2026, e cila korrespondon me datën e mbylljes së punës në terren sipas programit të auditimit. Nga subjekti i audituar janë paraqitur kundërshtitë mbi projekt raportin e auditimit.

III. PËRSHKRIM I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Zona Gjeografike: Bashkia e Beratit kufizohet në veri me bashkitë Kuçovë dhe Ura Vajgurore, në lindje me bashkinë Gramsh dhe Skrapar, në jug me bashkinë Poliçan, ndërsa në perëndim me bashkinë Mallakastër. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Beratit.
Popullsia: Sipas Censusit të vitit 2024, Bashkia Berat numëron 62,232 banorë. Bashkia e Beratit ka një sipërfaqe prej 379.98 km^2.
Zhvillimit ekonomik: Industritë kryesore në qytetin e Beratit, janë turizmi, biznesi fason, si dhe prodhimi dhe tregtimi të produkteve të konservuara.
Në Bashkinë e Beratit, krahas qytetit janë dhe katër njësi administrative rurale, ku NJA Velabisht dhe Otllak, janë zona kryesisht fushore dhe pjellore, ku të ardhurat kryesore sigurohen nga prodhimi i perimeve, ullinjve dhe vreshtarisë. Ndërkohë që dy njësitë e tjera administrative, Rroshnik dhe Sinjë, kanë reliev kodrinoro-malor dhe të ardhurat kryesore sigurohen nga pemëtaria dhe blegtoria.

Sfidat me të cilat përballet: Bashkia përballet me një sërë sfidash të rëndësishme janë: Menaxhimi i mbetjeve urbane dhe sistemimi i rrjetit të kanalizimeve; Ndërhyrja në infrastrukturën e rrugëve dytësore të qytetit dhe fshatrave përreth, mirëmbajtja e institucioneve arsimore dhe shëndetësore; Mbështetja dhe nxitja më tej e turizmit historik dhe kulturor përmes lehtësimin e procedurave dhe politikave fiskale të banorëve për vetëpunësim në këtë fushë, ruajtjen e banesave muzeale nga erozioni dhe zjarret, por dhe ndalimi i ndërtimeve pa leje në qendrën historike; Krijimi i mundësisë së integrimit të formave alternative të turizmit në zonat përreth qytetit, si ekoturizmi dhe turizmi i aventurës; Ripërtëritja e jetës kulturore dhe artistike të zonës, por dhe zhvillimi i ambienteve dhe aktiviteteve sportive për rritjen e përfshirjes së të rinjve në jetën sociale të qytetit, etj.
Rëndësia e këtij auditimi është të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si edhe shfrytëzimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur që subjekti i audituar të ndërmarrë veprimet korrigjuese sipas rastit, të rritë përgjegjshmërinë në llogaridhënie, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara, si dhe parandalimin e shkeljeve me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

Në zbatim të programit të auditimit nr.547/1 prot., datë 22.05.2026, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në Bashkinë Berat u ushtrua auditimi financiar për periudhën nga data 01.01.2025 deri më datën 31.12.2025, sipas drejtimeve:
2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik;
2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit;
2.3. Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025;
2.4. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve;
2.5. Të ndryshme të dala gjatë auditimit;

2.1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

Ky auditim u krye në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar*, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:
- *pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;*
- *informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;*
- *mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.*

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Berat si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

<u>I. Komponenti "Mjedisi i Kontrollit":</u>
Në lidhje me parimin 1 "Angazhimin për integritet dhe vlerat etike".

Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.
- Për vitin 2025 ka qenë në fuqi Rregullore e Brendshme miratuar me dokumentin nr. 326 prot., datë 18.01.2023 të Kryetarit të Bashkisë Berat.
- Nuk dokumentohet trajnimi i burimeve njerëzore të rekrutuar gjatë vitit 2025 mbi rregulloren e brendshme, integritetin dhe etikën.
- Nuk dokumentohet procedura e ndjekur për komunikimin dhe njohjen e stafit të Bashkisë Berat për ndryshimet ligjore të ndodhura në fusha të ndryshme.
- Ka rregullore të posaçme për hetimin administrativ të sinjalizimit, por nuk dokumentohet nëse përgjatë vitit 2025 ka pasur raste të raportimit të korrupsionit për të vlerësuar linjën e raportimit, ankuesi, njësia përgjegjëse për sinjalizimi, titullari i institucionit dhe dokumentimi i procedurës së ndjekur për trajtimin e rastit.
- Ka proçes vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip një herë në 6 muaj. Po ashtu ka vlerësime vjetore dhe për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.
- Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (në zyrën e integruar me një ndalesë), duke i'u adresuar strukturave të bashkisë sipas problemeve, të cilat do të trajtojnë ankesat dhe kërkesat dhe përgjigjet do të firmosen nga drejtorët sipas fushës përkatëse që ka shqyrtuar problematikën. Kjo proçedurë është përcaktuar në nenin 11 të Rregullores së Brendshme.
Në lidhje me parimin 2 "Titullari demostron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje".
- Për vitin 2025 nuk administrohet plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Nuk administrohen raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të kontrollit të brendshëm.
- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Ndërsa nga shoqëritë aksionare, ku bashkia është aksionere dhe nga ndërmarrjet në varësi të saj Bashkia Berat merr raportime ne lidhje me vendim-marrjen e këshillit drejtues, por mungojnë raportimet periodike për përformancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat.
- Për vitin 2025, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit janë hartuar çdo 4 - muaj, si dhe ka raportime periodike dhe vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit të paraqitur pranë nivelit drejtues dhe këshillit bashkiak. Si rezultat i këtij procesi, raportimi fokusohet në ecurinë e veprimtarisë dhe performancës financiare të institucionit dhe më pak në drejtim të raportimit të arritjeve apo problematikave në zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Veç sa më sipër, nuk dokumentohet raportimi nga çdo strukturë e bashkisë.
-Gjithashtu në rregulloren e brendshme, jo për çdo strukturë të Bashkisë Berat, përcaktohet afat për raportimin ndaj eprorit, mbi realizimin e planit të punës/objektivave.
Në lidhje me parimin 3 "Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë".
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezultoi se rregullorja e brendshme nuk është përditësuar me ndryshimet në strukturë, konkretisht evidentohen disa mospërputhje, në

strukturë emërtesa e pozicionit është "Specialist i Emergjencave Civile", në Rregulloren e Brendshme është "Specialist i Mbrojtjes Civile"; Në strukturë parashikohet pozicioni "Përgjegjës i Sektorit të Projekteve dhe Investimeve", ndërkohë në Rregulloren e Brendshme nuk parashikohet si pozicion; Në Rregulloren e Brendshme parashikohet pozicioni "Specialist i Planifikimit të Territorit dhe Regjistrit Elektronik", ndërkohë në strukturë nuk parashikohet si pozicion; Në strukturë parashikohet pozicioni "Përgjegjës i Sektorit të Administrimit Elektronik të Lejeve", ndërkohë në Rregulloren e Brendshme nuk parashikohet.

- Në organizimin dhe funksionimin e NJAB Bashkia Berat, referuar rregullores së brendshme, nuk parashikohen detyrat për pozicionin e specialistit të auditit, por këto janë të përfshira në pozicionin e drejtuesit të NJAB.
- Në rregulloren e brendshme, por edhe me urdhër të titullarit, nuk ka të përcaktuar linja komunikimi ndërmjet drejtorive/sektorëve të ndryshëm të bashkisë, konkretisht Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore me qëllim shkëmbimin e informacionit sa subjekte janë pajisur me leje ndërtimi/infrastrukture, si dhe nëse këta të fundit janë me seli kryesore në Bashkinë Berat apo duhet të pajisen me NIPT sekondar, duke vijuar me përfshirjen e tyre në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore, si dhe tarifimin e tyre nga sektori i taksave dhe tarifave).
- Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezultoi se nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik të zhvillimit (afat 5 vjeçar), sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të Ligjit nr.68/2017 *"Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore",* i ndryshuar, por është vetëm Plani i Përgjithshëm Vendor.

-Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit, si dhe nuk është përfshirë në rregulloren e brendshme.

- Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezultoi se në Rregulloren e Brendshme në raste të caktuara, në gjykimin e grupit të auditimit krijohet mbivendosje e disa detyrave, konkretisht:

Për pozicionet "Specialisti i Financës dhe të Ardhurave", "Specialisti i Buxhetit" dhe "Specialisti i Analizës Financiare dhe Riskut", për detyrat:

"Raporton periodikisht para NZ për ecurinë e realizimit të të ardhurave";

"Raporton periodikisht para NZ për ecurinë e realizimit të buxhetit" – ku theksojmë se buxheti përfshinë të ardhurat dhe shpenzimet;

"Analizon dhe raporton tek eprori mbi zbatimin e buxhetit vjetor, në periudha mujore dhe 4-mujore"

Për pozicionet "Specialisti i Buxhetit" dhe "Specialisti i Analizës Financiare dhe Riskut", për detyrat:

"Evidenton, regjistron dhe raporton detyrimet e prapambetura sipas kategorive për investime, vendime gjyqësore, blerje mallra dhe shërbime dhe detyrime të tjera";

"Analizon dhe raporton tek eprori mbi gjendjen e detyrimeve të prapambetura dhe monitoron likuidimin e tyre".

Në lidhje me parimin 4 "Njësia publike demostron angazhimin në realizimin e kompetencave".

- Në Bashkinë Berat nuk janë hartuar "Hartat e proçeseve të punës".
- Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e MFK-së, nuk është parashikuar dhe hartuar një program trajnimi, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet dhe zbatimin e kërkesave kryesore në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit përveç trajnimeve që janë organizuar nga ASPA.

- Nëpunësi Zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin, të përshtatur me pozicionin si Drejtori i Drejtorisë së Financës.
-Nuk administrohet urdhri për caktimin e Koordinatorit të MFK dhe të Riskut.
Në lidhje me parimin 5 "Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale".
-Për vitin 2025, GMS është krijuar me Urdhrin nr. 255 datë 02.04.2025 të Kryetarit të Bashkisë Berat.
Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupi të Menaxhimit Strategjik (GMS) rezultoi se:
-Bashkia Berat nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik".
-Nuk administrohen proçesverbalet e takimit të GMS, për të dokumentuar funksionimin e këtij grupi.
-Në Rregulloren e Brendshme janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e komisioneve të përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë Berat, me përjashtim të Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.
-Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.
-Në Rregulloren e Brendshme është parashikuar "Delegimi i kompetencave" në zbatim të ligjit 44/2015 *"Kodi i Proçedurave Administrative".*

II. Komponenti "Menaxhimi i Riskut".

Në lidhje me parimin 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre.
- Nga Bashkia Berat përcaktohen objektiva sasiorë (vlerë monetare) në hartimin e PBA-ve dhe buxhetet vjetore, dokumente të cilat publikohen në faqen zyrtare të Bashkisë Berat. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konstatohet se nuk është hartuar plani i përgjithshëm strategjik i zhvillimit (afat 5 vjeçar), sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të Ligjit nr.68/2017 *"Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore".*
-Nuk dokumentohet hartimi dhe miratimi i plan-veprime vjetore operacionale të miratuara, për arritjen e qëllimeve te politikave afatmesme (PBA), objektivave vjetore që përmbajnë veprime, afate, dhe persona konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar.
Në lidhje me parimin 7: "Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave".
-Nuk dokumentohet krijimi i grupit koordinues teknik të menaxhimit dhe raportimit të riskut për vitin 2025.
-Nuk dokumentohen takimet periodike (1 herë në dy muaj) të Koordinatorit të Riskut me drejtorët e drejtorive përkatëse të institucionit.
- Në Bashkinë Berat, sektori i financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me program kontabiliteti Alpha Ëeb por nuk dokumentohet se kur është bërë përditësimi i fundit i tij si dhe back up të të gjitha të dhënave. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.
-Është krijuar regjistri i riskut, por nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut.
-Nuk ka raportim të riskut operacional, për shkak të strukturave të pa plotësuara.
-Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk punon me sistem HRMIS, por me hedhje manualisht në programin Microsoft Office Excel.
Në lidhje me parimin 8: "Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime".

-Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk janë përcaktuar procedura specifike të vlerësimit të riskut të mashtrimit. Nuk administrohen evidenca të monitorimit të riskut tek/nga menaxherët, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike ekspozimin e Bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, e cila përbën risk për veprimtarinë e bashkisë.

Në lidhje me parimin 9: "Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm".

-Problematikë e evidentuar në lidhje me këtë parim është mungesa e rregullave të shkruara në lidhje me procedurën që ndiqet për lëvizjet e stafit dhe mungesa e pasqyrimit të këtyre ndryshimeve si risqe në regjistrin e riskut të institucionit. Ndryshimet e shpeshta të drejtuesve të njësive publike kanë shfaqur luhatje të vazhdueshme të kulturës dhe qëndrimeve filozofike përsa i përket menaxhimit të ndryshimeve dhe zhvillimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Ndryshimet strukturore apo menaxheriale duhet të ndiqen nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.

III. Komponenti: " Aktivitetet e Kontrollit".

Në lidhje me parimin 10: "Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli".

- Mbetet problematikë hartimi i hartave të proceseve të punës për çdo pozicion në strukturën e Bashkisë Berat.
- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.
- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtoria e Financës (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Drejtoria e Financës, hartimi dhe regjistrimi i pagesës kryhet nga specialistët e Sektorit të Financës, ndërsa autorizimi i pagesës nga NA.
- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të përllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/punimeve/shërbimeve.
- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili përditësohet sa herë ka ndryshime fondesh. Ekzistojnë dosjet e proçedurave të prokurimeve, ku gjurmën e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumenta autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj.
- Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivet afatgjata dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.
- Në përgjithësi për proçedurat e inventarizimit, vlerësimin, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të AAGJM, ka gjurmë auditimi, pasi ekziston dokumentacioni i firmosur nga komisionet dhe punonjësit përkatës si: Urdhri i NA për ngritjet e komisionit të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi si dhe për asgjesimin e tyre. Ekzistojnë fletët e inventarit, relacioni i vlerësimit për aktivet për nxjerrje jashtë përdorimi, proçesverbale dhe relacionet për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve dhe proçesverbalet për asgjesimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi. Janë prerë dokumentet bazë (fletë-daljet) dhe kryer veprimet kontabël përkatës.

- Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet bankave të nivelit të dytë në llogarinë e thesarit për Bashkinë Berat, si dhe veprimeve me arkën, kurse një pjesë e taksave dhe tarifave (taksat e ndara) arkëtohen nëpërmjet agjentëve tatimor. Për këto të ardhura në përgjithësi janë bërë akt-rakordimet përkatëse periodike dhe vjetore dhe janë kontabilizuar.
- Bashkia Berat në bashkëpunim me Degën e Thesarit Berat, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponilibiteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga Bashkia Berat.

Në lidhje me parimin 11: "Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë".

-Bashkia Berat nuk ka proçedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka proçedurën e vetë të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara.
- Në rregulloren e brendshme përcaktohen detyrat e specialistit të IT.
- Në Bashkinë Berat ka proçedurë për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij.
-Në strukturën e Bashkisë Berat janë 3 specialist IT, duke sjellë që i njëjti person të kontrollojë të gjitha fazat e funksionimit të TI-së.
- Në Bashkinë Berat zbatohen rekomandimet e politikave për sigurinë kibernetike në lidhje me ndryshimin e fjalëkalimeve, fireëall-et, hyrje e kufizuar në të dhënat TI, etj.
-Institucioni ka sistem rezervë (Back -up) si dhe plan-rekuperimi nga fatkeqesitë. Në përgjithësi, Bashkia Berat bazohet në rregullat e përgjithshme të përcaktuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe nuk ka procedura të brendshme specifike për këtë fushë.
-Në rregulloren e brendshme përcaktohen detyrat e specialistit të IT, i cili varet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
-Në strukturën e Bashkisë Berat janë 3 specialist IT.

Në lidhje me parimin 12: "Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe proçedurave".
- Nuk ka procedurë të shkruar specifike për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve.
- Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrolle dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listë-pagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga përgjegjësi i sektorit. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedura janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e sektorit të financës.
- Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare bëhet në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (pra Udhëzimit të MFE nr.8 datë 09.08.2018 "Për hartimin e PF", i ndryshuar). Nga auditi i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

IV. Komponenti: "Informimi dhe Komunikimi"

Në lidhje me parimin 13: "Njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor".

-Bashkia Berat disponon faqen e saj zyrtare në ëeb ku pasqyrohet aktiviteti i saj si rregullorja e brendshme, broshura, planet e performancës, projekte të brendshme dhe të huaja, bashkëpunime

brenda dhe jashtë vendit, aktivitete, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, buxheti vjetor, publikime të ndryshme, si dhe shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve.
Për vitin 2025 nga Bashkia Berat mbi vendimmarrjen e saj, janë kryer konsultime me publikun dhe palët e interesit.
Në lidhje me parimin 14: Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor.
-Përsa i përket raportimit të informacionit të përpunuar, evidentohet se përgatiten për menaxhimin/drejtuesit, raporte të nevojshme mbi performancën financiare (përmbushjen e detyrave) të njësisë në raport me objektivat e caktuara, për të bërë të mundur që ata të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre me efiçencë dhe efektivitet, por nuk rezulton që të ketë një bazë rregullative që të përcaktojë llojet e raportimit dhe periodicitetin e tyre, si dhe raporte mbi aktivitete të tjera të institucionit. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve.
Në lidhje me parimin 15: Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm.
-Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit.
-Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për probleme apo parregullsi, në rrugë shkresore/verbale/email.
-Për vitin 2025 nga Bashkia Berat (për vendimmarrje për dhënien e pasurive të paluajtshme me qira, buxhetin etj) janë kryer konsultime me publikun dhe palët e interesit.

V. Komponenti: "Monitorimi dhe Raportimi"

Në lidhje me parimin 16: "Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme".
- Proçedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por nuk administrohen plotësisht raportimet e të gjithë drejtuesve të drejtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave.
- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet periodikisht. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efiçencës e të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.
-Bashkia Berat pyetësorin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2025 e ka raportuar në MFE, me shkresën nr.1622 prot., datë 11.03.2026. Deklaratën e Cilësisë dhe Raportin Vjetor mbi Cilësinë e ka raportuar në MFE me shkresën nr.1301 prot., datë 26.02.2026. Bashkia Berat nuk respektuar afatin ligjor për dërgimin e pyetësorit të vetëvlerësimit brenda muajit Shkurt të vitit 2026.
Në lidhje me parimin 17: "Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë".

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë Berat, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:
1. z. E. C, në funksionin e Kryetarit të Bashkisë.
2. z. G. D, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
3. znj. R. Sh, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave.

2.1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm

Në zbatim të programit të auditimit, u audituа dokumentacioni si më poshtë:
1. Karta e Auditimit të Njësisë Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Berat;
2. Plani Strategjik 2025-2027, si dhe pasqyrat shoqëruese;
3. Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2025;
4. Raportimi vjetor në Ministrinë e Financave, Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;
5. Dosjet e subjekteve të audituara;
6. Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditimit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

Përshkrimi i situatës mbi krijimin dhe përbërjen e strukturës së njësisë së auditit të brendshëm.
Në bazë të VKM nr.83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik", është krijuar njësia e Auditit të Brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditit të Brendshëm duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr.1100, i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm. Ky sektor përgjatë vitit 2025, është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të Vendimit nr.857, datë 06.12.2024 *"Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Bashkisë Berat, të Njësive Shpenzuese në varësi të saj",* si dhe ka pasur 3 punonjës përkatësisht, përgjegjësi i sektorit z. Xh. M, si dhe dy specialist znj. O. H dhe znj. M. C.
Detyra e kësaj strukture është të programojë, organizojë dhe kryej auditime të brendshme me miratim të Kryetarit të bashkisë në strukturat e varësisë së drejtpërdrejtë të Bashkisë Berat, për të konstatuar dhe evidentuar shkallën e zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi, bazuar në Manualin e Procedurave të Auditimit të Brendshëm Publik.
Tabelën nr.1: Paraqitet struktura e Sektorit të Auditit të Brendshëm:

Nr	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi ne pune	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime
	Për vitin 2025							
1	Xh. M	Pergj.Sektori	25.11.2016	EK.Industrie Master shkencor	43	21	Nr.039 v.2005	po
2	O. H	Specialist	08.9.2016	Financ. Master shkencor	15	8	Nr.1945 v.2018	po
3	M. C	Specialist	Qershor 2024	Financ. Master shkencor	25	2	Jo	po

Burimi: NJAB Berat, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për vitin 2025.

Viti 2025, plani vjetor i auditimeve i miratuar me shkresën nr.5398 prot., datë 10.10.2024, sipas të cilit janë planifikuar për t'u audituar 9 auditime, pasqyruar si më poshtë:

Tabelën nr.2: Plani i auditimeve për vitin 2025

Nr	Subjekte për t'u audituar	Fusha për t'u audituar	Vlerësimi i riskut		
1	Ndjekja e Zbatimit Rekom Auditit	Financiar	I lartë	I mesëm	I ulët
2	Qendra "Lira"	Përputhshmëri dhe Financiar		Mesëm	
3	Detyrimet e Prapambetura	Përputhshmëri	Lartë		
4	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave	Përputhshmëri dhe Financiar	Lartë		
5	Inspektoriati i Mbrojtjes Territorit	Përputhshmëri dhe Financiar	Lartë		
6	Drejtoria e Bujqesise, Adminis.Pyjeve	Përputhshmëri dhe Financiar	Lartë		
7	Drejtoria e Prokurimeve Publike	Përputhshmëri	Lartë		
8	Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve	Përputhshmëri dhe Financiar		Mesëm	
9	Drejtoria e MZSH-së	Përputhshmëri		Mesëm	

Burimi: NJAB Berat, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Me shkresën nr.6721 prot., datë 20.11.2025, drejtuar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, pranë Ministrisë së Financave, është bërë ndryshimi i planit vjetor të auditimit të brendshëm, duke u hequr auditimi i prokurimeve dhe i MZSH-së, me arsyetimin se janë audituar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, si dhe është përfshirë për auditim Shoqëria Aksionare C. G, në pronësi të Bashkisë Berat. Pra nga 9 auditime të planifikuar për t'u realizuar, është bërë ndryshimi në 8 auditime për t'u realizuar.

Tabelën nr.3: Raportimi i auditimeve të kryera

Nr	Periudha	Të dhëna sipas raportimit								
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit						
				Perputh	Financ	Kombinuar	Performace	Tematik	Teknologjisë së informacionit	Zbatim Rekomandime
1	Viti 2025	8	8	2	1	3		1		1

Burimi: NJAB Berat, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Plani strategjik 2025-2027 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2025 është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr.5398 prot., datë 10.10.2024.

-Për aktivitetin e vitit 2025 është raportuar pranë Ministrisë së Financave me shkresën nr.943 prot., datë 11.02.2026.

Nga auditimi i raportimit për vitin 2025, rezultoi se janë dhënë 76 rekomandime gjithsej, nga të cilat janë zbatuar 30 prej tyre ose 39.5%, si dhe në proces zbatimi 46 ose 60.5%, pasqyruar në tabelën më poshtë:

Tabelën nr.4: Raportimi i rekomandimeve të lëna

Nr	Periudha	Të dhëna sipas raportimit				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar	Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
1	Viti 2025	76	30	46	0	6507	-	-	-

Burimi: NJAB Berat, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në kundërshtim me nenin 12, shkronja "b" në Ligjin nr. 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik",* i ndryshuar;

-Nuk dokumentohen trajnimet e kryera për stafin e NJAB Berat;

-Nuk pasqyrohet metodologjia e vlerësimit të riskut për sistemet. Konkretisht në një dokument "Excel" pasqyrohet vlerësimi i tyre sipas shkallëve të riskut "I lartë", "I mesëm" dhe "I ulët", por nuk pasqyrohet metoda e ndjekur për klasifikimin sipas shkallëve të riskut.
-Raportimi mbi aktivitetin vjetor 2025 të sektorit të auditimit të brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, nuk është sipas strukturës së përcaktuar në shkronjën "ç" të nenit 14 në Ligjin nr. 114/2015, "Për Auditin e Brendshëm Publik", i ndryshuar, pasi nuk jepet informacion për veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve;
-Drejtuesi i NJAB Berat, kryen vlerësimin e cilësisë së auditimit të kryer edhe për ato auditime, në të cilat ka qenë i angazhuar në grupin auditues;
-Nuk dokumentohet plotësimin i formatit standard 1 "Pyetësor vlerësimi për mjedisin e kontrollit të brendshëm", që shërben për hartimin e planit vjetor të auditimit të brendshëm, përcaktuar në pikën 3.2 të Manualit të Auditimit të Brendshëm;
-Nuk dokumentohet plotësimi i formatit standard 2 "Pyetësori për Planin Strategjik – Të kuptosh procedurat e Auditimit të Brendshëm", që përdoret gjatë hartimit të planit strategjik të auditimit të brendshëm, përcaktuar në pikën 3.2 të Manualit të Auditimit të Brendshëm;
-Arsyetimi i përdorur nga Drejtuesi i NJAB Berat, për ndryshimin e planit të auditimeve dhe konkretisht heqjen e auditimit të Drejtorisë së MZSH-së, nuk qëndron, pasi në auditimin e fundit të kryer nga KLSH, nuk ka qenë objekt, auditimi i kësaj strukture. Në këto kushte, auditimi i Drejtorisë së MZSH-së nuk duhet të ishte hequr nga plani i auditimit. Gjithashtu edhe për heqjen e auditimit të prokurimeve, me arsyetimin se është audituar nga KLSH, nuk qëndron, pasi nuk ka bazë ligjore mbështetëse, që justifikon arsyetimin e dhënë. Ndodhur në kushtet e mësipërme dhe në arsyetimin e bërë nga Drejtuesi i NJAB Berat, duhet të ishte hequr edhe auditimi i Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, për arsye se IMTV Berat është audituar nga KLSH në auditimin e kryer përgjatë vitit 2025 pranë Bashkisë Berat.

Në dosjet e përzgjedhura për auditim, u konstatua se:
1. **Në dosjen e auditimit në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve**, njoftimi për fillimin e angazhimit nuk është nënshkruar nga Drejtuesi i NJAB; Deklarata e Konfliktit të Interesit për audituesen znj. M.C nuk është nënshkruar; Programi i auditimit është përputhshmëri, ndërkohë në planin vjetor është miratuar për auditim përputhshmërie dhe financiar dhe nuk është nënshkruar nga grupi i auditimit; Autorizimi për fillimin e auditimit është nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë, ndërkohë duhet të ishte nënshkruar nga Drejtuesi i NJAB Berat; Ndarja e detyrave nuk është nënshkruar edhe nga audituesja znj. M. C; Nuk administrohet dokumenti sipas formatit standard 6 "Buxheti dhe afati kohor për angazhimet e auditimit"; Formati standard 9 "Testet individuale të Auditimit të Brendshëm"; Nuk administrohet dokumenti i takimit përmbyllës; Dosja e auditimit nuk është e arkivuar; Nuk administrohet lista e kontrollit të cilësisë.
2. **Në dosjen e auditimit në Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit**, programi i auditimit është përputhshmëri, ndërkohë në planin vjetor është miratuar për auditim përputhshmërie dhe financiar, si dhe nuk është sipas formatit standard 8; Autorizimi për fillimin e auditimit është nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë, ndërkohë duhet të ishte nënshkruar nga Drejtuesi i NJAB Berat; Nuk administrohet dokumenti sipas formatit standard 6 "Buxheti dhe afati kohor për angazhimet e auditimit"; Formati standard 9 "Testet individuale të Auditimit të Brendshëm"; Nuk administrohet dokumenti i takimit përmbyllës; Raporti nuk është sipas formatit të përcaktuar në manualin e auditimit të brendshëm; Është dhënë opinion mbi përputhshmërinë,

ndërkohë sipas standardeve të auditimit të brendshëm, auditimi i brendshëm jep opinion mbi përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm; Dosja e auditimit nuk është e arkivuar.

3. **Në dosjen e auditimit në Drejtorinë e Tatimeve dhe Tarifave**, programi i auditimit është përputhshmëri, ndërkohë në planin vjetor është miratuar për auditim përputhshmërie dhe financiar, si dhe nuk është sipas formatit standard 8; Autorizimi për fillimin e auditimit është nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë, ndërkohë duhet të ishte nënshkruar nga Drejtuesi i NJAB Berat; Nuk administrohet dokumenti sipas formatit standard 6 "Buxheti dhe afati kohor për angazhimet e auditimit"; Formati standard 9 "Testet individuale të Auditimit të Brendshëm"; Nuk administrohet dokumenti i takimit përmbyllës; Raporti nuk është sipas formatit të përcaktuar në manualin e auditimit të brendshëm; Është dhënë opinion mbi përputhshmërinë duke referuar standardet ndërkombëtare të auditimit ISSAI, ndërkohë sipas standardeve globale të auditimit të brendshëm, auditimi i brendshëm jep opinion mbi përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm; Dosja e auditimit nuk është e arkivuar.

4. **Në dosjen e auditimit të subjektit C. G Sh.A.**, programi i auditimit nuk është nënshkruar nga grupi i auditimit; Ndarja e detyrave nuk është nënshkruar nga auditueset znj. O. H dhe znj. M. C; Autorizimi për fillimin e auditimit është nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë, ndërkohë duhet të ishte nënshkruar nga Drejtuesi i NJAB Berat; Nuk administrohet dokumenti sipas formatit standard 6 "Buxheti dhe afati kohor për angazhimet e auditimit"; Formati standard 9 "Testet individuale të Auditimit të Brendshëm"; Nuk administrohet dokumenti i takimit përmbyllës; Raporti nuk është sipas formatit të përcaktuar në manualin e auditimit të brendshëm; Është dhënë opinion financiar dhe opinion mbi përputhshmërinë duke referuar standardet ndërkombëtare të auditimit ISSAI, ndërkohë sipas standardeve globale të auditimit të brendshëm, auditimi i brendshëm jep opinion mbi përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm; Dosja e auditimit nuk është e arkivuar.

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit nga Bashkia Berat është paraqitur observacioni me shkresën nr. 5325 prot., datë 26.08.2026, administruar në KLSH me praktikën nr. 547/3 prot., datë 04.09.2026, nga znj. R. Sh dhe z. Xh. M ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Observim nr. 1. Ne lidhje me konstatimin në Projekt Raportin e KLSH-së se: Për periudhën e vitit 2025, konstatohet se nuk jane mbuluar me auditim te gjitha njesitë e Bashkisë Berat, me risk të lartë, ku sipas përcaktimit të bërë në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm "Për sistemet të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpejtë, një herë në vit sqarojmë se:

Sqarojme se: Planifikimi ka qene mbi baze risku dhe se jane planifikuar për cdo vit njesitë që kanë risk të lartë, si Drejtoria e Prokurimeve Publike, Inspektoriati i Mbrojtjes se Territorit, Drejtoria e Bujqesise, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Veterinarisë, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Detyrimet e Prapambetura. Jane evidentuar ne planin strategjik 2025-2027 te gjitha njesite sipas risqeve qe paraqesin.

Per vitin 2025, jane programuar per auditim te gjitha njesite me risk te larte per te mbajtur frekuencen e auditimit sipas standarteve të auditimit, njesite me risk te larte auditohen një herë në vit, njesite me risk të mesem 2-3 vjet dhe njesite me risk te ulet një herë në 5 vjet.

Ndryshimet ne Programit e auditimit te vitit 2025, miratuar nga Titullari i Bashkise Berat me shkresen nr 6721 prot date 20.11.2025, njoftuar Drejtorine e Harmonizimit te Auditimit te Brendshem me shkresen nr 672/1 date 20.11.2025.

Sqarojme se ndryshimi i miratuar u krye, pasi Drejtoria e Prokurimeve dhe MZSH e programuar per auditim ne vitin 2025, po auditoheshin nga grupet e auditimit te KLSH-se respektivisht me Programin e KLSH-se nr 86/1prot, date 20.01.2025 per Prokurimet Publike, dhe Programi Tematik i KLSH-se nr 808/1 prot, date 28.07 2025 per auditimin e MZSH-së..

Ne keto kushte per te mos patur mbivendosje u auditua njesia qe ishin programuar per vitin 2026, me miratim te Titullarit te Bashkise Berat.

Observim nr 2. Në faqen 24, ne paragrafi i fundit të Projekt-Raportin e KLSH-së, ku behet fjalë "Njësia e auditimit të brendshëm nuk ka celur manualisht dhe elektonikisht dosjet e përherëshme mbi njësite e menaxhimit, në kundërshtim me paragrafin 6.3, Kreut 6 të Manualit të Auditimit të Brendshëm.";
Sqarojme se: Nga Njesia e Auditimit te Brendshëm e Bashkise Berat per cdo njesi te audituar eshte mbajtur dosja e perhereshme mbi auditimet e kryera.
Keto dosje ndodhen ne zyren e auditimit ku ndodhen raportet e auditimit sipas viteve, dokumentimi i fushave te audituara sipas ndarjes se detyrave, si dhe risqet e evidentuara sipas fushave, komponenteve te kontrollit dhe riskut rezultant sipas pikezimeve per cdo sistem, sipas formatit standart i sugjeruar për dosjen e përhereshme të auditimit.
Po keshtu elektronikisht mbahet ne foldera te vecante auditimet e kryera per cdo njesi sipas viteve te auditimeve.
Observim nr 3. Në faqen 25, ne paragrafi i parë të Projekt-Raportit të KLSH-së, ku thuhet:" Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm",
Sqarojme se: Ne programet e auditimit te perputhshmerise dhe financiar, janë trajtuar si pike e vecante analiza e 5 komponenteve te kontrollit te brendshem dhe jane trajtuar të 5 komponentet me qellim permerësimin e sistemit te kontrollit te brendshem për arritjen e objektivave te vendosura.
Qëndrimi i Grupit të Auditimit:
Në lidhje me observacionin nr.1 për auditimin me risk të drejtorive/sektorëve të Bashkisë Berat argumentat e paraqitura nga njesia e auditimit për auditimet e kryera gjatë vitit 2025 ***merret në konsideratë në hartimin e raportit të auditimit.***
Qëndrimi i Grupit të Auditimit:
Në lidhje me observacionin nr.2 për dosjet e dosjet e përherëshme të njësive të audituara ***merret në konsideratë në hartimin e raportit të auditimit.***
Qëndrimi i Grupit të Auditimit:
Në lidhje me observacionin nr.3 për auditimin për vlerësimin dhe monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm", dokumentohet se është kryer auditimi i 5 komponenteve te kontrollit te brendshem.
Sa më sipër merret në konsideratë në hartimin e raportit të auditimit.

Baza Ligjore:
-Ligji nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar;
-Manuali i Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar;

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:
-Për vitin 2025 nuk janë përfshirë dhe nuk janë audituar fusha të vlerësuara me risk të lartë.
-Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.
-Nuk zbatohen Standardet Globale të Auditit të Brendshëm (GIAS).

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. z. Xh. M, në cilësinë e Përgjegjës i Sektorit të Njësisë se Auditimit të Brendshëm.

2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.
2.2.1 Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor;
2.2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.
2.2.3 Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.
2.2.4 Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve;

2.1.1 Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

Nga auditimi i procesit të hartimit të PBA-së 2025-2027 dhe dokumentimit të hapave të ndjekura rezultoi se:

-Bashkia Berat ka paraqitur në Këshillin Bashkiak ***"Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027"*** i cili është miratuar me VKB nr. 109, datë 18.12.2024 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr.889/1 prot., datë 24.12.2024.

-Për realizimin e fazave të përgatitjes PBA është **ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik** (GMS) për PBA 2025-2027 me Urdhrin nr. 76 datë 17/05/2024.

-**Raporti për vlerësimin dhe parashikimin e të ardhurave afatmesme** nuk është paraqitur në Këshillin Bashkiak. Vlerësimi i të ardhurave nuk është paraqitur në Këshillin Bashkiak në kundërshtim me afatet e përcaktuar në pikën 58 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".*

-Për realizimin e fazave të përgatitjes PBA është **ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik** (GMS) për PBA 2024-2026 me Urdhrin nr. 44 datë 17/02/2023.

-**Tavanet Buxhetore** për PBA 2025-2027 janë paraqitur dhe miratuar me VKB nr.37, datë 29.04.2024 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 311/1 prot., datë 02.05.2024 në kundërshtim me afatet e përcaktuara në pikën 63 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".*

-Udhëzimi i Kryetarit për përgatitjen e buxhetit afatmesëm nuk është hartuar në kundërshtim me pikën nr. 64 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".* Kryetari i Njësisë Vendore 5 ditë pas miratimit të tavaneve buxhetore duhet të miratoj udhëzimin e përgatitjes së buxhetit të njësisë dhe duhet ta shpërndaj atë.

Përgatitja e dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm:

- PBA 2025-2027 **faza e parë** është dërguar në MF nëpërmjet sistemit SMBV në datën 04.06.2024. Nga Ministria e Financave janë dërguar rekomandimet me shkresën nr.prot.8592 datë 19.06.2024. Projekt dokumenti i fazës së parë të PBA 2025-2027 është paraqitur në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore nga kryetari i njësisë së bashku me mendimin zyrtar të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në kundërshtim me pikën nr. 76 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".*

Pas përfundimit të fazës së parë dhe pas rekomandimeve të MF, është dërguar nga MF udhëzimi plotësues nr. 9436/1 datë 08.07.2024 *"Për përgatitjen e PBA 2025-2027".*

- **Tavanet përfundimtare** të PBA 2025-2027 janë miratuar me VKB nr.56 datë 30.07.2024 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr.540/1 prot., datë 05.08.2024 në kundërshtim me ligjin nr.68/2017, neni 37, pika 1 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore" pika 79 "*Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim, brenda datës 15 korrik, tavanet përfundimtare në Këshillin e Njësive Vetëqeverisjes Vendore. Këshilli miraton tavanet përfundimtare brenda datës 20 korrik".*

- Faza e dytë e PBA 2025-2027

Kalendari i konsultimeve publike nuk është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak në kundërshtim me udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore" pika 82* " *Pas finalizimit të projektit të dokumentit të programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, kryetari i njësisë së*

vetëqeverisjes vendore merr masa për publikimin e tij dhe më pas organizon seanca dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit gjatë periudhës 1-15 shtator Procesverbalet e takimeve së bashku me qëndrimet përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore, behën pjesë e dokumentit të projektit të PBA".
Pika 84 "Pas reflektimit të sugjerimeve brenda datës 15 shtator, njësia e vetëqeverisjes vendore dërgon në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dokumentin e PBA të rishikuar, të miratuar nga këshilli i njësisë, së bashku me informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë fazës së parë".
- Faza e dytë e PBA 2025-2027 është miratuar me VKB nr. 76, datë 26.09.2024, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 682/1, datë 30.09.2024 dhe është dërguar në MF me shkresën nr. 4885, datë 16.09.2024.

PBA 2025-2027 dhe buxheti i vitit 2025 është miratuar me VKB nr. 108, datë 18.12.2024 për Bashkinë Berat. Në fazën përfundimtare duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor trevjeçar sipas programeve si për shpenzimet korente, ashtu edhe për investimet dhe të ardhurat.

Tabela 5: Programimi i shpenzimeve për vitin 2025-2027 Bashkia Berat dhe i detajuar sipas programeve paraqitet, sipas PBA.

000/lekë

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
		000/lekë	000/lekë	000/lekë
1	AA102 - Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse	180,429	182,043	185,249
2	AB102 - Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile	517,543	558,490	663,081
3	AC102 - Arsimi dhe Kujdesi Social	548,608	552,425	487,238
4	AD102 - Bujqësia, Administrimi i Pyjeve, Ujërave, Shërbimi Veterinar & Siguria Ushqimore	57,213	60,868	59,536
5	AE102 - Siguria dhe Mbrojtja e Territorit	89,735	92,398	94,260
6	AF102 - Turizmi, Kultura dhe Sportet	139,741	133,166	135,321
7	AG102 - Rezerva & Kontigjenca	12,000	14,000	16,000
Totali		**1,545,269**	**1,593,390**	**1,640,685**

Burimi: Punoi Grupi i Auditimit

Tabela 6: Planifikimi i shpenzimeve në PBA 2025-2027 sipas llogarive dhe peshës specifike që zënë ato në totalin e shpenzimeve parqiten në tabelën e mëposhtme:

000/lekë

Nr	Shpenzimet sipas llogarive	Viti 2025		Viti 2026		Viti 2027	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga (600)	725,194	46.9%	736,191	46.2%	748,375	45.6%
2	Sigurime (601)	120,446	7.8%	122,284	7.7%	122,882	7.5%
3	Shpenzime operative (602)	312,804	20.2%	321,341	20.2%	330,293	20.1%
4	Shpenzime (603)	29,000	1.9%	30,000	1.9%	30,000	1.8%
5	Shpenzime (604)	124,994	8.1%	126,080	7.9%	127,420	7.8%
6	Shpenzime (606)	6,500	0.4%	6,700	0.4%	7,000	0.4%
7	Shpenzime (609)	12,000	0.8%	14,000	0.9%	16,000	1.0%
	Shp. principal + interes						
8	Shpenzime për investime (230-231)	214,331	13.9%	236,795	14.9%	258,716	15.8%
Totali		**1,545,269**	**100%**	**1,593,390**	**100%**	**1,640,685**	**100%**

Burimi: Punoi Grupi i Auditimit

Tabela 7: Sipas PBA 2025-2027 Bashkia Berat tendenca e të ardhurave paraqitet në pasqyrën si më poshtë**:**

A	Të ardhurat	2025	2026	2027
1	Të ardhura të trashëguara	-	-	-
I	**Totali**	-	-	-
1	Nga taksat	637,974	646,481	651,975

A	Të ardhurat	2025	2026	2027
1	Të ardhura të trashëguara	-	-	-
I	**Totali**	-	-	-
II	**Totali**	**637,974**	**646,481**	**651,972**
1	Transferta e pakushtëzuar	545,223	583,602	624,144
2	Transfertë specifike	362,071	363,306	364,566
III	**Shuma e transfertave**	**907,294**	**946,909**	**988,710**
Totali I burimeve të veta (I +II+III)		**1,545,268**	**1,593,390**	**1,640,682**

Burimi: Punoi Grupi i Auditimit

Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2025.

Për vitin 2025, buxheti është miratuar me Vendim të KB nr.108, datë 18.12.2024, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 889/1 datë 24.12.2024.

Sipas VKB nr. 108 *"Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2025"* rezultoi se të ardhurat nga burimet e vete të planifikuara për vitin 2025 kanë vlerën **637,974 mijë lekë**, transferta e pakushtëzuar ka vlerën **545,224 mijë lekë**, transferta specifike ka vlerën **362,071 mijë lekë.**

I detajuar planifikimi i buxhetit fillestar për vitin 2025 paraqitet në vijim:

Tabela 8: Të dhënat mbi buxhetin fillestar

në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani fillestar i vitit 2025	
		Të ardhurat	Shpenzimet
1	Transferta e pakushtëzuar	545,224	-
2	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	362,071	-
3	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore + Institucionet e varësisë	637,974	-
4	Të ardhura të tjera	-	-
1	Shpenzime për paga (600)	-	725,194
2	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (601)	-	120,446
3	Shpenzime operative	-	312,804
4	Subvencione (603)	-	29,000
5	Transferta (604+606)	-	131,494
6	Fondi rezervë+Fondi I kontigjencës (609)	-	12,000
7	Shpenzimet kapitale (230+231)	-	214,331
8	Principali+Interesi I kredisë (166+651)	-	
Total		**1,545,269**	**1,545,269**

Burimi: *Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, përpunuar nga grupi i auditimit*

Rezultoi se buxheti i konsoliduar është miratuar i balancuar dhe pa deficite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën **1,545,269 mijë lekë**.

Planifikimi i shpenzimeve kapitale për vitin 2025 është bërë si vijon:

Gjatë vitit 2025 sipas VKB Nr.108, datë 18.12.2024 janë parashikuar shpenzime kapitale në vlerën 214,331 mijë lekë të cilat do të financohen nga të ardhurat e veta dhe transferta e pakushtëzuar.

-Likuidime për investime të përfunduara për të cilat janë akumuluar detyrime të prapambetura është parashikuar të likuidohet shuma 753 mijë lekë. Investime të reja të planifikuara gjatë vitit 2025 janë në vlerën 213,578 mijë lekë.

Tabela 9: Investimet e parashikuara për periudhën 2025-2027 me mbulim nga transfertat e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta.

000 lekë

Nr	Emri i programit/objektit	Origjina e te ardhures	Fondi limit	2025	2026	2027
1	Hartim projekte, studime, oponenca teknike, VNM	Te ardhurat(05)	169,355	37,098	45,000	45,000
2	Investime të reja në infrastrukturën rrugore përfshirë shp. për supervizime, kolaudime, shpronësime	Te ardhurat(05)	316,384	54,930	66,045	156,216
3	Përmirësimi i banesave për komunitete të varfëra e të pafavorizuara, bashkëfinancim me MSH	Te ardhurat(05)	79,019	20,000	20,000	20,000
4	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare "22Tetori" dhe parkim nëntokësor, bashkëfinancim me MAS	Te ardhurat(05)	178,926	80,000	73,926	0

5	Ndërtim i fushave sportive, bashkëfinancim me FSHF	Te ardhurat(05)	26,000	10,000	0	0
6	Mjet për shërbimet mbështetëse të bashkisë	Te ardhurat(05)	4,500	2,000	0	0
7	Fond per Bashkefinancime ne projekte me financim te huaj ne fushen e sherbimeve publike	Te ardhurat(05)	28,000	2,000	12,000	14,000
8	Sistemim i ambienteve te jashtme ne godinat arsimore te arsimit parauniversitar	Te ardhurat(05)	4,100	2,400	1,700	0
9	Shërbimi i Stafit të Administrim & Menaxhim	Te ardhurat(05)	0	1,500	2,500	2,000
10	Shërbimi i Borxhit	Te ardhurat(05)	0	1,602	319	0
11	Fëmijë që Frekuentojnë Ļerdhet	Te ardhurat(05)	0	500	403	200
12	Objekte të Arsimit Baze dhe Parashkollor të Mirëmbajtura dhe Funksionale	Te ardhurat(05)	0	1,900	1,300	800
13	Objekte te Arsimit të Mesëm të Mirëmbajtura dhe Funksionale	Te ardhurat(05)	0	200	0	0
14	Funksionimi i Bibliotekës	Te ardhurat(05)	0	200	1,000	1,500
Total Investime			**806,286**	**214,331**	**224,195**	**239,716**

Burimi: Bashkia Berat

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit sipas miratimit me Vendim të Këshillit të Bashkisë, ndryshimet gjatë vitit, analiza e tyre sipas artikujve, arsyet e këtyre ndryshimeve.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës specifike dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për
funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësimi). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

-Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë të raportuara periodikisht pranë Degës së Thesarit. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

-Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit.

Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregon se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla.

Gjatë vitit 2025 janë miratuar disa vendime të tjera të Këshillit Bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë.

Në aneksin 2/2/1 në anekset e raportit të auditimit është paraqitur tabela me të dhënat përmbledhëse për planifikimin e buxhetit dhe ndryshimet për vitin 2025 sipas VKB-ve.

Në aneksin 2/2/2 në anekset e raportit të auditimit është paraqitur tabela me të dhënat përmbledhëse për planifikimin e buxhetit sipas burimeve të të ardhurave dhe ndryshimet për vitin 2025 dhe ndryshimet sipas VKB-ve.

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.

Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Berat, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv buxhetor, të miratuar me Vendim të KB, apo nga ndryshimet e transfertave të pakushtëzuara sektoriale nga pushteti qendror, nga auditimi i shkresave, evidencave të çeljeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me degën e Thesarit Berat, u konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore.

Në aneksin 2/2/3 në anekset e raportit të auditimit është paraqitur informacioni për realizmin e buxhetit të Bashkisë Berat dhe Njësive shpenzuese të tjera.

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërm, niveli i realizmit të treguesve të buxhetit:

Për **vitin 2025** fondet buxhetore janë realizuar 2,385,853 mijë lekë nga 2,085,479 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 87 %. Në këtë masë realizimi ka ndikuar mosrealizimi në zërat e buxhetit:

Shpenzimet për investime llog. 230-231 janë realizuar ne masën 62%.

-Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre:

Për **vitin 2025** janë **planifikuar** fonde për investime nga të ardhurat e Bashkisë Berat në shumën ***264,583 mijë lekë*** (të cilat janë nga grant i pakushtëzuar + transferta sektoriale + të ardhura) dhe janë ***realizuar në vlerën 112,743 mijë lekë, ose në masën 42%***.

Tabelë nr.10: Tabela e përgjithshme e buxhetit (shpenzimet) e përmbledhur:

Në 000/lekë

Shpenzimet sipas llogarive ekonomike	Plani vjetor fillestar 2025	Plani perfundimtar 2025	Plani i celur 2025	Realizimi i shpenzimeve 2025	% e realizimit/ planit vjetor
Shpenzime për paga (600)	819,978	744,978		693,850	93%
Shp. për sig shoq e shëndetësore (601)	136,594	122,974	826,450	113,939	93%
Shpenzime operative (602)	331,677	482,322		434,314	90%
Subvencione (603)	29,000	29,000		26,800	92%
Transferta tek organizatat (604)	125,000	124,994		98,348	79%
Transferta tek individët (606)	10,800	461,017	1,061,605	457,215	99%
Fondi rezervë+e kontigjencës (609)	14,000	7,256		-	
Fondi e Emergjences	-	17,216		16,756	97%
Shpenzime Principali (166)	-	-			
Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendeshme(255)	319	1,602		1,300	81%
Shpenzime per Oponenca teknike (230)	35,000	41,898		152	0.4%
Shpenzime per Investime (231)	160,451	352,593	265,029	242,799	69%
a.Nga te ardhurat e transf e pakushtez, specifike	1,662,819	1,759,789	1,527,021	1,461,688	83%
b.Nga Ministrite linjes	-	626,063	626,063	623,789	100%
Total Bashki + Institucione	**1,662,819**	**2,385,853**	**2,153,085**	**2,085,478**	**87%**

Burimi: *Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, përpunuar nga grupi i auditimit*

Në aneksin 2/2/4 në anekset e raportit të auditimit është paraqitur tabela e investimeve te financuara gjate vitit 2025 me të ardhurat e veta.

Në aneksin 2/2/5 në anekset e raportit të auditimit është paraqitur tabela e investimeve te financuara gjate vitit 2025 nga buxheti i shtetit.

Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Berat së bashku me transfertat e pakushtëzuara dhe specifike, për vitin 2025 kanë diferenca me vlerën e planifikuar.
Për vitin 2025 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 2,385,853 mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën 2,085,478 mijë lekë, ose në masën 87 %.
Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2024 investimet me të ardhurat e veta janë planifikuar në vlerën 229,665 mijë lekë, realizuar 112,742 mijë lekë, ose në masën 49%.
Ky mos realizim vjen si rezultat i mospasjes së fondeve në llogarinë e thesarit në momentin e lidhjes së kontratës Bashkia Berat në fillim të vitit buxhetor duhet të planifikohen angazhime buxhetore realiste.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ku thuhet:
"*Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji".*

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës, emergjencë.

a. Fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës.

Për vitin 2025 fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës është planifikuar në total në shumën 12,000 mijë lekë, i cili është miratuar në buxhetin fillestar me VKB nr. 108 datë 18.12.2024 *"Për miratimin e buxhetit vjetor 2025 dhe PBA 2025-2027"*, dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 889/1 datë 24.12.2024.

b. Fondet e emergjencës.

Për vitin 2025 me shkresën nr. 492/1, datë 25.02.2025, të ardhur nga Ministria e Mbrojtjes, (AKMC), *"Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile"* Bashkisë i është akorduar *fondi në vlerën 11,521 mijë lekë.*
Me shkresën nr. 1016/1, datë 27.05.2025, të ardhur nga Ministria e Mbrojtjes, (AKMC), *"Mbi aplikimin ne programin emergjencat civile 2025"* Bashkisë i është akorduar fondi në vlerën 6,720 mijë lekë për blerje fadrome.
Fondi i emergjencave është planifikuar me VKB nr. 49 datë 26.06.2025, VKB nr.75 datë 20.10.2025 ,VKB nr. 90 datë 04.12.2025 dhe VKB nr.91 date 04.12.2025 është bërë miratimi i përdorimit të fondeve të lira të paraqitura **në tabelën nr.11**:

Në lekë

Nr	Emërtimi i shpenzimeve	Shuma e planifikuar	Përdorimi	Mbetja
1	Mure mbajtës	9,296,824	6,710,889	266,122
2	Blerje uniformash për shërbimin zjarrfikës	777,600	777,600	0
3	Ndërtim muri guri mbajtës lagja Muzakaj, rajoni 1	868,440	868,440	0
4	Ndërtim muri guri mbajtës rruga Uzgurliu, rajoni 2	684,000	683,965	35
5	Ndërhyrje rehabilituese te mureve mbajtëse dhe terrene ne territorin e Bashkisë Berat(mbetje fature 2024)	117,030	116,160	870
6	Blerje mjeti fadrome	6,720,000	6,720,000	0
7	Mbështetje financiare për S. Q	879,701	879,701	0
8	Mbështetje financiare të shtetasit L. Z	155,915		155,915
9	Diference nga prokurimet	37,034		37,034
Total		**17,216,731**	**16,756,755**	**459,976**

Burimi: *Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, përpunuar nga grupi i auditimit*

Gjatë vitit 2025 nga fondet e bashkisë janë përdorur edhe 390,733 lekë nga plani 2,533,052 lekë për ndihmë financiare familjeve të dëmtuara nga zjarri. Këto fonde jepen të detajuara si më poshtë:
- Me VKB nr.13 datë 05.03.2025 për dhënien e ndihmës financiare z. K. Gj. për dëmet e shkaktuara nga zjarri në banesën e tij në vlerën 390,733 lekë.

Raportet e monitorimit për zbatimin e buxhetit

Për vitet 2025 janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit e tyre në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* neni 6 dhe me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, *"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore"* pikat 10, 12, 28, 29, 48.
Për vitet 2025 janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit e tyre në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" neni 6 dhe me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore" pikat 10, 12, 28, 29, 48.

Për vitin 2025 janë dërguar në MFE raportet e detajuara si më poshtë:
"Raport monitorimi Janar-Prill 2025" me e-mail datë 30.05.2025.
"Raport monitorimi Janar-Gusht 2025" me e-mail datë 30.09.2025.
"Raporti i monitorimit Janar-Dhjetor 2025" me e-mail datë 27.02.2026.

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve:

Bashkia Berat në datën 01.01.2025 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta dhe granti në vlerën 66,204 mijë lekë. Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2025 është planifikuar për likuidim vlera 22,186 mijë lekë si më poshtë.

Tabela nr. 12: Informacion për planifikimin e likuidimit të detyrimeve të prapambetura.

Periudha	Detyrimet në fund të periudhës viti 2024	Vlera e detyrimeve të planifikuara	VKB nr. /datë	Llog 602+606	Llog. 230+231
Viti 2025	66,204,480	17,186,364	VKB nr.23 date 05.03.2025	16,432,443	753,921
		5,000,000	VKB 106 date 31.12.2025	5,000,000	

Burimi: *Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, përpunuar nga grupi i auditimit*

Gjatë vitit 2025 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 107,274 mijë lekë dhe janë likuiduar detyrime në vlerën 66,204 mijë lekë. Totali progresiv i detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2025 është në vlerën 107,274 mijë lekë.

Tabela Nr. 13: Të dhëna të hollësishme për detyrimet e prapambetura më 31.12.2025:

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2024	Detyrimi i krijuar në periudhën 01/01/2025 – 31.12.2025	Total detyrime	Shlyerja e detyrimeve 2025	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2025
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Ministritë e linjës e FZHSH		4,706,400	4,706,400	-	4,706,400
b. Investime nga Bashkia	16,496,784	15,742,863	32,239,647	16,496,784	15,742,863
INVESTIME :			-	-	
Mallra dhe shërbime	1,159,850	1,274,580	2,434,430	1,159,850	1,274,580
Vendime gjyqësore	48,547,846	85,550,791	134,098,637	48,547,846	85,550,791
Totali :	**66,204,480**	**107,274,634**	**173,479,114**	**66,204,480**	**107,274,634**

Burimi: *Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, përpunuar nga grupi i auditimit*

Për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025 nga analiza e këtyre detyrimeve, të paraqitura në tabelën e mëposhtme rezultojnë që në fund të vitit 2025 janë të palikuiduara gjithsej 21 fatura me vlerë 102,568 mijë lekë**.**

Në aneksin 2/2/6 në anekset e raportit të auditimit paraqiten detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2025.

Detyrimet e prapambetura për vitin 2025 të paraqitura në Ministrinë e Financave me shkresën nr.1364 prot., datë 27/02/2026 jepen në tabelën si më poshtë:

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit nga Bashkia Berat është paraqitur observacioni me shkresën nr. 5325 prot., datë 26.08.2026, administruar në KLSH me praktikën nr. 547/3 prot., datë 04.09.2026, nga znj. R. Sh dhe z. Xh. M ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me gjetjen dhe rekomandimin 6.1, sqarojmë se vlera e provigjioneve për çështjet gjyqësore në pasqyrat financiare të vitit 2025 rezulton 0, pasi Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk ka disponuar informacion të përcjellë nga struktura përgjegjëse për ndjekjen e çështjeve gjyqësore, mbi çështjet gjyqësore në proces dhe vlerësimin e probabilitetit të humbjes së tyre, si dhe detyrimet financiare që mund të lindin prej tyre.

Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, në mungesë të këtij informacioni, nuk ka pasur bazën e nevojshme për të bërë vlerësimin dhe regjistrimin e provigjioneve përkatëse.

Për sa më sipër, kërkojmë që në vlerësimin e gjetjes të merret në konsideratë se mungesa e provigjioneve të regjistruara nuk ka ardhur nga mosvlerësimi i tyre nga ana e strukturës financiare. por nga mungesa e informacionit të nevojshëm nga struktura përgjegjëse për ndjekjen e proceseve gjyqësore të Bashkisë.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në lidhje me observacionin e mësipërm subjekti nuk e kundërshton gjetjen, por evidenton mungesën e bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet strukturave përgjegjëse, si dhe mungesën e përcjelljes së informacionit të nevojshëm për vlerësimin dhe regjistrimin e provigjioneve. ***Sa më sipër observacioni i mësipërm nuk merret në konsideratë në hartimin e raportit të auditimit.***

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit nga Bashkia Berat është paraqitur observacioni me shkresën nr. 5325 prot., datë 26.08.2026, administruar në KLSH me praktikën nr. 547/3 prot., datë 04.09.2026, nga znj. R. Sh dhe z. Xh. M ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me gjetjen dhe rekomandimin 5.1, Bashkia Berat sqaron se shlyerja e detyrimeve të prapambetura është konsideruar prioritet gjatë procesit të planifikimit dhe përdorimit të fondeve buxhetore. Megjithatë, vlerësojmë se ekzistenca e një stoku detyrimesh në fund të vitit nuk mund të konsiderohet, në vetvete, tregues i mosrespektimit të këtij prioriteti, pa u marrë në konsideratë natyra dhe rrethanat konkrete të detyrimeve.

Në stokun e detyrimeve në datën 31.12.2025 përfshihen detyrime të viteve të mëparshme, për të cilat likuidimi nuk mund të realizohet vetëm nëpërmjet planifikimit të fondeve, pasi ekzistojnë pengesa juridike, kontraktore ose dokumentare.

Konkretisht, 15,742,863 lekë detyrime për investime të viteve 2017-2019 lidhen me situacione përfundimtare për të cilat mungon akti i marrjes në dorëzim të objekteve nga strukturat përgjegjëse, për shkak të problematikave në zbatimin e kontratave. Në mungesë të dokumentacionit të plotë justifikues, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të të Ardhurave nuk mund të kryejë likuidimin e tyre.
Gjithashtu, detyrimi prej 987,350 lekë, për blerje ushqimesh për kopshte dhe çerdhe, vijon të jetë objekt i procesit gjyqësor me operatorin MB, për shkak të mosrespektimit të kushteve kontraktore.
Në rastin e detyrimit gjyqësor në favor të R. Ç dhe Sh. I, likuidimi ka filluar që në vitin 2023 dhe ka vijuar në vitet pasardhëse, konkretisht 100,000 lekë në 2023, 3,000,000 lekë në 2024 dhe 21,432,443 lekë në 2025, në total 24,532,443 lekë, ndërsa pjesa e mbetur është planifikuar të shlyhet gjatë viteve 2026-2027. Ky rast tregon se, për detyrimet gjyqësore me vlera të konsiderueshme, shlyerja e plotë brenda një viti buxhetor nuk mund të parashikohet domosdoshmërisht, por mund të planifikohet në disa vite.
Për detyrimet që lidhen me 7 përfituesit e vendimit gjyqësor, dokumentacioni për ekzekutimin e tyre është protokolluar në Bashki më 07.11.2025, ndërkohë që gjatë vitit 2025 janë kryer likuidime në shumën 10,000,000 lekë.
Për sa më sipër, kërkojmë që në vlerësimin e rekomandimit 5.1 të merret në konsideratë se detyrimet e mbetura në stok nuk kanë të njëjtën natyrë dhe se moslikuidimi i plotë i tyre nuk mund t'i atribuohet mosprioritizimit gjatë planifikimit buxhetor. Për një pjesë të tyre likuidimi kushtëzohet nga dokumentacioni i nevojshëm, proceset gjyqësore dhe problematikat kontraktore, ndërsa për detyrimet gjyqësore me vlera të konsiderueshme shlyerja është planifikuar dhe realizuar në mënyrë të shtrirë në disa vite.
Qëndrimi i Grupit të Auditimit:
Në lidhje me observacionin e mësipërm argumentet e paraqitura nga Bashkia Berat merren pjesërisht në konsideratë, pasi dokumentacioni i administruar evidenton se një pjesë e detyrimeve të prapambetura lidhet me mungesë dokumentacioni, pengesa kontraktore ose procese gjyqësore, të cilat ndikojnë në mundësinë dhe afatin e likuidimit të tyre. Për detyrimet me pengesa juridike, kontraktore ose dokumentare, Bashkia duhet të marrë masa për zgjidhjen e problematikave përkatëse dhe, pas plotësimit të kushteve të nevojshme, të procedojë me likuidimin e tyre. Për pjesën tjetër të detyrimeve, për të cilat nuk ekzistojnë pengesa, duhet të vijojë likuidimi sipas planifikimit buxhetor dhe radhës së krijimit. ***Sa më sipër observacioni i mësipërm merret pjesërisht në konsideratë në hartimin e raportit të auditimit.***

Tabela Nr. 14: Stoku i borxhit i raportuar në MFE

Në lekë

		Viti 2025		
Nr	**Emërtimi**	**Stoku në vlerë ne fund te vitit 2025**	**Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në**	**Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së**
I	**Borxhe (a+b)**			
a	**Hua afatgjatë**			
a.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
a.2	Tituj të emetuar			
a.3	Garanci për të tretë			
b	**Hua afatshkurtër**			
b.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
b.2	Tituj të emetuar			
b.3	Garanci për të tretë			
II	**Detyrimet e prapambetura**	**102,568,234**		**2.9**
Llogaria ekonomi	**Emërtimi**			
4864100	Vendime Gjyqesore	85,550,791		
4864200	Det.Prap. Sherbime	269,230		
4864201	D.P.Eneri Elektirke			
4864300	Det.Prap.Mirembajtje			
4864400	Det.Prap. Investime	15,742,863		
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra	1,005,350		
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet			

4864603	Det.Prap.Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronesime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet			
III	**Totali (I+II)**	**102,568,234**	**1,461,688,971**	**7,02**

Burimi: *Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, përpunuar nga grupi i auditimit*

Tabela Nr. 15: Efektet financiare në buxhet, si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore.

	Numri i vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2025	**Vlera e vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2025**	**Numri i vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2025**	**Vlera e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2025**	**Pagesa në lekë të kryera gjatë vitit 2025**	**Detyrimi në lekë më 31.12.2025**
Dëmshpërblim page për punonjësit e larguar nga puna	-	-	12	18,422,729	12,390,319	6,032,410
Te tjera	1	48,547,846	3	68,651,448	31,648,503	85,550,791

Burimi: *Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, përpunuar nga grupi i auditimit*

Në aneksin 2/2/7 në anekset e raportit të auditimit paraqiten lista e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë dhe likuidimet e kryera prej saj për mbi pagesat e vendimet gjyqësore për çështje të tjera të ndryshme viti 2025.

Gjatë vitit 2025 janë shpenzuar 12,390,319 lekë për 10 (dhjetë) vendime gjyqësore me objekt dëmshpërblim page dhe 3 (tre) vendime gjyqësor me vlerë 31,648,503 lekë me objekt dëmshpërblim shpronësimi dhe dëmi..Fondet e shpenzuara janë nga të ardhurat e veta të Bashkisë Berat.

Vlera totale **44,038,822 lekë** e shpenzuar për periudhën 01.01.2024- 31.12.2025 nga Bashkia Berat për zbatimin e vendimeve gjyqësore, **konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet.**

Bashkia Berat në fund të vitit 2025 ka detyrime për vendime gjyqësore në vlerën 91,583,201 lekë. Referuar të ardhurat e Bashkisë Berat për vitin 2025 sipas buxheti fillestar në vlerën 1,545,268,802 lekë vlera e detyrimeve për vendime gjyqësore zë 6% të buxhetit.

Në aneksin 2/2/8 në anekset e raportit të auditimit paraqiten çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR dhe Ministrive të linjës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

1. z. E. C në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Berat
2. znj. R. Sh me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave

2.5. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të paarkëtuara progresive dhe për vitin buxhetor.

- **<u>Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore:</u>**

Për vitin 2025 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me Vendimin nr.857, datë 06.12.2024, *"Për miratimin e strukturës dhe organigramës së Bashkisë dhe të njësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat vitin 2025",* i ndryshuar, ku përfshihet edhe struktura e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave, e cila sipas strukturës është e përbëre nga sektorë dhe në total ka 18

(tetëmbëdhjetë) punonjës 1(një) është Përgjegjës për Taksat dhe Tarifat, 3 (tre) janë specialistë të vlerësimit të taksave dhe tarifave të biznesit, 2 (dy) janë specialistë për inspektimin, kontrollin tatimor në terren, 2 (dy) punonjës specialist për mbledhjen dhe monitorimin e borxhit, 1 (një) është specialist i vlerësimit të taksave dhe tarifave për ambulantet, institucionet dhe parkimin, 3 (tre) janë specialist për taksat dhe tarifat në lagje, 4 (katër) janë specialistë për taksat dhe tarifat në Njësitë Administrative, 1 (një) punonjës për të ardhurat të Tregut Industrial. respektivisht aneksi si vijon:
Struktura e Drejtorisë të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025 është paraqitur si më poshtë:

Tabelën nr. 16: Struktura e Drejtorisë të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025

Nr.	Emri Mbiemri	Funksioni Sipas Strukturës	Lloji i shkollës	Urdhri i emërimit Nr., datë	2025
1		Drejtor			
2	D. B	Përgjegjës	Ekonomik		
3	O L	Specialist i Vleresimit te Taksave dhe Tarifave te Biznesit	Ekonomik		
4	T. E	Specialist i Vleresimit te Taksave dhe Tarifave te Biznesit	Ekonomik	Nr.448 date 18.04.2017	
5	K. Gj	Specialist për Inspektimin, Kontrollin Tatimor ne Terren	Ekonomik		
6	E. C	Specialist për Inspektimin, Kontrollin Tatimor ne Terren	Ekonomik	Nr.423 date 26.10.2015	
7	G. T	Specialist i Vleresimit te Taksave dhe Tarifave te Biznesit	Ekonomik		
8	L. M	Specialist për mbledhjen dhe monitorimin e borxhit	Ekonomi Agrare	Nr.204 date 30.03.2020	
9	L. T	Specialist për mbledhjen dhe monitorimin e borxhit	Ekonomik	Nr.470 datë 25.08.2022	
10	G. Xh	Specialist i vleresimit te taksave dhe tarifave për ambulantet, institucionet dhe parkimin	Ekonomi Agrare	Nr.623/ 31.12.2015	
11	Rr. D	Specialist për taksat dhe tarifat ne lagje	Ekonomik	Nr.191 date 30.03.2020	
12	S. R	Specialist për taksat dhe tarifat ne lagje	Menaxhim Biznesi	Nr.203 date 30.03.2020	
13	F. Z	Specialist për taksat dhe tarifat ne lagje			
14	G. Q	Specialist për taksat dhe tarifat ne Njësinë Administrative Otllak	Ekonomik	Nr.192 date 05.03.2019	
15	M H	Specialist për taksat dhe tarifat ne Njësinë Administrative Velabisht	Ekonomi Agrare	Nr.250/2 date 06.08.2015	
16	H. .A	Specialiste për Taksat dhe Tarifate Njësinë Administrative Roshnik	Shkenca-Juridike	Nr.105 date 16.01.2017	
17	Xh D	Specialiste për Taksat dhe Tarifate Njësinë Administrative Sinje			
18	M. H	Punonjes i te Ardhurave te Tregut Industrial	Mercolog Ushqimor	Nr.69 date 29.01.2021	

Burimi: Bashkia Berat

Struktura e Drejtorisë të taksave dhe tarifave vendore, Bashkisë Berat nuk ka probleme dhe është në funksion të realizmit e të ardhurave.

- **<u>Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:</u>**

Për vitin 2025, Bashkia Berat nuk ka miratuar paketë të re fiskale por ka ushtruar aktivitetin me paketën fiskale të vitit 2022, miratuar me VKB nr. 93, datë 28.12.2021, e konfirmuar nga Prefekti. Nga të dhënat e tabelës nr.17 më poshtë, shihet se për vitin 2025 të ardhurat nga 637,974 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 532,165 mijë lekë ose 83%, për shkak të mosrealizimit në zëra të veçantë si, taksa e ndikimit në infrastrukturë, të ardhura nga pronësia etj.
-Bazuar në VKB nr.93 datë 28.12.2021 "*Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Beratit"* i ndryshuar, janë përcaktuar në mënyrë specifike drejtoritë përgjegjëse dhe pesha e tyre specifike në planifikimin e të ardhurave dhe mbledhjen e tyre si më poshtë:
Tabela nr.17: Drejtoritë përgjegjëse dhe pesha e tyre specifike.

Nr.	Strukturat përgjegjëse	Në %	Plani në 000/lekë
1	Agjentet Tatimore	8%	49,790
2	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave	56%	360,054
3	Drejtoria E Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Shërbimeve	6%	37,650
4	Drejtoria E Planifikimit Urban, Lejeve Dhe Monitorimit Të Investimeve	12%	74,817
5	Drejtoria Bujqsise,Administrimit te Pyjeve,Ujerave dhe Sherbimit Veterinar	11%	69,243
6	Tarifa te Drejtorise Ekonomike te Arsimit	3%	20,897
7	Tarifa te Pallatit te Kultures dhe Bibliotekes	0%	24

8	Te ardhura nga MZSH	0%	500
9	Agjencia e sherbime publike	1%	7,600
10	Të tjera	3%	17,400
Totali		**100%**	**637,974**

Burimi: Bashkia Berat

Për vitin 2025, ka pasur mos realizim në vlerën 105,809 mijë lekë, kryesisht në taksat e popullatës, si p.sh. taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, taksa e ndërtesës dhe tarifa e pastrim-gjelbërimit.

Nga intervistat e zhvilluara me punonjësit e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave drejtori që mbulon një pjesë të taksave dhe tarifave vendore, rezultoi se faktorët kryesorë të mos realizimit për taksat që ata ngarkohen nga VKB – ja janë:

- Niveli ekonomiko-financiar i familjeve;
- Emigrimi dhe migrimi;
- Probleme të pronësisë.

Edukimi fiskal i komunitetit për pagesën e taksave dhe tarifave vendore. Komuniteti nuk është ndërgjegjësuar për pagesën me vullnet të lirë të detyrimeve vendore.

Për periudhën e audituar, evidencat e rakordimeve me thesarin janë nënshkruar nga: Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë znj. A. T, Drejtoresha e Financës znj. R. Sh, Specialiste e Financës znj. L. C, Specialiste e të Ardhurave dhe Bankës znj. A. Dh si dhe znj. A. R, në cilësinë e specialistes të Degës së Thesarit Berat.

Referuar planit vjetor të miratuar dhe aktrakordimeve me Degën e Thesarit Berat, parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për vitin 2025 janë paraqitur të detajuara në:

Tabela nr.18: Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për vitin 2025.

Në 000/lekë

Nr.	Emertimi	Plani 2025	Fakti 2025	Realizimi ne % Kundrejt Planit 2025
I	**Agjentet Tatimore**	49,790	87,151	175%
1	Te ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	15,000	39,222	261%
2	Takse e kalimiti te drejtes se pronsise (ZRPP)	3,215	2,705	84%
3	Takse e mjeteve te perdorura	31,395	45,216	144%
4	Taksa e rentës minerare	180	7	4%
II	**Drejtoria e Taksave dhe Tarifave**	360,054	283,754	79%
1	Takse tabele	2,665	1,829	69%
	Tabelë për qëllime identifikimi	2,045	1,040	51%
	Tabelë për qëllime reklamimi	620	245	40%
2	Te ardhura nga zenia e hapsirave publike	17,441	15,699	90%
3	Takse fjetje ne hotel	7,205	6,533	91%
4	Takse mbi token bujqesore	18,862	6,148	33%
5	Takse mbi ndertesat	53,784	47,210	88%
	Biznes	26,231	23,135	88%
	Familje	27,553	24,075	87%
6	Takse trualli	7,953	6,549	82%
	Biznes	6,848	6,158	90%
	Familje	1,105	391	35%
7	Tarife e pastrimit	106,306	85,258	80%
	Biznes	59,186	57,231	97%
	Familje	47,120	28,027	59%
8	Tarife e ndriçimit publik	47,962	37,445	78%
	Biznes	19,279	17,992	93%
	Familje	28,684	19,454	68%
9	Tarife gjelberimi publik	40,431	32,401	80%
	Biznes	13,237	12,313	93%
	Familje	27,195	20,088	74%
10	Tarife Arsimi publik	10,960	8,608	79%
	Biznes	4,642	4,669	101%
	Familje	6,317	3,939	62%
11	Te tjera tarifa(Ambjenti)	1,021	965	95%
12	Tarife për linjat ajerore nentokesore (Kablloret)	828	1,909	231%
13	Te ardhura nga parkimi	3,149	7,303	232%
14	Debitore Familje	19,459	18,934	97%
15	Debitore Biznesi	22,028	6,964	32%
III	**Drejtoria E Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Shërbimeve**	37,650	40,465	107%

1	Tarife për license /certifikate për transport rrugor	5,298	6,183	117%
2	Te ardhura nga qerate	29,552	34,282	116%
3	Debitore	2,800	-	0%
IV	**Drejtoria E Planifikimit Urban, Lejeve Dhe Monitorimit Të Investimeve**	74,817	75,286	101%
1	Tarife urbanistike	697	2,886	414%
2	Taksa e Ndikimit ne infrastukture nga ndertimet e reja	74,120	72,399	98%
V	**Drejtoria Bujqsise,Administrimit te Pyjeve,Ujerave dhe Sherbimit Veterinar**	69,243	3,988	6%
1	Tarife për lende drusore	2,435	489	20%
2	Tarife ujitje	3,182	1,502	47%
3	Te tjera te ardhura nga pronesia	63,626	1,997	3%
VI	**Tarifa te Drejtorise Ekonomike te Arsimit**	20,897	16,315	78%
1	Te ardhura nga konviktet	2,925	1,061	36%
2	Te ardhurat për regjistrim	1,500	2,997	200%
3	Te ardhura nga kopshtet dhe cerdhet	16,472	12,257	74%
VII	**Tarifa te Pallatit te Kultures dhe Bibliotekes**	24	-	0%
1	Tarfia per zenie salle dhe dheniie ambjentesh me qera	24	-	0%
VIII	**Te ardhura nga MZSH**	500	928	186%
IX	**Te tjere debitore (gjyqe dhe klsh)**	**6,700**	**5,916**	**88%**
X	**Agjencia e sherbime publike**	**7,600**	**7,020**	**92%**
1	Tarifa e sherbimit te varrimit	7,600	7,020	92%
XI	**Te ardhura te priteshme nga bashkefinancimet e huaja**	**10,700**	**11,343**	**106%**
Totali		**637,974**	**532,165**	**83%**

Burimi: Bashkia Berat

Referuar pasqyrës më sipër, konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulëta dhe për disa taksa dhe tarifa të tjera realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve, e cila kryesisht vjen për shkak të mosnjohjes së situatës dhe moskryerjes së rregullt të procedurave, gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave.

Në këtë konkekst, është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Berat, që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme, në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të bëhet mbi baza sa më reale, për të mos shkaktuar defiçit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve, etj, në dëm të interesave të publikut.

- **<u>Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:</u>**

Në rregulloren e brendshme të institucionit nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me ta.

Të ardhurat nga agjentët tatimorë (*Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, në lidhje me TFTH; Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me rentën minerare; AKSH-ja, në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Berat, në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura*) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të bashkisë Berat dhe konfirmohen nga Dega e thesarit Berat. Gjithashtu Bashkia Berat, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të paarkëtuara apo të shmangura sipas Në nenin 117[4] të ligjit nr. 9920, dt.

[4] "Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, agjenti i taksave apo tarifave, që nuk arrin të mbajë, të llogarisë, të raportojë dhe të transferojë në Buxhetin e Shtetit tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe tarifat e mbledhura, apo i shmanget mbledhjes së tyre, detyrohet të paguajë gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës së pambledhura apo të shmangur."

19.5.2008, "*Për Procedurat Tatimore*", ku parashikohet se "*Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave*".
Pjesa më e rëndësishme e të ardhurave që vilen me agjentët tatimorë është Ujësjellës-Kanalizime. Është shumë e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave ka pasur përmirësime pas kontraktimit me Agjentin Tatimor.
Konstatojmë se Bashkia Berat, mos arkëtimet nga ana e Drejtoria Rajonale Vendore ASHK Berat, janë për shkak të anashkalimit të arkëtimit të këtyre detyrimeve për taksën e infrastrukturës, për të cilat nga Bashkia Berat është kërkuar vazhdimisht në rrugë zyrtare që të mos i kryejnë veprimet e regjistrimit të pronës nga këto lloj subjektesh, pa paraqitur dokumentin e pagesës së kësaj takse. Për sa më sipër, Bashkia Berat duhet të fillojë procedurat për të gjobitur Agjentin Tatimor ASHK në zbatim të dispozitës së mësipërme.
-Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet nuk është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorin e Doganave dhe mbahet korrespondencë me Ministrinë e Financave.
-Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, mbahet korrespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 7 "*Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit*" dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, neni 15 "*Parapagimi*", si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 "*Për taksat Kombëtare*". Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë gjatë periudhës së audituar janë paraqitur në:
Tabelën nr. 19: Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë.

000/lekë

Agjenti Tatimor	**Lloji I Taksës**	**2025**
Drejtoria Rajonale e Tatimeve	Te ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	39,222
Drejtoria Rajonale të Shërbimeve te Transportit Rrugor	Taksa e mjeteve të përdorura të transportit	45,216
Shoqëria Rajonale Ujsjellës Kanalizime Berat Sh.a	Tarifat/ gjelbërim, ndriçim, pastrim, arsimi, ndërtesa	83,900
Dega e Doganës	Taksa e rentës minerare	7
Agjensia Shtetërore e Kadastrës	Takse e kalimiti te drejtes se pronsise	2,705
Totali		171,050

Burimi: Bashkia Berat

- **<u>Detyrimet e familjarëve:</u>**

- *Mënyra e parashikimit të detyrimeve të familjarëve*

Tarifa e shërbimit për familjarët parashikohet në bazë të numrit të familjeve rezidente aktive të bashkisë.
Taksa e ndërtesës parashikohet në bazë të regjistrit të taksës që kanë njësitë, të përditësuar me numër njësi pronësie të reja, saktësim dhe shtim sipërfaqesh.
Nga auditimi u konstatua se bashkia Berat ka lidhur kontratë me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizimeve Berat për vjeljen e detyrimeve të familjarëve mbi bazën e kontratave të ujit të pijshëm që abonentët familjarë kanë.

- *Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese*

Shërbimi për familjet ofrohet në Zyrën me një ndalesë për qytetin dhe në Njësitë Administrative nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifat vendore.
Paketa Fiskale e bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë në lidhje me taksat dhe tarifat vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj.
Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë nga specialistët e taksave si në mënyrë verbale ashtu dhe shkresore.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, zakonisht kërkohet dokumentimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga popullata.
Nga auditimi i të dhënave, rezultoi se më datën 31.12.2025 për mospagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë për abonentët familjar në vlerën **175,315,146 lekë.** Vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Berat, nga mosarkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familjar deri në datën 31.12.2025.

Tabela nr.20: Detyrimet e familjarëve për taksat dhe tarifat vendore si vijon:

Nr.	Emërtimi	Deri më datën 31.12.2024	Detyrime deri më 31.12.2024 (zbritur pagesat e 2025	Viti 2025	Totali progresiv	Numri i familjeve debitore
1	Taksa e Truallit	3,575,204	3,159,180	735,777	3,894,958	5,156
2	Taksa e ndërtesës	26,694,991	23,948,665	3,957,556	27,906,221	5,536
3	Taksa e tokës bujqësore	74,233,563	64,965,164	11,997,936	76,963,100	7,949
4	Tarifa e pastrimit	33,665,890	30,257,300	5,597,750	35,855,050	5,883
5	Tarifa e Ndricim	10,778,725	10,147,275	1,866,525	12,013,800	3,062
6	Tarifa e Gjelberim	6,089,824	5,739,894	1,177,010	6,916,904	6,432
7	Tarifa e Arsim	4,541,804	4,057,825	1,115,250	5,173,075	5,075
8	Tarifa vaditje + kullim	6,126,685	5,316,158	1,190,909	6,507,067	2,891
9	Kamate vonese	86,570	84,970	-	84,970	127
Totali		**165,793,256**	**147,676,432**	**27,638,713**	**175,315,145**	

Burimi: Bashkia Berat

Tabela nr.21: Detyrimet e familjarëve për taksat dhe tarifat vendore të ndara sipas rajoneve dhe Njësive administrative si vijon:

Nr.	Njesitë Administrative	Truall	Ndërtes%	Toka	Pastrim	Ndriçim	Gjelbërim	T.Arsimi	Kanal	Kamatë	Totali
1	Rajoni I	40,792	1,900,647	208,098	4,236,700	2,692,500	1,996,075	264,750			11,339,562
2	Rajoni 2 dhe 3	286,622	1,850,631	1,058,046	4,520,950	3,331,200	2,929,584	503,250			14,480,283
3	Otllak	1,566,113	10,085,257	24,583,334	11,371,600	3,390,850	848,945	1,221,125	5,493,429		58,560,654
4	Velabisht	914,906	7,232,520	21,139,128	12,228,900	1,417,250	997,600	1,890,700	1,013,638		46,834,642
5	Sinje	737,849	4,916,596	22,570,078	2,781,700	1,088,250	122,650	1,070,000			33,287,123
6	Roshnik	348,677	1,920,569	7,404,416	715,200	93,750	22,050	223,250		84,970	10,812,882
Bashkia Berat		**3,894,959**	**27,906,221**	**76,963,100**	**35,855,050**	**12,013,800**	**6,916,904**	**5,173,075**	**6,507,067**	**84,970**	**175,315,146**

Burimi: Bashkia Berat

- **<u>Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:</u>**

Administrimi i taksave vendore bëhet me program, ku janë të pasqyruara regjistrat, sipas aktiviteteve, njoftim detyrimet dhe pagesat, kjo si për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë. Nga të dhënat që kërkohen për auditim, konstatohet që programi është i saktë, pasi në informacionet që kërkohen të dhënat dalin të analizuara për çdo zë tatimor që DTT Bashkia Berat aplikon. Pasqyrimi i të dhënave fillon me çelje si debitorë. Kamatëvonesat rigjenerohen nga sistemi në fund të çdo periudhe**.**

Tabela nr.22: Situata e lëvizjes së subjekteve paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrimet e reja (hyrje)	Mbyllur aktiviteti (dalje)	Gjendja në fund të vitit
I vogël/ madh	2025	2,312	245	218	2,339
Ambulant	2025	16	-	-	16
OJF	2025	20	-	-	20
Institucione	2025	47	-	-	47
Total		2,395	245	218	2,422

Burimi: Bashkia Berat

- **<u>Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:</u>**

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, Bashkia Berat në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e Aluizmit Berat janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ZVRPP (ASHK) Berat.

Konkretisht për periudhën nga 01.01.2025 deri më 31.12.2025, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezultoi se detyrimi për këtë taksë është në vlerën **6,142,563 lekë** për 186 persona, kanë paguar detyrimet 6 persona me vlerë **259,553 lekë** dhe kanë mbetur për likuidim deri datë 31.12.2025 gjithsej **180** persona me vlerë **5,883,010 lekë.**

Tabela nr.23: Taksa e ndikimit në infrastrukturë.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë				
Viti	**Persona**	**Vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë**	**Vlera e arkëtuar**	**Vlera e detyrimit**
Deri më 31.12.2025	186	6,142,563	259,553	5,883,010

Burimi: Bashkia Berat

- **<u>Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifat vendore:</u>**

Nga auditimi i të dhënave, rezultoi se më datën 31.12.2025 për mospagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe institucionet shtetërore në vlerën **165,233,088 lekë.**

Tabela nr.24: Gjendja e debitorëve sipas llojit të subjekteve:

Nr.	**Njësitë Administrative**	**Deri më 31.12.2024**	**Deri më 31.12.2024 (zbritur pagesat e 2025)**	**2025**	**Totali progresiv**
1	Subjektet fizik bisnesi i vogël	58,352,084	53,456,337	11,071,195	64,527,531
2	Subjektet juridik bisnesi i madh	90,132,706	88,681,228	8,333,764	97,014,992
3	Institucione	1,582,444	1,342,152	224,820	1,566,972
4	O J F	1,644,652	1,666,622	456,972	2,123,594
	Totali	**151,711,887**	**145,146,337**	**20,086,751**	**165,233,088**
1	Subjektet fizik bisnesi i vogël Rajoni 1, 2 dhe 3	42,583,295	41,063,313	6,795,961	47,859,274
2	Subjektet fizik bisnesi i madh Njësia Rajoni 1, 2 dhe 3	79,009,993	76,147,742	8,953,464	85,101,206
	Totali	**121,593,287**	**117,211,055**	**15,749,426**	**132,960,481**
2	Subjektet fizik bisnesi i vogël Nj. Adm Otllak,Velabisht,Sinje dhe Roshnik	6,809,133	6,262,578	1,537,803	7,800,380
5	Subjektet fizik bisnesi i madh Nj. Adm Otllak,Velabisht,Sinje dhe RoshnikAdministraive x	10,848,409	9,521,751	2,117,730	11,639,481
		17,657,542	**15,784,329**	**3,655,533**	**19,439,861**
A	**Totali**	**151,711,887**	**145,146,337**	**20,086,751**	**165,233,088**

Burimi: Bashkia Berat

Tabela nr.25: Gjendja e debitorëve sipas llojit të taksave/tarifave:

Nr	**Lloji i taksës/tarifës**	**2025**	
		Nr.sub	**Vlera**
1	Tarifë Arsimi	566	2,974,810
2	Tarifë Gjelbërimi	878	9,178,404
3	Tarifë Ndriçimi	868	15,891,982
4	Tarifë Pastrimi	897	51,690,363
5	Taksë Ndërtese	651	33,918,106
6	Taksë Trualli	510	5,567,423
7	Tarifë Rregjistrimi	67	715,000

8	Taksë Tabele	237	728,838
9	Tarifë Ambienti	9	541,957
10	Tarifë Parkimi	83	925,282
11	Tarifë Urbanistike	1	1,604,531
12	Tatimi i Biznesit të Vogel	142	3,446,993
13	Taksë hoteli	2	58,975
14	Gjobe dhe kamatë	971	37,312,099
15	Hapsirë Publike Ambulantet	15	678,326
Totali			**165,233,088**

Burimi: Bashkia Berat

Sa me sipër arrihet në konkluzionin se nga strukturat tatimore të bashkisë Berat, për subjektet që janë debitorë pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve, kanë zbatuar një pjesë e procedurave për to, si bllokimi i llogarive duke filluar me nr.7306 deri 7408 prot. datë 29.12.2025 (gjithsej 102 subjekte), me nr.7452 deri 7605 prot. datë 30.12.2025 (gjithsej 150 subjekte).

- **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Mjedisit, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Berat dhe në Njësitë Administrative në vartësi Otllak, Velabisht, Sinjë dhe Roshnik, ushtrojnë aktivitetin 12 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, si vijon:

Tabela nr.26: Hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre.

Nr.	Subjekti	Nipt	Afati i Autorizimit		Detyrimi për autorizimin	Pagesat e kryera	Diferenca
			Fillimi	Mbarimi			
1	S O	J62	20.02.2025	19.02.2030	1,000,000	1,000,000	0
2	R shpk	K1	10.03.2025	09.03.2030	1,000,000	1,000,000	0
3	T shpk	K4	Pezulluar				-
4	H Q	L33	15.12.2025	14.12.2030	1,000,000	1,000,000	0
5	B O	L42	01.08.2025	31.07.2030	1,000,000	600,000	400,000 (Akt Marreveshje)
6	K SA	K32	Ne proces				0
7	I O	K32	Kërkesë për pezullim				
8	G O	K6	01.07.2025	30.06.2030	1,000,000	1,000,000	0
9	G O	K66	Mbyllur	06/10/2022			
10	O Shpk	J63	18.07.2024	17.07.2029	1,000,000	1,000,000	0
11	A	J68	Nuk eshte paraqitur	-		-	
12	O	L91	08/02/2022	07/02/2027	1,000,000	1,000,000	0
13	G	L73	20.08.2020	19.08.2025 Pezulluar 03/06/2025			0
14	E S	K82	Kerkese per pezullim			-	-
15	U	L82	Pezulluar				
16	M C	L82	17/02/2022	16/02/2027	100,000	100,000	-
17	A H	K83	21/02/2022	20/02/2027	100,000	100,000	-
18	K	J61	20.02.2025	19.02.2030	1,000,000	1,000,000	-
19	P	L43	10/06/2022	09/06/2027	1,000,000	1,000,000	0
20	K O	L53	Pezulluar				
Shuma					**9,200,000**	**8,800,000**	**400,000**

Burimi: Bashkia Berat

Me Urdhrin nr. 15, datë 10.01.2025, është ngritur Komisioni "Për zbatimin e procedurës për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës (GLN) për automjete, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse".

Në Bashkinë Berat, gjatë vitit 2025, ushtrojnë aktivitetin 12 subjekte aktive që tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënproduktet e tyre. Nga auditimi i kryer mbi këtë kategori biznesesh, në lidhje me pajisjen me licencat përkatëse të tregtimit dhe pagesën e detyrimeve përkatëse, u konstatua se 10 subjekte janë pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre.
Nga këto, 5 subjekte janë pajisur me licencë gjatë vitit 2025, sipas të dhënave të paraqitura në tabelën më poshtë:

Tabela nr.27: Subjektet e pajisura me licenca që tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre.

Nr.	Subjekti	Nipt	Afati i Autorizimit		Detyrimi për autorizimin	Pagesat e kryera	Diferenca
			Fillimi	Mbarimi			
1	S	J62	20.02.2025	19.02.2030	1,000,000	1,000,000	0
2	H Q	L33	15.12.2025	14.12.2030	1,000,000	1,000,000	0
3	R	K13	10.03.2025	09.03.2030	1,000,000	1.000.000	0
4	G O	K66	01.07.2025	30.06.2030	1,000,000	1,000,000	0
5	K	J61	20.02.2025	19.02.2030	1,000,000	1,000,000	0
Shuma					**5,000,000**	**5,000,000**	**0**

Burimi: Bashkia Berat

Kanë mbyllur aktivitetin e tyre 7 subjekte, të cilat nuk ushtrojnë më aktivitetin në tregtimin me pakicë të hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre si vijon:

Tabela nr.28: Subjektet e mbyllura dhe të pezulluara, hidrokarbure.

Nr.	Subjekti	Nipt	Afati i Autorizimit		Detyrimi për autorizimin	Pagesat e kryera	Diferenca
			Fillimi	Mbarimi			
1	T	K42	Pezulluar 25/01/2024		-	-	-
2	I	K32	Pezulluar		-	-	-
3	G	K66	Mbyllur		-	-	-
4	E S	K82	Kerkese për pezullim/ Pasiv ne DRT Berat				
5	U	L82	Pezulluar				
6	K	L53	Pezulluar				
7	G	L73	Pezulluar				

Burimi: Bashkia Berat

Tabela nr.29: Subjektet e pa pajisura me licenca/autorizime në tregimin me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre.

Nr.	Subjekti	Nipt	Afati i Autorizimit		Detyrimi për autorizimin	Pagesat e kryera	Diferenca
			Fillimi	Mbarimi			
1	A	J68	Pa autorizim		-	-	-
2	B	L42	Ne proces		1,000,000	600,000	400,000
3	K	K32	Ne proces		-	-	-
Shuma							**400,000**

Burimi: Bashkia Berat

Gjatë vitit 2025 është informuar Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për subjektet të cilat ushtrojnë aktivitet pa u pajisur me Licencë dhe që nuk i janë përgjigjur shkresave të nisura nga Bashkia Berat për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar sipas legjislacionit në fuqi.

- **Taksa e tabelës**

Në Bashkinë Berat, sipas përcaktimit në Paketën Fiskale, tabelat kategorizohen në 4 lloje

1.Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit.

2.Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim, ku për vitin 2025 rezulton e papaguar vlera 47,700 lekë.
3.Tabelë për qëllime reklamimi, ku për vitin 2025 rezulton e papaguar vlera 27,000 lekë.
4.Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire spektale etj.

Tabela nr.30: Te dhënat për sipërfaqet e tabelave

			Taksa e tabeles					
		Niveli I takses(leke/m 2 vit	Sip. M2	Faturuar	Sip. M2	Paguar	Sip. M2	Pa paguar
1	Tabele per qellim identifikimi (me ndricim te thjeshte) 2-10 m2	15,000	86.27	1,294,020	83.09	1,246,320	3.18	47,700
2	Tabele per qellim identifikimi (me ndricim te thjeshte) 10-20 m2	12,750	18.63	237,494	18.63	237,494	-	-
3	Tabele per qellim identifikimi (me ndricim te thjeshte) 20-40 m2	8,250	9.20	75,900	9.2	75,900	-	-
4	Tabele per qellime reklamimi (E thjesht me/pa ndricim)	22,500	10.2	229,298	9.0	202,298	1.20	27,000
5	Tabele per qellime reklamimi (Elektronike)	45,000	0.95	42,750	0.95	42,750	-	-
*	Tabele per qellim identifikimi (me ndricim te thjeshte) 2-10 m2	15,000	3.80	23,750	3.80	23,750		
	Total			1,903,212		1,828,512		74,700

Burimi: Bashkia Berat

Përfundime:

Nga auditimi i vjeljes së të ardhurave, rezultuan debitorë në vlerën **346,905,944 lekë** ndaj Bashkisë Berat.

1. Debitorë nga taksat dhe tarifat vendore për abonentët familjarë në vlerën **175,315,146 lekë.**
2. Debitorë për taksën e tabelës në vlerën **74,700 lekë**.
3. Debitorë nga taksat dhe tarifat vendore për abonentët e biznesit në vlerën **165,233,088 lekë.**
4. Debitorë për taksën e ndikimit në infrastrukturë në vlerën **5,883,010 lekë.**
5. Debitorë nga mospagimi i detyrimit për pajisje me licencë tregtimi për shitjen me pakicë të hidrokarbureve dhe nënporodukteve të tyre në vlerën **400,000 lekë**.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. z. E. C, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Berat
2. z. D. B, në cilësinë e Përgjegjësit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore

2.3 Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025.

2.3.1. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.
2.3.2. Vlerësimi nëse aktivet dhe pasivet janë llogaritur saktë si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.
2.3.3. Inventarizimi i aktiveve për vitin e raportimit financiar.

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i më poshtëm:

- Pasqyrat Financiare për vitin ushtrimor 2025;
- Ditarët e kontabilitetit për vitin ushtrimor 2025;
- Listë pagesat me zgjedhje për vitin ushtrimor 2025;
- Dokumentet e bankës dhe të arkës për vitin ushtrimor 2025;
- Aktet e rakordimit me degën e thesarit Berat, për vitin ushtrimor 2025;
- Dokumentet e inventarizimit etj., për vitin ushtrimor 2025;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave.

- **Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:**

Për vitin 2025 Bashkia Berat ka hartuar pasqyrat e konsoliduar në të cilat përfshihen aparati i Bashkisë Berat, Agjensia e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar, Qendra Kulturore Margarita Tutulani dhe Qendra Lira.

Bashkia Berat për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Berat si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestimi.

- **Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.**

Për vitin 2025 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, "*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- ☐ Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- ☐ Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- ☐ Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Floë).
- ☐ Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- ☐ Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- ☐ Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- ☐ Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- ☐ Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- ☐ Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

- **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Bashkisë Berat për vitin 2025 janë të nënshkruara nga z. E. C Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. R. S me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në cilësinë e nëpunësit zbatues ku janë depozituar pranë Degës së Thesarit Berat në datë 30.04.2026, në përputhje me afatet e përcaktuara me ligj.

Pasqyrat individuale për të gjitha njësitë shpenzuese janë depozituar në degën e thesarit si mëposhtë:

1-Bashkia Berat ka depozituar në degën e thesarit Berat pasqyrat financiare në datën 31.03.2026, të cilat janë miratuar në datën 31.03.2026. Pasqyrat Financiare janë përgatitur nga znj. R. Sh.në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare të institucionit dhe janë konfirmuar nga Kryetari i Bashkisë Berat, z. E. C në cilësinë e Nëpunësit Autorizues.

2-Drejtoria e Arsimit, Bashkia Berat ka depozituar në degën e thesarit Berat pasqyrat financiare në datën 30.03.2026, të cilat janë miratuar në datën 30.03.2026. Pasqyrat Financiare janë përgatitur nga znj. E. M në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare të institucionit dhe janë konfirmuar nga znj. K. H në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, Bashkia Berat.

3-Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar ka depozituar në degën e thesarit Berat pasqyrat financiare në datën 11.03.2026, të cilat janë miratuar në datën 28.03.2024. Pasqyrat Financiare janë përgatitur nga znj. Th. H në cilësinë e hartuesit të pasqyrave

financiare të institucionit dhe janë konfirmuar nga z. B. Ç në cilësinë e Drejtuesit të Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar.
4-Qendra Kulturore Margarita Tutulani ka depozituar në degën e thesarit Berat pasqyrat financiare në datën 11.03.2026, të cilat janë miratuar në datën 11.03.2026. Pasqyrat Financiare janë përgatitur nga znj. M. Sh. në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare të institucionit dhe janë konfirmuar nga z. A. Q në cilësinë e Drejtuesit të Qendrës Kulturore Margarita Tutulani.
5-Qendra Lira ka depozituar në degën e thesarit Berat pasqyrat financiare në datën 24.03.2026, të cilat janë miratuar në datën 26.03.2026. Pasqyrat Financiare janë përgatitur nga znj. L. B në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare të institucionit dhe janë konfirmuar nga znj. A. K në cilësinë e Drejtuesit të Qendrës Lira.

- **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.**

Për vitin 2025 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.**

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:
- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.
Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:
- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- **Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare individuale dhe të konsoliduar për Bashkisë Berat dhe Njësitë e tjera shpenzuese për aktivitetin ekonomiko-financiar për periudhën 01.01.2025- 31.12.2025.
Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2025 rezultoi se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2025:

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënzërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejtë në pasqyrën e bilancit.

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar të Bashkisë Berat në 31.12.2025, sipas **formatit F1**, është paraqitur më poshtë:

Pasqyra e pozicionit financiar (F1) 2025.

- Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=6,438,348,733 lekë.

- Aktivet 7,249,296,542 lekë
- Detyrimet 810,947,809 lekë
- Aktivet Neto 6,438,348,733 lekë

Pasqyra individuale e pozicionit financiar të Bashkisë Berat në 31.12.2025, sipas **formatit F1**, është paraqitur më poshtë:

Pasqyra e pozicionit financiar (F1) 2025.

- Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=3,453,421,006 lekë.

- Aktivet 4,198,259,490 lekë
- Detyrimet 744,838,484 lekë
- Aktivet Neto 3,453,421,006 lekë

Aktivet afatshkurtra:

Aktivet afatshkurta më 31.12.2025 paraqiten në vlerën **1,142,813,575 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" në shumën 293,763,872 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues" në shumën 148,734,625 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" në shumën 593,040,444 lekë;

Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" përbëhet nga:

Pasqyra PF1: Detajet e nënrubrikës "*Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre*".

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2025	Viti 2024
531	Mjete Monetare në arkë	-	-
512	Mjete monetare në bankë	-	-
520	Disponibilitete në thesar	290,556,113	300,621,128
50	Letra me vlerë	-	-
532	Vlera të tjera	3,207,759	2,440,759
54	Akreditiva dhe paradhënie	-	-
59	Provigjone zhvlerësimi letra me vlerë	-	-
	Totali	**293,763,872**	**303,061,887**

Burimi: Bashkia Berat

Vlera e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" në shumën 290,556,113 lekë, përbëhet nga: gjendja e llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në shumën 187,061,633 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 104,519,774 lekë.

1-Bashkia Berat:
Sipas pasqyrës së performancës financiare të Bashkisë Berat për vitin 2025 kemi informacionin si më poshtë:
Klasa 7(Të ardhurat në vlerën 1,186,086,506 lekë).
Klasa 6 (Shpenzimet në vlerën 999,536,798 lekë).
Sipas informacionit të mësipërm llogaria 85 është paraqitur në vlerën 186,549,708 lekë e cila kuadron me diferencën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
Sipas akt mbajtjet e të ardhurave për vitin 2026 si më poshtë:
1-Transfertë e pakushtëzuar dhe specifike viti 2025 e papërdorur 50,918,357 lekë.
2-Të ardhurat pa çelur viti 2025 në shumën 114,399,212 lekë.
3-Të ardhura të çelura të papërdorura në shumën 19,807,804 lekë.
Totali i fondeve të papërdorura është në shumën 182,428,745 lekë fonde të cilat do të trashëgohen për vitin 2026.

2-Agjensia e Shërbimeve Publike:
Sipas pasqyrës së performancës financiare të Agjensisë së Shërbimeve Publike për vitin 2025 kemi informacionin si më poshtë:
Klasa 7(Të ardhurat në vlerën 320,021,605 lekë).
Klasa 6 (Shpenzimet në vlerën 317,449,549 lekë).
Sipas informacionit të mësipërm llogaria 85 është paraqitur në vlerën 2,572,056 lekë e cila kuadron me diferencën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Diferenca e të ardhurave dhe shpenzimeve 2,572,056 lekë.

3-Drejtoria e Arsimit, Bashkia Berat:
Sipas pasqyrës së performancës financiare të Drejtorisë së Arsimit, Bashkia Berat për vitin 2025 kemi informacionin si më poshtë:
Klasa 7(Të ardhurat në vlerën 372,311,015 lekë).
Klasa 6 (Shpenzimet në vlerën 373,904,282 lekë).
Sipas informacionit të mësipërm llogaria 85 është paraqitur në vlerën (1,593,267)lekë e cila kuadron me diferencën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4-Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar:
Sipas pasqyrës së performancës financiare të Drejtorisë së Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar për vitin 2025 kemi informacionin si më poshtë:
Klasa 7(Të ardhurat në vlerën 50,154,976 lekë).
Klasa 6 (Shpenzimet në vlerën 50,839,032 lekë).
Sipas informacionit të mësipërm llogaria 85 është paraqitur në vlerën (684,056)lekë e cila kuadron me diferencën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

5-Qendra Kulturore Margarita Tutulani:
Sipas pasqyrës së performancës financiare të Qendrës Kulturore Margarita Tutulani për vitin 2025 kemi informacionin si më poshtë:
Klasa 7(Të ardhurat në vlerën 75,515,455 lekë).
Klasa 6 (Shpenzimet në vlerën 75,423,445 lekë).
Sipas informacionit të mësipërm llogaria 85 është paraqitur në vlerën 92,010 lekë e cila kuadron me diferencën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

6-Qendra Lira:
Sipas pasqyrës së performancës financiare të Qendrës L për vitin 2025 kemi informacionin si më poshtë:
Klasa 7(Të ardhurat në vlerën 33,796,781 lekë).
Klasa 6 (Shpenzimet në vlerën 33,671,599 lekë).
Sipas informacionit të mësipërm llogaria 85 është paraqitur në vlerën (125,182) lekë e cila kuadron me diferencën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Vlera e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" në shumën 293,763,872 lekë kuadron me llogaritë 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" dhe 466 "Mjete në ruajtje".

Aktivet afatshkurtra (pasqyra individuale e aparatit):
Aktivet afatshkurta më 31.12.2025 paraqiten në vlerën **950,736,301 lekë** dhe përbëhen nga:
- Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" në shumën 289,779,340 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues" në shumën 22,766,677 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" 528,695,241 në shumën lekë

Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" përbëhet nga:
Pasqyra PF2: Detajet e nënrubrikës "*Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre*".

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2025	Viti 2024
531	Mjete Monetare në arkë	-	-
512	Mjete monetare në bankë	-	-
520	Disponibilitete në thesar	289,779,340	298,010,129
50	Letra me vlerë	-	-
532	Vlera të tjera	3,207,759	2,440,759
54	Akreditiva dhe paradhënie	-	-
59	Provigjone zhvlerësimi letra me vlerë	-	-
	Totali	**292,987,099**	**300,450,888**

Burimi: Bashkia Berat

Vlera e llogarisë 520 *"Disponibilitete në thesar"* në shumën 289,779,340 lekë, përbëhet nga: gjendja e llogaria 85 *"Rezultati i vitit ushtrimor"* në shumën 186,549,708 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 *"Mjete në ruajtje"* në shumën 103,743,001 lekë.

Fondi i Konsoliduar:
Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar/Deficit i akumuluar)
Pasqyra PF3: Detajet e nënrubrikës '*Teprica*".

Zërat për të cilat pakësohet fondi	Llogaria 101		Zerat për të cilat shtohet fondi
	Debi	Kredi	
Pakësimet gjatë vitit	869,028,249	3,171,164,116	Çelje
Amortizim i vitit	409,155,992	2,177,496,220	Investime + Dhurime
		1,025,294	Ndryshim i gjendjes së inventarit
Shuma	1,278,184,241	5,349,685,630	Shuma
Shuma		**4,071,501,389**	

Burimi: Bashkia Berat

Referuar pasqyrës së pozicionit financiar llogaria 101 "Teprica" është kontabilizuar për vlerën 4,210,500,765 lekë.
Sipas tabelës së mësipërme e përllogaritur dhe sipas udhëzimit të MFE Nr.8 datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e*

qeverisjes së përgjithshme" vlera e raportuar në bilanc është mbivlerësuar për vlerën 138,999,376 lekë.

Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues", përbëhet nga:
Pasqyra PF4: Detajet e nënrubrikës "*Gjendje inventari qarkullues*".

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca 2025-2024
31	Materiale	50,598,133	47,567,716	3,060,417
32	Inventar i imët	97,919,705	99,886,955	(1,967,250)
33	Prodhim në proces			
34	Produkte			
35	Mallra	216,787	254,660	(37,873)
36	Kafshë në rritje e majmëri			
37	Gjendje të pambëritura ose pranë të tretëve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Provigjone për zhvlerësimin e inventarëve			
	Totali	**148,734,625**	**147,709,331**	**1,055,294**

Burimi: Bashkia Berat

1-Aparati i Bashkisë Berat:
Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Berat në 31.12.2025 paraqitet në vlerën lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 "Materiale" në vlerën 2,928,961 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 "Inventar i imët" në vlerën 19,837,716 lekë.
Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën = 513,369 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 "Ndryshimi gjendjes së inventarit" në shumën 513,369 lekë

Llogaria 312 "Materiale", ka vlerën 2,928,961 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelën e mëposhtme:
Pasqyra PF5: Detajet e llogarisë 312 "*Materiale*".

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	2,022,698
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025	
Dalje nga magazina gjatë vitit 2025	
Gjendja në 31.12.2025	**2,928,961**

Burimi: Bashkia Berat

Llogaria 327 "Inventar i imët", ka vlerën 19,837,716 dhe lëvizjet e llogarisë 32 "Objekte inventari" paraqiten në tabelën e mëposhtme:
Pasqyra PF6: Detajet e llogarisë 327 "*Inventar i imët*".

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	20,230,610
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025	
Dalje nga magazina gjatë vitit 2025	
Gjendja në 31.12.2025	**19,837,716**

Burimi: Bashkia Berat

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Titullari i Bashkisë Berat ka nxjerrë Urdhrat e inventarizimit ku janë përcaktuar grupi për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve. Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit".

2-Agjensia e Shërbimeve Publike:
Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Agjensisë së Shërbimeve Publike në 31.12.2025 paraqitet në vlerën 48,743,817 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 "Materiale" në vlerën 33,986,377 lekë ,nga llogaria kontabël 32 "Inventar i imët" në vlerën 14,757,440 lekë.

Llogaria 312 "Materiale", ka vlerën 33,986,377 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelën e mëposhtme:
Pasqyra PF7: Detajet e llogarisë 312 "*Materiale*".

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	32,974,929
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025	162,016,738
Dalje nga magazina gjatë vitit 2025	161,005,290
Gjendja në 31.12.2025	**33,986,377**

Burimi: Agjensia e Shërbimeve Publike

Llogaria 327 "Inventar i imët", ka vlerën 14,757,440 lekë dhe lëvizjet e llogarisë 32 "Objekte inventari" paraqiten në tabelën e mëposhtme:
Pasqyra PF8: Detajet e llogarisë 327 "*Inventar i imët*".

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	13,196,832
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025	2,855,616
Dalje nga magazina gjatë vitit 2025	1,295,008
Gjendja në 31.12.2025	**14,757,440**

Burimi: Agjensia e Shërbimeve Publike

3-Drejtoria e Arsimit, Bashkia Berat:
Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Drejtorisë së Arsimit, Bashkia Berat në 31.12.2025 paraqitet në vlerën 61,931,936 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 "Materiale" në vlerën 11,434,273 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 "Inventar i imët" në vlerën 50,497,663 lekë.

Llogaria 312 "Materiale", ka vlerën 11,434,273 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelën e mëposhtme:
Pasqyra PF9: Detajet e llogarisë 312 "*Materiale*".

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	9,646,053
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025	16,251,978
Dalje nga magazina gjatë vitit 2025	14,463,758
Gjendja në 31.12.2025	**11,434,273**

Burimi: Drejtoria e Arsimit

Llogaria 327 "Inventar i imët", ka vlerën 50,497,663 dhe lëvizjet e llogarisë 32 "Objekte inventari" paraqiten në tabelën e mëposhtme:
Pasqyra PF10: Detajet e llogarisë 327 "*Inventar i imët*".

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	53,879,150
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025	1,177,008
Dalje nga magazina gjatë vitit 2025	4,558,495
Gjendja në 31.12.2025	**50,497,663**

Burimi: Drejtoria e Arsimit

4- Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar:
Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Drejtorisë së Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar në 31.12.2025 paraqitet në vlerën 6,083,062 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 "Materiale" në vlerën 1,723,733 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 "Inventar i imët" në vlerën 4,359,329 lekë

Llogaria 312 "Materiale", ka vlerën 1,723,733 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelën e mëposhtme:
Pasqyra PF11: Detajet e llogarisë 312 "*Materiale*".

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	2,381,605
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025	6,622,790
Dalje nga magazina gjatë vitit 2025	6,476,033
Gjendja në 31.12.2025	**1,723,733**

Burimi: Drejtoria e Bujqësisë, administrimit të pyjeve, ujërave dhe shërbimit veterinar

Llogaria 327 "Inventar i imët", ka vlerën 4,359,329 lekë dhe lëvizjet e llogarisë 32 "Objekte inventari" paraqiten në tabelën e mëposhtme:
Pasqyra PF12: Detajet e llogarisë 327 "*Inventar i imët*".

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	4,385,513
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025	651,506
Dalje nga magazina gjatë vitit 2025	102,376
Gjendja në 31.12.2023	**4,359,329**

Burimi: Drejtoria e Bujqësisë, administrimit të pyjeve, ujërave dhe shërbimit veterinar

5-Qendra M.T:
Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Qendrës M.T në 31.12.2025 paraqitet në vlerën 5,934,582 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 "Materiale" në vlerën 143,801 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 "Inventar i imët" në vlerën 5,790,781 lekë

Llogaria 312 "Materiale", ka vlerën 143,801 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelën e mëposhtme:
Pasqyra PF13: Detajet e llogarisë 312 "*Materiale*".

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	143,801
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025	1,201,790
Dalje nga magazina gjatë vitit 2025	1,201,790
Gjendja në 31.12.2025	**143,801**

Burimi: Qendra M.T

Llogaria 327 "Inventar i imët", ka vlerën 12,283,388 lekë dhe lëvizjet e llogarisë 32 "Objekte inventari" paraqiten në tabelën e mëposhtme:
Pasqyra PF14: Detajet e llogarisë 327 "*Inventar i imët*".

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	5,698,771
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025	92,010
Dalje nga magazina gjatë vitit 2025	
Gjendja në 31.12.2025	**5,790,781**

Burimi: Qendra M.T

6-Qendra L:
Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Qendrës Lira në 31.12.2025 paraqitet në vlerën 3,274,551 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 "Materiale" në vlerën 380,988 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 "Inventar i imët" në vlerën 2,676,776 lekë

Llogaria 312 "Materiale", ka vlerën 380,988 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelën e mëposhtme:
Pasqyra PF15: Detajet e llogarisë 312 "*Materiale*".

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	398,630
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025	987,669
Dalje nga magazina gjatë vitit 2025	1,005,311
Gjendja në 31.12.2025	**380,988**

Burimi: Qendra L

Llogaria 327 "Inventar i imët", ka vlerën 864,378 lekë dhe lëvizjet e llogarisë 32 "Objekte inventari" paraqiten në tabelën e mëposhtme:
Pasqyra PF16: Detajet e llogarisë 327 "*Inventar i imët*".

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	2,496,079
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025	701,846
Dalje nga magazina gjatë vitit 2025	521,149
Gjendja në 31.12.2025	**2,676,776**

Burimi: Qendra L

Inventarizimi i aktiveve:
Gjatë vitit 2025, mbështetur dhe në udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* është kryer procedura e inventarizimit si më poshtë për aparatin e Bashkisë Berat dhe për Agjensitë dhe Drejtoritë.

Aparati Bashkia Berat:
Titullari i Bashkisë Berat me urdhër nr.777, datë 30.10.2025 *"Për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve për vitin 2025"*
Me urdhrin nr.778, datë 30.10.2025 *"Për ngritjen e komisionit të asgjesimit të aktiveve afatgjata dhe afatshkurta për vittin 2025"*
Komisioni i Inventarizimit ka mbajtur relacionin e inventarizimit në datën 31.12.2025 në të cilin është përcaktuar gjendja e aktiveve për aparatin e Bashkisë Berat.
Pasqyra PF17: Gjendja e aktiveve për aparatin e Bashkisë Berat.

Nr	Llogaria	Pakësuar në lekë	Jashtë përdorimit në lekë
1	Rrugë, rrjete, vepra ujore (213)	750,335,825	
2	Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune (214)	5,553,600	
3	Mjete transporti (215)	81,470,177	
4	Inventar ekonomik (218)	11,556,454	1,402,186
5	Inventar i imët (327)	2,342,785	787,345
Total		**851,258,841**	**2,189,531**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Komisioni i Vlerësimit ka mbajtur relacionin e vlerësimit për aktivet e vlerësuara jashtë përdorimit në datën 31.12.2025. Aktivet e propozuara për jashtë përdorimit janë në vlerën totale 2,189,531 lekë nga të cilat llogaria (218) në vlerën 1,402,186 lekë dhe llogaria (327) në vlerën 787,345 lekë. Me shkresën nr. 6282/1 prot., datë 31.12.2025 *"Mbi miratimin e procedurës së ndjekur për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata për vitin 2025"* vendosi:

- Të miratoj procedurën e ndjekur nga komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve.
- Nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata llogaria (218) në shumën 1,402,186 lekë dhe inventarin e imët llogaria (327) në vlerën 787,345 lekë.

Komisioni i asgjesimit me datë 31.12.2025 ka mbajtur procesverbalin për asgjesimin e materiale të vleësuara për dalje jashtë përdorimi. Materiale për tua asgjesuar jane në vlerën 2,189,531 lekë.

Agjencia e Shërbimeve Publike

Drejtori i Agjencisë me urdhër nr.223, datë 17.11.2025 *"Për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve për vitin 2025"*
Me urdhrin nr.224, datë 17.11.2025 *"Për ngritjen e komisionit të asgjesimit të aktiveve afatgjata dhe afatshkurta për vittin 2025"*
Komisioni i Inventarizimit ka mbajtur relacionin e inventarizimit në datën 31.12.2025 në të cilin është përcaktuar gjendja e aktiveve.

Pasqyra PF18: Gjendja e aktiveve për Agjencisë e Shërbimeve Publike

Nr.	Llogaria	Pakësuar në lekë	Jashtë përdorimit në lekë
1	Inventar i imët (327) Sektori i Gjelbërimit	-	377,117
2	Inventar i imët (327) Sektori i Shërbimeve		917,089
Total		-	**1,294,206**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Komisioni i Vlerësimit me shkresën nr.956/1, datë 27.12.2025 ka mbajtur relacionin e vlerësimit për aktivet e vlerësuara jashtë përdorimit. Aktivet e propozuara për jashtë përdorimit janë në vlerën totale 1,294,206 lekë.

Komisioni i asgjesimit me datë 05.03.2026 ka mbajtur procesverbalin për asgjesimin e materiale të vleësuara për dalje jashtë përdorimi. Materiale për tu asgjesuar janë në vlerën 1,294,206 lekë.

Drejtoria e Arsimit Bashkia Berat.

Drejtori i Drejtorisë Titullari i Bashkisë Berat me urdhër nr.121, datë 07.10.2025 *"Për ngritjen e komisionit për kryerjen e inventarizimit fizik të aseteve në Qytetin e Beratit e për vitin 2025".*
Me urdhër nr.122, datë 07.10.2025 *"Për ngritjen e komisionit për kryerjen e inventarizimit fizik të aseteve në Qytetin e Beratit e për vitin 2025".*
Me urdhrin nr.119, datë 07.10.2025 *"Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi".*
Me urdhrin nr.120, datë 07.10.2025 *"Për caktimin e Kryetarit të Komisionit të Asgjesimit të materialeve të nxjerra jashtë përdorimit".*

Komisioni i Inventarizimit ka mbajtur relacionin e inventarizimit me shkresën nr.802 në datën 31.12.2025 në të cilin është përcaktuar lista e aktiveve për nxjerrjen jashtë përdorimit.

Pasqyra PF19: Lista e aktiveve për nxjerrjen jashtë përdorimit

Nr.	Llogaria	Vlerësuar për jashtë përdorimit në lekë
1	Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune (214)	9,976,151
2	Inventar ekonomik (218)	7,559,985
3	Inventar i imët (327)	4,150,037
Total		**21,686,173**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Komisioneve i Vlerësimit të Aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi i ngritur me urdhër nr.119, datë 07.10.2025 nuk ka ndjekur procedurën për vlerësimin e aktiveve të njësisë në kundërshtim me *pikën 104 , "Hartohet nga komisioni i vlerësimit pas verifikimit faktik të të gjitha aktiveve duke argumentuar arsyet për vlerësimin e secilit prej tyre: a. nese eshte i nevojshem apo jo per veprimtarine e njesise; b. nese nuk rezulton i nevojshem per njesine, a eshte ne gjendje te mire fizike dhe ka mundesi perdorimi te metejshem ne njesi te tjera; c. nese duhet te nxirret perfundimisht jashte perdorimit nepermjet shitjes si material mbeturine apo asgjesimit përfundimtar".*

Llogaritë Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme "&"Të tjera aktive afatshkurtra":

Pasqyra PF20: Detajet e nënrubrikës "*Llogari të arkëtueshme*".

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2025	Viti 2024
	Llogari të arkëtueshme		
468	Debitorë te ndryshëm	500,232,595	488,436,848
4342	Te tjera operacione me shtetin(të drejta)	92,807,849	75,156,906
	Totali	**593,040,444**	**563,593,754**
	Të tjera aktive afatshkurtra		
409	Furnitorë (Debitorë),parapagime pagesa pjesore		
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin		
477	Diferenca konvertimi aktive		
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime		
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	107,274,634	66,204,480
	Totali	**107,274,634**	**66,204,480**

Burimi: Bashkia Berat

Pasqyra PF21: Informacion i Pasqyrave të Konsoliduara llogaria 468 *"Debitorë të ndryshëm".*

Nr	Institucioni	Gjendja e llogarisë 468 datë 31.12.2025
1	Aparati i Bashkisë Berat	495,959,189
2	Agjencia e Shërbimeve Publike	1,752,066
3	Drejtoria e Arsimit	1,558,370
4	Drejtoria e Bujqësisë,Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar	-
5	Q.Kulturore Margarita Tutulani	-
6	Qendra Lira	962,970
Totali		**500,232,595**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

1-Aparati i Bashkisë Berat:

Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm", e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 484,126,015 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 495,959,189 lekë, kjo llogari gjatë vitit 2025 ka pasur rritje me vlerë 11,833,174 lekë. Vlerë e cila i përket debitorëve për taksa e tarifa vendore për bizneset dhe taksa e tarifa vendore familjarët. Nga analiza e llogarisë 468 ***"Debitorë të ndryshëm"*** kemi detyrimet si më poshtë:

Pasqyra PF22: Detajet e llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm*".

Lloji i Detyrimit	Detyrim 31.12.2024	Shtesa viti 2025	Pakësim viti 2024	Detyrim datë 31.12.2025
Detyrime Familjarë, Biznesi	337,312,025	65,126,876	41,264,686	361,174,215
Detyrime nga Drejtoria e Investimeve	78,277,937	852,850	-	79,130,787
Detyrime Drejtoria Urbanistikës	-	43,544,199	-	43,544,199
Gjoba IMTV	70,070,475	9,798,355	66,294,600	13,574,230
Detyrime punonjës ish-komuna	2,776,411	44,337	11,584	2,809,164
Shuma	**488,436,848**	**119,366,617**	**107,570,870**	**500,232,595**

Burimi: Bashkia Berat

Në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" janë kontabilizuar detyrimet duke i grupuar sipas llojit të detyrimit informacioni për debinë sipas detyrimeve gjendet në tabelës e mësipërme.
-Në grupimin e detyrimeve nga Drejtoria e Investimeve janë detyrimet të cilat janë nxjerrë gjatë auditimeve nga Grupet e Kontrollit të KLSH për punime të pakryera në projekte publike ose detyrime për taksa dhe tarifa vendore të llogaritura jo në përputhje me paketën fiskale përgjatë viteve. Për këto detyrime nga Drejtoria e Financës disponohet listë analitike për subjektet debitore dhe janë dërguar me shkresë
- Detyrimet progresive të kontabilizuara për gjobat e IMTV janë në vlerën lekë. Gjatë vitit 2025 Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit me shkresën nr. 487/2 prot., datë 27.01.2026 ka dërguar informacionin për debitorët për vitin 2025 në Drejtorinë e Financës.
- Detyrimet për taksat dhe tarifat vendore për abonentë familjarët dhe biznes në datën 31.12.2025 janë kontabilizuar në vlerën 361,174,215 lekë. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore me shkresën nr. 487/5, datë 06.02.2026 ka dërguar informacion për debitorët progresivë.

2-Agjensia e Shërbimeve Publike:
Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm", e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 1,752,066 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 1,752,066 lekë, kjo llogari gjatë vitit nuk ka pasur ndryshime.

Llogaria 4342 "Të tjera operacione me shtetin (debitor)", në fund të vitit 2025 paraqitet në pasqyrat e konsoliduara në vlerën 92,807,849 lekë. Referuar udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes, raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*. Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)" është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike te tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm.
Sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Berat gjendja e llogarive të klasës 4 është në vlerën 92,807,849 lekë pasqyruar si më poshtë:
- Llogaria 401-408 *"Furnitorë dhe llogari të lidhura me to"*: 4,526,552 lekë.
- Llogaria 421 *"Detyrime ndaj personelit"* : 47,297,760 lekë.
- Llogaria 431 *"Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"* : 4,239,213 lekë.
- Llogaria 435 *"Sigurime Shoqërore"* : 14,275,015 lekë.
- Llogaria 436 *"Sigurime Shëndetësore"* : 1,964,925 lekë.
- Llogaria 467 *"Kreditorë të ndryshëm"* : 127,779,017 lekë

Pasqyra PF23: Përmbledhëse e llogarisë 4342 *"Të tjera operacione me shtetin"*

Nr	Institucioni	4342	401-408	42	431	435	436	467	Total pa përfshirë 4342
1	Aparati i Bashkisë Berat	32,736,052	535,320	15,508,935	1,921,445	4.896,811	662,464	115,498,361	134,126,525
2	Agjencia e Shërbimeve Publike	20,210,818	2,409,086	6,942,161	287,136	1,989,060	276,452	8,306,922	20,210,817
3	Drejtoria e Arsimit	31,045,075	1,492,638	18,896,807	1,427,589	5,593,287	776,212	3,845,892	32,032,425
4	Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve	3,780,351	0	2,609,855	265,510	785,366	109,580	123,408	3,893,719

5	Qendra M.T	2,569,307	0	1,749,039	172,045	525,884	72,965	49,374	2,569,307
6	Qendra L	2,466,246	89,508	1,590,963	165,488	484,607	67,252	68,428	2,466,246
Total		**92,807,849**	**4,526,552**	**47,297,760**	**4,239,213**	**14,275,000**	**1,964,925**	**127,892,385**	**200,195,835**

Burimi: Bashkia Berat

Referuar udhëzimit nr.5, datë 21.02.2022 *"Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" citohet.*
Llogaria 4342 "Operacione me shtetin" (detyrime).
Kjo është një llogari që në pasqyrat financiare të NJQP paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzimet/shërvbimet e kryera gjatë periudhës ushtrimore, të rimbursueshme nga shteti në bazë të kuadrit ligjor ose marrëveshjet e financimit për projekte të ndryshme.
Llogaria 4342 "Të tjera operacione me shtetin" është kontabilizuar në kundërshtim me udhëzimin nr.5 si mësipër.
Referuar të dhënave të tabëlës PF23 mësipër llogaria 4342 *"Të tjera operacione me shtetin (të drejta)"* duhet të kontabilizohej për vlerën 200,195,835 lekë. Kjo llogari është kontabilizuar në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 92,807,849 lekë e cila është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 107,387,986 lekë.

Llogaria 486 ***"Shpenzime të periudhave të ardhshme"*** në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 107,274,634 lekë dhe në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 66,204,480 lekë.
Referuar udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes,paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithsme"*

42. *Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas në pasqyrat financiare vjetore dhe zërin e detyrimeve të prapambetura të tyre ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të mungesës së fondeve. Për të evidentuar këto detyrime, do të përdoren llogari specifike të kontabilitetit të llogarisë 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme", në varësi të natyrës së tyre:*

- *"Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore"*
- *"Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për shërbime"*
- *"Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për mirëmbajtje";*
- *"Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për investime";*
- *"Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura të tjera".*

Nga pikëpamja e kontabilitetit, regjistrimet për detyrimet e praprambetura të bëhen si më poshtë:

- *Debitohet llogaria përkatëse 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura" dhe*
- *Kreditohet llogaria përkatëse 467 "Kreditorë të ndryshëm".*

Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme". *Kjo llogari përfshihet në grupin e llogarive rregulluese. Përfaqësojnë shpenzime për blerje ose sherbime, realizimi faktik i të cilave ndodh në një vit ushtrimor të ardhshëm (shpenzime të parapaguara), si p.sh.qera të paguara në avancë, prime të sigurimeve për rreziqe të paguara në avancë dhe të tjera.*
Referuar ndryshimeve sipas udhëzimit nr.5, datë 21.02.2022 *"Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*

Seksioni 3.1 “Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithme”, paragrafi 42 ndryshon si vijon: Degët e Thesarit regjistrojnë në SIFQ raportin/listën e faturave të siguruara sipas pikës 6 (b) të këtij udhëzimi lidhur lidhur me detyrimet e prapambetura të njësive të qeverisjes së përgjithshme ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara për shkak të mungesës së fondeve publike.Për të evidentuar këto detyrime, degët e thesaritpërdorin llogaritë kontabël 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, funksionimi i të cilit caktohet me udhëzim të veçantë dhe vetëm për qëllime monitorimi të performancës financiare të njësive të qeverisjes së përgjithshme.Rregjistrimet e thesarit në llogarinë 486 nuk janë pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar që prodhohet nga SIFQ në nivel njësie shpenzuese ose njësie publike qendrore ose vendore për efekte rakordimi me keto të fundit. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, përpara mbylljes së llogarive vjetore 2021, kryejnë veprimin e mbylljes së llogarisë 4864 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura” në debi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në këto llogari në datën 31.12.2021.

Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM) :

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 *“Studime dhe Kërkime”*, dhe paraqiten me kosto historike 177,466,812 lekë, amortizim i akumuluar në vlerën 78,067,897 lekë, shtesa gjatë vitit 2025 në vlerën 152,888 lekë, amortizim i vitit 2025 në vlerën 54,278 lekë dhe vlerë neto në vlerën 79,964,240 lekë.

Pasqyra PF24: Detajet e nënrubrikës *“Studime dhe Kërkime”*.

Nr	Institucioni	Kosto Historike	Amortizim i Akumuluar	Teprica Neto
1	Aparati i Bashkisë Berat	177,115,671	97,159,642	79,956,029
2	Agjencia e Shërbimeve Publike	-	-	-
3	Drejtoria e Arsimit	451,200	442,989	8,211
4	Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve	-	-	-
5	Qendra M.T	-	-	-
6	Qendra L	-	-	-
Total		**177,566,871**	**80,399,018**	**79,964,240**

Burimi: Bashkia Berat

Pasqyra PF25: Lista e projekteve të kontabilizuara gjatë vitit 2025:

Nr	Emri I Projektit	Vitit i rregjsitrimit	Vlera historike	Amortizimi	Vlera kontabel neto
Bashkia Berat					
1	Oponence teknike Rikonstruksioni i shkolles së bashkuar Koco Brisku Lapardha	2025	-	-	113,175
2	Oponence teknike Rikonstruksioni i Qendres Rinore Lapardha	2025	-	-	39,713
Totali					**152,888**

Burimi: Bashkia Berat

Aktivet e afatgjata materiale (AAM) pasqyrat e konsoliduara:

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale", AAM sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Berat për vitin ushtrimor 2025, paraqiten me tepricë neto 3,925,640,930 lekë. Në vitin paraardhës, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 2,961,271,762 lekë. Gjatë viti 2025 kemi patur shtesë të AAM-ve blerje me pagesë në shumën 756,647,069 lekë, shtesa pa pagesë janë në shumën 1,420,696,263 lekë. Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2025 kanë qenë në vlerën 271,716,109 lekë dhe pakësime nga nxjerrje jashtë përdorimi janë në vlerën 20,059,364 lekë, pakësime të tjera në vlerën 848,968,885 lekë.

Pasqyra PF26: Detajet e nënrubrikës "*Aktive afatgjata materiale*".

Nr Llog	Emërtimi	Teprica neto në 31.12.2024	Shtesa 2025	Amortizim 2025	Pakësime neto 2025	Gjendja me 31.12.2025
210	Toka, Troje, Terrene	33,763,064	-	-	-	33,763,064
211	Pyje, Kullota, Plantacione	5,820,572	980,400	-	-	6,800,972
212	Ndërtime e Konstruksione	1,516,146,548	6,702,858	75,839,976	-	1,447,009,430
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	1,131,945,985	1,970,682,479	262,186,169	725,330,369	2,115,114,925
214	Instalime dhe paisje	38,436,089	8,663,969	6,855,548	5,349,036	34,893,475
215	Mjete Transporti	103,392,169	153,186,882	20,877,127	80,305,837	155,396,087
218	Inventar Ekonomik	131,767,335	37,123,744	23,977,637	12,252,464	132,662,977
	Shuma	**2,971,271,762**	**2,177,340,332**	**389,736,457**	**823,237,706**	**3,925,640,930**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Aktivet e afatgjata materiale (AAM) 2025:

Llogaritë e Klasës 21 "Aktivet Afatgjata Materiale" Bashkia Berat (aparati), AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2025, paraqiten me tepricë neto 1,066,689,363 lekë. Në vitin paraardhës 2024, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 1,137,921,574 lekë. Gjatë viti 2025 kemi patur shtesë të AAM-ve blerje me pagesë në shumën 740,485,127 lekë, shtesa pa pagesë jashtë sistemit janë në shumën 74,312,301 lekë. Shtesat kanë ardhur kryesisht si rezultat i investimeve të ndryshme në rrugë, rrjete, vepra ujore dhe blerje, në Bashkinë Berat dhe Agjencitë, Drejtoritë. Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2025 kanë qenë në vlerën 62,435,212 lekë dhe pakësimet neto në vlerën 823,441,538 lekë.

Pasqyra PF27: Detajet e nënrubrikës "*Aktive afatgjata materiale*".

Nr Llog	Emërtimi	Teprica neto në 31.12.2024	Shtesa 2025	Amortizim 2025	Pakësime neto 2025	Gjendja me 31.12.2025
210	Toka, Troje, Terrene	33,502,064	-	-	-	33,502,064
211	Pyje, Kullota, Plantacione	728,000	-	-	-	728,000
212	Ndërtime e Konstruksione	861,149,872	-	43,057,494	-	818,092,378
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	152,623,656	716,102,667	1,418,269	725,330,369	141,977,684
214	Instalime dhe paisje	11,930,292	5,553,600	2,386,058	5,553,600	9,544,234
215	Mjete Transporti	46,261,276	80,185,101	9,228,108	80,305,837	36,912,432
218	Inventar Ekonomik	31,726,414	12,803,172	6,345,283	12,251,732	25,932,571
	Shuma	**1,137,921,574**	**814,644,540**	**62,435,212**	**823,441,538**	**1,066,689,363**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Gjendja e llogarisë 210 *"Toka, troje terrene"* sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Berat është paraqitur me vlerë neto 33,502,064 lekë. Gjatë vitit 2025 llogaria 210 *"Toka, troje terrene"* nuk ka pasur shtesa.

Nga verifikimi dhe analiza llogaria 210 *"Toka, troje, terrene",* konstatohet se, nga ana e Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, nuk janë hedhur në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të; a) trojeve nën objekt, të objekteve si godina e Bashkisë dhe trualli përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, ndërtesat e shkollave dhe të zyrave në Njësive Administrative, etj., sipas regjistrit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 "Ndërtime e konstruksione" truallit të godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë, trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Berat, si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhej bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse.

Nga auditimi mbi saktësinë e Llogarisë 210 *"Toka, troje terrene"* rezultoi se kjo llogari nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2025. Kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale në llogarinë 210 *"Toka, troje terrene"* dhe paraqitja e gjendjes së kësaj llogarie në PF është e paplotë, pasi mungojnë analizat për të. Kjo llogari e pa analizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata

materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 27, 30*; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu III, pika 30.*

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit nga Bashkia Berat është paraqitur observacioni me shkresën nr. 5325 prot., datë 26.08.2026, administruar në KLSH me praktikën nr. 547/3 prot., datë 04.09.2026, nga znj. R. Sh dhe z. Xh. M ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me gjetjen 8 dhe rekomandimin 8.1, sqarojmë se Drejtoria e Financës dhe Buxhetit kryen regjistrimin dhe pasqyrimin kontabël të pronave në llogarinë 210 "Toka, troje, terrene", mbi bazën e dokumentacionit të pronësisë, inventarizimit, vlerësimit dhe dokumenteve të tjera justifikuese.

Drejtoria ka përgjegjësi për kërkimin dhe ndjekjen e sigurimit të këtij dokumentacioni, ndërsa identifikimi, inventarizimi, verifikimi i statusit të pronave dhe plotësimi i dokumentacionit realizohen nga strukturat përgjegjëse për administrimin e pronave.

Në rastet kur dokumentacioni i nevojshëm mungon, regjistrimi kontabël nuk mund të kryhet pa u krijuar më parë baza dokumentare përkatëse. Me disponimin e dokumentacionit, Drejtoria kryen regjistrimin dhe pasqyrimin kontabël.

Për sa më sipër, kërkojmë që në vlerësimin e gjetjes të merret në konsideratë ndarja e përgjegjësive ndërmjet strukturave përkatëse dhe fakti që Drejtoria e Financës dhe Buxhetit vijon të kërkojë dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e regjistrimeve kontabel.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në lidhje me observacioni e mësipërm rekomandimi do ti drejtohet edhe struktures përkatëse, Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Shërbimeve.***Sa më sipër observacioni i mësipërm merret në konsideratë në hartimin e raportit të auditimit.***

Gjendja e llogarisë 211 *"Pyje, Plantacione"* sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Berat është paraqitur me vlerë neto 6,800,000 lekë. Gjatë vitit 2025 llogaria 211 ka pasur shtesa në vlerën 980,400 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur konstatohet se në Bashkia Berat në kontabilitet nuk ka të pasqyruar vlerën e pyjeve dhe kullotave, të transferuara me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 *"Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive",* e ndryshuar, pika 6, shtojca me nr.4, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Berat,. Për këto sipërfaqe nuk është bërë verifikimi fizik i tyre me qëllim përcaktimin e vlerës kontabël të llogarisë nr. 211. Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i aseteve për llogarinë me sipër. Për llogaritë e mësipërme në Bashkinë Berat nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj. Pra, si rezultat i moszbatimit të kuadrit rregullator ligjor për transferimin e aktiveve, llogaria 211 *"Pyje Plantacione",* nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2025. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 1.2 "Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë";* Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pikat 26, 27, 30 dhe 74,* dhe Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të*

pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Kap III, pika 30, i ndryshuar.

Pasqyra PF28: Aktivet e kontabilizuara në llogarinë 211:

Nr Llog	Emërtimi	Viti	Lloji i aktivit	Kosto Historike
211	Blerje peme dekorative	2025	Peme Selvi	980,400
Total				**980,400**

Burimi: Bashkia Berat

Gjendja e llogarisë 212 ***"Ndërtesa dhe konstruksione"*** sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Berat për vitin ushtrimor 2025, paraqiten me tepricë neto 1,447,009,430 lekë. Në vitin paraardhës 2024, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 1,516,146,548 lekë.

Gjatë vitit 2025 ka patur shtesë të AAM-ve blerje me pagesë në shumën 6,702,858 lekë. Pakësime nga amortizimit gjatë vitit 2025 kanë qenë në vlerën 75,839,976 lekë

Pasqyra PF29: Detajet e nënrubrikës "*Ndërtesa dhe Konstruksione*".

Nr	Institucioni	Teprica neto në 31.12.2024	Shtesa 2025	Amortizim 2025	Pakësime neto 2025	Gjendja me 31.12.2025
1	Aparati i Bashkisë Berat	861,149,872	-	43,057,494	-	818,092,378
2	Agjencia e Shërbimeve Publike	138,439,952	-	6,921,997	-	131,517,955
3	Drejtoria e Arsimit	453,895,789	6,202,860	22,727,438	-	437,371,211
4	Drejtoria e Bujqesise	3,173,959	499,998	158,698	-	3,515,259
5	Qendra Margarita Tutulani	35,073,739	-	1,753,687	-	33,320,052
6	Qendra Lira	25,748,958	24,000	1,527,463	-	24,449,327
Total		**1,517,482,269**	**6,726,858**	**76,146,777**	**-**	**1,448,266,182**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Pasqyra PF30: Aktivet e kontabilizuara në llogarinë 212 *"Ndërtesa dhe Konstruksione":*

Nr Llog	Emërtimi	Kosto Historike	Amortizim i Akumuluar	Vlera neto kontabël 31.12.2025
DREJTORIA E ARSIMIT (1)				
212	Hidroizolimi i shkolles 9-vjecare "Z.T"	-	-	1,520,640
212	Punime ne permiresimin e infrastruktures ne arsimin baze,Shkolla Paftal,Njesia Administrative Sinje	-	-	1,632,840
212	Hidroizolimi dhe permiresim I rrjetit hidraulik te konviktit Kristo-Isak	-	-	3,049,380
DREJTORIA E BUJQESISE (2)				
212	Rikonstruksion Tarrace	-	-	499,998
Total (1+2)				**6,702,858**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Gjendja e llogarisë kontabël 212 ***"Ndërtesa dhe konstruksione"*** sipas të dhënave të pasqyrave financiare individuale të Bashkisë Berat për vitin ushtrimor 2025, paraqiten me tepricë neto 818,092,378 lekë. Në vitin paraardhës 2024, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 861,149,872 lekë. Gjatë vitit 2025 ka patur shtesë të AAM-ve në vlerën 6,726,858 lekë. Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2025 kanë qenë në vlerën 43,057,494 lekë dhe pakësime nga nxjerrje jashtë përdorimi ose lëvizje ndërmjet llogarive kanë qenë në shumën 0 lekë.

Gjendja e llogarisë kontabël 213 ***"Rrugë, rrjete, vepra ujore"*** sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Berat për vitin ushtrimor 2025, paraqiten me tepricë neto 2,115,114,925 lekë. Në vitin paraardhës 2024, vlera kontabël neto e llogarisë 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore*" paraqitet në shumën 1,970,685,479 lekë. Gjatë vitit 2025 kemi patur shtesë të

llogarisë 213 blerje me pagesë në shumën 718,073,067 lekë. Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2025 kanë qenë në vlerën 262,186,169 lekë.

Pasqyra PF31: Aktivet e kontabilizuara në llogarinë 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore":*

Nr	Emërtimi	Kosto Historike	Amortizim i Akumuluar	Vlera neto kontabël 31.12.2025
BASHKIA BERAT (1)				
1	Ndertim i linjes kryesore dhe shperndarjes se furnizimit me uje te Njesise Administrative Velabisht	-	-	157,711,616
2	Ndertim I Ujesjellesit ne Fshatin Duhanas, Lapardha 1,Otllak, Orizaj	-	-	443,360,476
3	Rokonstr rrugesh, trotuar dhe ndric,30 vjetori ish pjeshkorja	-	-	76,999,027
4	Rruga Antipatrea,Kryqezimi Spitali Rajonal-Kryqezimi Bypass (A. Konstruksion, B.Y, Unitec Studio)	-	-	25,951,278
5	Projekti i Roshnikut: Rivitalizimi i mjediseve atraktive turistike ne fshatin turistik Roshnik-projekti 100 fshatrat	-	-	12,080,270
AGJENSIA E SHERBIMEVE PUBLIKE (2)				
1	Ura Lapardha 2	-	-	10,201,272
2	Permiresimi urban I qytetit paketa 1 Gorica	-	-	417,183,549
3	Permiresimi urban I qytetit paketa 2 Rruga antipatrea dhe sheshi I .V	-	-	417,183,555
4	Rikualifikimi Urban I Unazes se Madhe	-	-	408,044,036
DREJTORIA E BUJQESISE (3)				
1	Veshje Me Beton Kanal Ujites Veterik	-	-	1,010,400
2	Veshje Me Beton Kanal Ujites Starove	-	-	960,000
Total (1+2+3)				**1,970,685,479**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Bashkia Berat (aparati) ka kontabilizuar 5 aktive në llogarinë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" për vitin 2025 në vlerën 716,102,667 lekë.

1-*"Ndërtimi i linjës kryesore dhe shpërndarja e furnizimit me ujë të Njësisë Velabisht"* me vlerë kontrate 437,990,401 lekë. Certifikata e marrjes përfundimtare në dorëzim të objektit është në datë 23.04.2025.

2-*"Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Duhanas, Lapardha"* me vlerë kontrate 154,991,516 lekë. Certifikata e marrjes përfundimtare në dorëzim të objektit është në datë 05.08.2025.

3-*"Rikonstruksion rrugësh, trotuar ndriçim"* me vlerë kontrate 76,903,433 lekë. Certifikata e marrjes përfundimtare në dorëzim të objektit është në datë 04.07.2025.

4-*"Rruga Antipatea, kryqezimi i spitalit rajonal"* me vlerë kontrate 27,386,832 lekë. Certifikata e marrjes përfundimtare në dorëzim të objektit është në datë 12.11.2025.

5-*"Projekti i Roshnikut, rivitalizimi i mjediseve atraktive"* me vlerë kontrate 11,803,107 lekë. Certifikata e marrjes përfundimtare në dorëzim të objektit është në datë 10.04.2025.

Agjencia e Shërbimeve Publike ka kontabilizuar 4 aktive në llogarinë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" për vitin 2025 në vlerën 1,252,612,412 lekë.

1-*"Rikualifikim urban i unazës së re Berat"* me vlerë kontrate 408,044,036 lekë, ky investim është kryer nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Certifikata e marrjes përfundimtare e dorëzimit të objektit është në datë 23.04.2025.

2-*"Përmirësimi i integruar urban i qytetit të Beratit, paketa 1 Goricë"* me vlerë kontrate 407,147,500 lekë, ky investim është kryer nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Certifikata e marrjes përfundimtare e dorëzimit të objektit është në datë 01.07.2025.

3-*"Përmirësimi i integruar urban i qytetit të Beratit, paketa 1 Goricë"* me vlerë kontrate 407,147,500 lekë, ky investim është kryer nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Certifikata e marrjes përfundimtare e dorëzimit të objektit është në datë 30.06.2025.

Pasqyra PF32: Aktivet e pakësuara në llogarinë 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore":*

Nr	Emërtimi	Kosto Historike	Amortizim i Akumuluar	Vlera neto kontabël 31.12.2025
BASHKIA BERAT				
1	KUZ Veterik	11,911,810	2,293,024	9,618,786
2	Ujesjellesi Roshnik	64,269,939	12,371,963	51,897,976
3	Ujesjellesi I Paftalit	9,466,265	1,822,256	7,644,009
4	Ndertim linje furnizimi me uje Uznove Bilc	4,987,735	960,139	4,027,596
5	Ujesjelles Mbreshtan Njesia administrative Sinje	27,984,481	3,615,433	24,369,049
6	Ndertim rrjeti KUZ ne fshatin Lapardha 1,2,Drobonik	30,64,3503	3,942,641	26,700,862
7	Ndertim i linjes kryesore dhe shperndarjes se furnizimit me uje te Njesise Administrative Velabisht	157,711,616		157,711,616
8	Ndertim I Ujesjellesit Ne Fshatin Duhanas, Lapardha 1,Otllak, Orizaj	443,360,476		443,360,476
Totali		**750,332,675**	**25,005,456**	**725,327,219**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Me shkresën nr. 6769/1 prot., datë 22.12.2025 janë transferuar tek "Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime" Sh.a aktivet e mësipërme.

Gjendja e llogarisë kontabël 214 *"Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune".* Kjo llogari përfaqëson makineri paisje dhe vegla pune në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Berat. Sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Berat gjendja e llogarisë 214 më 31.12.2025 paraqitet me vlerë neto kontabël 124,220,652 lekë.

Gjatë vitit 2025 kjo llogari ka pasur shtesa në vlerën 8,663,969 lekë. Kjo shtesë në llogarinë 214 është përfituar nga blerje me pagesë në shumën 3,061,369 lekë, blerje pa pagesë në vlerën 49,000 lekë dhe lëvizje brenda sistemit 5,553,600 lekë. Vlera prej 5,602,600 lekë i përket donacioneve të dhëna nga OJF për paisje për funksionimin e Drejtorisë.

Pasqyra PF33: Shtesat gjatë vitit 2023 në llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune":

			Pa pagesë		
Nr	**Njësitë shpenzuese**	**Blerje me pagesë**	**Jashtë sistemit**	**Brenda sistemit**	**Lëvizje brenda aktiveve**
1	Bashkia	-	-	5,553,600	-
2	ASHP	1,680,300	-	-	-
3	Drejtori e Arsimit	1,238,269	49,000	-	-
4	Qendra M .T				
5	Drejtori e Bujqesise	142,800	-	-	-
6	Qendra L	-	-	-	-
Total		**3,061,369**	**49,000**	**5,553,600**	**-**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Gjatë vitit 2025 llogaria 214 *"Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune"* është pakësuar për vlerën 15,529,750 lekë. Pakësimi i llogarisë së mësipërme vjen nga procedura e nxjerrjes nga përdorimi.

Pasqyra PF35: Pakësimet gjatë vitit 2023 në llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune":

		Pakësimet	
Nr	**Njësitë Shpenzuese**	**Kosto Historike**	**Amortizim**
1	Drejtoria e Arsimit	9,976,150	9,976,150
Total		**9,976,150**	**9,976,150**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Në aneksin 2/3/1 në anekset e raportit të auditimit paraqiten të dhënat e llogarisë 214

"Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune" sipas pasqyrave individuale të Bashkisë Berat dhe Njësive Shpenzuese të tjera.

Gjendja e llogarisë kontabël 215 *"Mjete transporti"*. Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve te transportit në pronësi të Bashkisë Berat.
Sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të në datën 31.12.2025, Bashkia disponon 64 mjete me kosto historike 359,312,641 lekë, amortizim të akumuluar në shumën 169,729,111 lekë dhe me vlerë neto kontabël 155,396,087 lekë.
Bashkia gjatë vitit 2025 ka blerë më pagesë më anë të procedurave të prokurimit me vlerë 10,326,000 lekë.
Në aneksin 2/3/2 në anekset e raportit të auditimit paraqiten të dhënat e llogarisë 215 *"Mjete Transporti"*.
Pasqyra PF34: Aktivet e pakësuara në llogarinë 215 *"Mjete Transporti":*

Nr	Emërtimi	Kosto Historike	Amortizim i Akumuluar	Vlera neto kontabël 31.12.2025
Qendra Lira				
1	Autobus Volkswagen AB623KG	1,114,542	1,114,542	0

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Me shkresen nr.334 prot. datë 30.12.2025 *"Mbi miratimin e procedurës së ndjekur për inventarizimin dhe vlerësimin e automjetit autobuz volksëagen me targa AB 623 KG të Qendrës Lira"*, Kryetari i Bashkise ka miratuar:

1. Proceduren e ndjekur nga komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit te **Automjetit Autobus Volksëagen me targe AB 6 K** të Qendres L ; ngritur me Urdhërin e titullarit te institucionit me Nr. 26 datë 21.11.2025, me nr. 290 prot. dt. 21.11.2025, *"Për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve për vitin 2025", i ndryshuar* me Urdhërin Nr. 30 datë 15.12.2025, me nr. 317 prot. Dt. 15.12.2025, *"Per ndryshim ne Urdhërin e titullarit te institucionit me Nr. 26 datë 21.11.2025, me nr. 290 prot. Dt. 21.11.2025"* .
2. Nxjerrjen jashtë përdorimit të **Automjetit Autobus Volkswagen me targë AB G** të Qendres L, nëpërmjet shitjes si hekurishte (skrap).

Gjendja e llogarisë kontabël 218 *"Inventar ekonomik".* Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Berat. Sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Berat gjendja e llogarisë 218 më 31.12.2025 paraqitet me vlerë neto kontabël 132,662,977 lekë.
Gjatë vitit 2025 kjo llogari ka pasur shtesa në vlerën 37,123,744 lekë. Kjo shtesë në llogarinë 218 është përfituar nga blerje me pagesë në shumën 14,385,895 lekë, blerje pa pagesë në vlerën 17,168,649 lekë dhe lëvizje të aktiveve në vlerën 5,569,200 lekë. Informacioni për ndryshimet e ndodhura në llogarinë 218 gjatë vitit 2025 gjendet në tabelën e mëposhtme.
Pasqyra PF35: Shtesat gjatë vitit 2023 në llogarinë 218 "Inventar Ekonomik":

			Pa pagesë		
Nr	**Njësitë shpenzuese**	**Blerje me pagesë**	**Jashtë sistemit**	**Brenda sistemit**	**Lëvizje brenda aktiveve**
1	Bashkia	12,803,172	-	-	-
2	ASHP	-	-	5,520,000	-
3	Drejtoria e Arsimit	875,979	17,168,649	-	-
4	Qendra M. T	169,600	-	-	-
5	Drejtoria e Bujqesise	513,144	-	49,200	-
6	Qendra L	24,000	-	-	-
Total		**14,385,895**	**17,168,649**	**5,569,200**	**-**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Gjatë vitit 2025 llogaria 218 "Inventar Ekonomik" është pakësuar për vlerën 12,958,640 lekë. Pakësimi i llogarisë 218 vjen nga procedura e nxjerrjes nga përdorimi sipas tabelës së mëposhtme.

Pasqyra PF36: Pakësimet gjatë vitit 2025 në llogarinë 218 "Inventar ekonomik":

		Pakësimet	
Nr	**Njësitë Shpenzuese**	**Kosto Historike**	**Amortizim**
1	Bashkia	12,958,640	706,908
2	ASHP	-	-
3	Drejtoria e Arsimit	7,559,986	7,559,986
4	Qendra M .T	-	-
5	Drejtoria e Bujqësisë	-	-
6	Qendra L	6,500	5,768
Total		**20,525,126**	**8,272,662**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Llogaria 219 "Amortizimi i AAGJM & AAJM: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Berat në fund të vitit 2025, paraqitet në vlerën 1,987,766,464 lekë që ka të bëjë me amortizimin e akumuluar me datë 31.12.2025. Krahasuar me vitin 2024 llogaria 219 "Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara" paraqitet me shtesë prej 363,418,278 lekë, shtesë e cila ka të bëjë me amortizimin vjetor të vitit 2025.

Në aneksin nr 2/3/3 në anekset e raportit të auditimit është paraqitur amortizimi i AAGJ.

Përllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr 05 datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura nga Bashkia Berat, janë si më poshtë:

- Ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5 %
- Inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi) 20 %
- Për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25%
- Për mjetet e transportit 20%
- Për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare) 15 %

Aktivet Afatgjata Financiare

Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund të vitit 2025 është regjistruar në vlerën 60,091,462 lekë.

- Bashkia Berat në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 23.01 % të aksioneve të "Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat" sh.a me NUIS MO

e cila është shoqëri aksionere me objekt, *"Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve".*

Numri i aksioneve është 23,010 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 2,310,000 lekë.

- Bashkia Berat në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të "F. T" sh.a me NUIS L13 e cila është shoqëri aksionere me objekt, *"Organizimi i aktiviteteve sportive në fushën e futbollit, krijimi i ekipeve zinxhir".*

Kapital në vlerë monetare prej 2,000,000 lekë.

- Bashkia Berat në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të "B. C" sh.a me NUIS K83 e cila është shoqëri aksionere me objekt, *"Fuksionimi i tregut me shumicë fruta-perime. Dhënie me qira e hapsirave dhe ambienteve personave fizike dhe juridike".* Referuar informacionit dhe dokumentacionit të audituar vlera e kapitalit e kësaj shoqërie është 55,790,462 lekë.

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit nga Bashkia Berat është paraqitur observacioni me shkresën nr. 5325 prot., datë 26.08.2026, administruar në KLSH me praktikën nr. 547/3 prot., datë 04.09.2026, nga znj. R. Sh dhe z. Xh. M ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Ne lidhje me konstatimin nr.10 e paraqitur nga ana e grupit te auditimit te Kontrollit te Larte te Shtetit, lidhur me faktin se llogaria 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet nuk eshte pasqyruar ne menyre te sakte ne Bilancin e Bashkise Berat, sqarojme sa me poshte:

Per verifikimin, rakordimin dhe evidentimin e sakte te vlerave qe duhet te pasqyrohen ne llogarine 26, nga ana e institucionit jane ndermarre veprime konkrete, duke iu drejtuar me shkresa zyrtare shoqerive aksionere perkatese, me qellim konfirmimin dhe saktesimin e te dhenave qe lidhen me pjesemarrjen e Bashkise Berat ne kapitalin e tyre.

Konkretisht. Bashkia Berat i eshte drejtuar shkrese zyrtare shoqerive aksionere perkatese perkatesisht me shkresen nr. 1284 date 05.03.2025, duke kerkuar informacion dhe dokumentacion perkates mbi vleren e pjesemarrjes se Bashkise ne kapitalin aksionar te ketyre shoqerive.

Shoqerite Aksionere i jane përgjigjur Bashkise Berat si me poshte:

1. Shoqeria Rajonale e Ujesjelles Kanalizime me shkresen nr.292/1 date 11.03.2025, ka konfirmuar se: Bashkia Berat eshte aksionare me 23,01% te aksioneve ose ne vlere kapitali 2.301.000 leke (10,000,000 23,01%) ne Shoqerine e re te krijuar "Shoqeria Rajonale e Ujesjelles Kanalizime. Sha.
2. F.K Tomori 1923 me shkresen nr.20 date 10.03.2025 ka konfirmuar se: Bashkia Berat eshte aksionare 100% ne shoqerine "F T dhe vlera e kapitalit ne kete shoqeri eshte 2,000,000 leke.
3. Shoqëria B Csha me shkresen nr.50/1 date 06.03.2025 ka konfirmuar se: Bashkia Berat eshte aksionare 100% ne shoqerine "BC" sha dhe vlera e kapitalit te Bashkise Berat ne kete shoqeri eshte ne vleren 55,790,462 leke.

Drejtoria e Finances dhe Buxhetit e Bashkise Berat ka pasqyruar ne aktive pjesemarrjen ne kapital ne keto tre shoqeri dhe total ne pasqyren e pozicionit financiar te konsoliduar eshte paraqitur vlera 60,091,462 leke (2,301,000+55,790,462+2,000,000).

Ne vijim te konstatimit te paraqitur lidhur me mosperputhjen ndermjet vleres se komunikuar nga shoqeria BCG, nepermjet shkreses perkatese, dhe vleres se regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit (QKR), sqarojme se kjo mosperputhje lidhet me procesin e vleresimit te kapitalit te shoqerise.

Konkretisht, vlera e paraqitur nga shoqeria BC me shkresen perkatese nuk perputhet me vleren e pasqyruar aktualisht ne regjistrin e QKR-se, pasi shoqeria eshte ne pritje te perfundimit te procesit te vleresimit nga eksperti kontabel qe te perputhet vlera e kapitalit qe rezulton ne Bilancin e shoqerise me vleren qe paqaqitet ne QKR.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në lidhje me rekomandimin e mësipërm dokumentacioni dhe shkresat e përcjell nga subjekti pranohen dhe do të merren në konsideratë në hartimin e raportit të auditimit. ***Sa më sipër observacioni i mësipërm merret në konsideratë në hartimin e raportit të auditimit.***

Investimet:

Sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Berat për vitin ushtrimor 2025, paraqiten me tepricë neto 2,040,786,335 lekë. Në vitin paraardhës 2024, vlera e llogarisë 231 paraqitet në shumën 2,514,688,876 lekë.

Referuar udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022 *"Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* këto llogari paraqesin vlerën e investimeve në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 "*Aktive afatgjata materiale*".

Në aneksin 2/3/4 në anekset e raportit të auditimit paraqiten investimet në proces të kontabilizuara në llogarinë 231 "*Investimet për aktivet afatgjata* "

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit nga Bashkia Berat është paraqitur observacioni me shkresën nr. 5325 prot., datë 26.08.2026, administruar në KLSH me praktikën nr. 547/3 prot., datë 04.09.2026, nga znj. R. Sh dhe z. Xh. M ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me gjetjen 11 dhe rekomandimin 11.1, sqarojmë se konkluzioni i paraqitur në Projekt-Raport rezulton të jetë ndikuar nga informacioni i paplotë jo i qartë i vënë në dispozicion nga ana jonë gjatë procesit të auditimit.

Për të saktësuar situatën, Bashkia Berat po vë në dispozicion analizën e detajuar të llogarisë 231 "Investime për aktive afatgjata materiale", e cila paraqet lëvizjen e kësaj llogarie nga gjendja më 31.12.2024 deri në gjendjen më 31.12.2025, sipas investimeve dhe dokumentacionit përkatës.

Nga analiza rezulton se vlera e pasqyruar në llogarinë 231 në pasqyrat financiare të vitit 2025 është e rakorduar me lëvizjet e kësaj llogarie dhe i përket investimeve të cilat, në datën e raportimit, rezultojnë ende në proces dhe nuk kanë përmbushur kushtet për transferimin e tyre në llogaritë e aktiveve afatgjata materiale të përfunduara.

Për sa më sipër, kërkojmë që, bazuar në dokumentacionin dhe analizën e detajuar të llogarisë 231 që po paraqesim, gjetja dhe rekomandimi 11.1 të rishikohen, pasi pasqyrimi i kësaj llogarie në pasqyrat financiare rezulton i mbështetur në dokumentacionin kontabël dhe në gjendjen faktike të investimeve në proces.

Gjendja e llogarise ne fund te vitin 2024 ne shumen 2,514,688,876 leke.

Likujdimet e investimeve te regjistruara ne llogarine 231 gjate vitit 2025 ne shumen 240,554,203 leke.

Investime te perfunduara per te cilat eshte cliruar garancia dhe kane kaluar ne klasat 2 ne shumen 714,456,744 leke.

Gjendja e llogarise ne fund te vitin 2025 ne shumen 2,040,786,335 leke.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në lidhje me observacionin e përcjell nga subjekti Bashkia Berat për rekomandimin nr.11 për llogarinë 231 *"Investime për aktive afatgjata materiale"* për të cilin referuar informacionit të përcjell nga subjekti gjatë fazës së terrenit ka qënë i pa plotë dhe duke mos përcjell informacionin e plotë për aktivet në proces të kontabilizuar në këtë llogari. Subjekti ka përcjell listën e plotë të investimeve në të cilën përfshihet gjendja në datën 31.12.2024, shtesat dhe pakësimet gjatë vitit 2025 dhe gjendja në fund të vitit 2025. ***Sa më sipër observacioni i mësipërm merret në konsideratë në hartimin e raportit të auditimit.***

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Berat më 31.12.2025, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2025, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2025, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Pasqyra PF37: Detajet e nënrubrikës "*Llogari të pagueshme*".

Llogaritë		Viti 2025
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	4,526,552
42	Detyrime ndaj personelit	47,297,760
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	4,239,213
435	Sigurime shoqërore	14,275,015
436	Sigurime shëndetësore	1,964,925
464	Detyrime për t'u paguar për blerjen e letrave me vlerë	3,207,759
467	Kreditor të ndryshëm	127,779,017

Burimi: Bashkia Berat

Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në datën 31.12.2023 për vlerën 4,526,552 lekë.

Referuar pasqyrave individuale të njësive shpenzuese në Bashkinë Berat kemi të dhënat si më poshtë:

Pasqyra PF38: Detajet e nënrubrikës "*401-408*".

Llogaria	Institucioni	Shuma
401-408	Bashkia Berat (aparati)	535,320
401-408	Agjensia e Shërbimeve Publike	2,409,086
401-408	Drejtoria e Arsimit	1,492,638
401-408	Drejtoria e Bujqësisë	-
401-408	Qendra Margarita Tutulani	-
401-408	Qendra Lira	89,508
Totali		**4,526,552**

Burimi: Bashkia Berat

Pasqyra PF39: Detajet e nënrubrikës "*Furnitorë e llogari të lidhura me to".*

Nr	Objekti i faturës	Data dhe numri	Vlera e fatures me tvsh	Gjendja date 01.01.2025	Shtesa 2025	Pakesime 2025	Gjendja 31.12.2025
Bashkia Berat							
6	Blerje karburant	14.11.2025			349,440		349,440
81	Pjese kembimim per mjetin me targe AA225NK	23.12.2025			133,200		133,200
82	Pjese kembimi per mjetin me targe AA812IZ	24.12.2025			52,680		52,680
Agjencia Sherbimeve Publike							
1	Blerje Karburant	27.11.2026	580,694				580,694
2	Blerje Karburant	15.12.2026	249,374				249,374
3	Blerje Karburant	15.12.2026	91,618				91,618
4	Blerje Karburant	22.12.2026	507,000				507,000
5	Blerje Fishkezjarre	31.12.2026	980,400				980,400
Drejtoria e Arsimit							
1	Blerje produkte ushqimore kopshte,cerdhe dhe konvikt	19.01.2026	1,492,638	-	1,492,638	0	1,492,638
Qendra Kulturore "Margarita Tutulani"							
	Fatura				1,293,800	1,293,800	-
Drejtoria e Bujqesise							
	Furnizime fatura			-	7,421,090	7,421,090	-
Qendra Lira							
1	Blerje ushqime	31.12.2024	331,506	331,506	0	331,506	-
2	Blerje dekori per festate e fund vitit	23.12.2024	34,990	34,990	-	34,990	-
3	Blerje ushqime	23.12.2025			89,508	-	89,508
Total				**366,496**	**1,918,628**	**1,660,296**	**4,526,552**

Burimi: Bashkia Berat

Llogaria 42, "Detyrime ndaj personelit", sipas pasqyrave financiare të konsoliduara, paraqitet në vlerën 47,297,760 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, dhe janë paguar ne muajin janar 2026 në vlerën 47,297,760 lekë.
Llogaria 431, "Detyrime ndaj shteti për tatim taksa", paraqitet në vlerën 4,239,213 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor është paguar në janar 2026 në vlerën 4,239,213 lekë.
Llogaria 435, "Sigurime shoqërore" dhe llogaria 436 "Sigurime shëndetësore" paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 14,275,015 lekë dhe 1,964,925 lekë.

Llogaria 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje", sipas pasqyrës së konsoliduar të pozicionit financiar të Bashkisë Berat, në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 104,519,774 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit. Vlera e kontabilizuar në llogarinë 466 *" Kreditore për mjete nën ruajtje"* i përket njësive shpenzuese si më poshtë:

Pasqyra PF40: Detajet e nënrubrikës "Kreditorë për mjete në ruajtje".

Llogaria	Institucioni	Shuma
466	Bashkia Berat (aparati)	103,743,001
466	Agjensia e Shërbimeve Publike	215,279
466	Drejtoria e Arsimit	438,086

466	Drejtoria e Bujqësisë	-
466	Qendra M. T	-
466	Qendra L	-
Totali		**104,396,366**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Llogaria 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje" (Bashkia Berat): Referuar pasqyrës individuale të pozicionit financiar për Bashkinë Berat kjo llogari është regjistruar për vlerën 103,743,001 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2025, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve private, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466. Në mënyrë analitike, garancitë e të cilave u ka kaluar afati i shlyerjes, si dhe objekti për të cilën është mbajtur kjo garanci ka përfunduar, paraqiten **në aneksin 2/3/5** në anekset e projekt raportit të auditimit.

Llogaria 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje" është mbivlerësuar për 48,573,386 lekë, veprim ky në kundërshtim me udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar, pika 3.2 "Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4".*

Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje" duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Veprimet dhe mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",* Kap. III, pikat 30, 50, ku përcaktohet:

Pika 30:"*Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet*",

Pika 50: "*Tepricat e llogarisë 520, "Disponibilitete në thesar" dhe të llogarisë 466, "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt rakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuara sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet)*".

UKM nr. 3, datë 15.02.2011 "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar, Kap. II, pika 10 ku përcaktohet:

Pika 10: "*Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për difektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.*"

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit nga Bashkia Berat është paraqitur observacioni me shkresën nr. 5325 prot., datë 26.08.2026, administruar në KLSH me praktikën nr. 547/3 prot., datë 04.09.2026, nga znj. R. Sh dhe z. Xh. M ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me gjetjen 12 dhe rekomandimin 12.1, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e vlerëson gjetjen lidhur me nevojën për sistemimin e llogarisë 466. Megjithatë, sqarojmë se çlirimi dhe likuidimi i garancive nuk mund të kryhet nga kjo Drejtori në mungesë të dokumentacionit përkatës.
Procedurat për marrjen përfundimtare në dorëzim të objekteve, verifikimin e përmbushjes së kushteve të kontratës dhe dokumentimin e përfundimit të periudhës së garancisë janë përgjegjësi e strukturës përgjegjëse për ndjekjen dhe monitorimin e investimeve. Pas paraqitjes së dokumentacionit të përcaktuar nga legjislacioni, Drejtoria e Financës kryen veprimet kontabël dhe financiare për sistemimin dhe çlirimin e garancive në llogarinë 466.
Për këtë arsye, përgjegjësia për mosçlirimin e garancive nuk mund t'i atribuohet Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave.
Qëndrimi i Grupit të Auditimit:
Në lidhje me rekomandimin e mësipërm gjetja e mësipërme nuk kundërshtohet nga subjekti por vetëm ndarja e përgjegjësive. Në rekomandim do të përfshihen të gjitha strukturat të cilat kanë përgjegjësi për situatën e mësipërme.
Sa më sipër observacioni i mësipërm merret në konsideratë në hartimin e raportit të auditimit.

Llogaria 467 "Kreditore të ndryshëm", sipas pasqyrës së pozicionit financiar të konsoliduara të Bashkisë Berat, në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 127,779,017 lekë.
Pasqyra PF41: Detajet e nënrubrikës "*Kreditorë të ndryshëm"*

Llogaria	Institucioni	Shuma
467	Bashkia Berat (aparati)	115,498,361
467	Agjensia e Shërbimeve Publike	8,306,922
467	Drejtoria e Arsimit	3,845,892
467	Drejtoria e Bujqësisë	10,040
467	Qendra M .T	49,374
467	Qendra L	68,428
Totali		**127,779,017**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2025, të ardhurat janë në vlerën 2,037,886,338 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Berat paraqitet më poshtë:
Gjendja e llogarisë sintetike ***70*** **"Të ardhurat nga taksat dhe tatimet"** paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 266,782,454 lekë e cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.
a. Gjendja e llogarisë analitike ***7002*** **"*Tatim mbi Biznesin e vogël*"** pasqyrohet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 147,698 lekë e cila përfshin *taksën mbi Biznesin e vogël* , e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.
b. Gjendja e llogarisë ***7020 "Tatim mbi pasurinë e paluajtshme"*** pasqyrohet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 67,640,166 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.
c. Gjendja e llogarisë ***7035 "Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie"*** pasqyrohet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 196,289,416 lekë e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.
- Gjendja e llogarisë ***71*** **"Të ardhurat jo tatimore"** paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 169,434,849 lekë i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.
a. Gjendja e llogarisë ***7109*** "***Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia"*** paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 36,170,878 lekë e cila përfshin, taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe nga pyjet, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.
b. Gjendja e llogarisë ***711*** "***Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare"*** paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 133,263,971 lekë. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Analiza e llogarive të shpenzimeve në vitin 2025, të cilat në total janë në vlerën 1,850,824,705 lekë paraqitet më poshtë:
- Gjendja e llogarisë ***600 'Paga, shpërblime e të tjera personeli"*** për vitin 2025, paraqitet në bilanc në vlerën 699,610,251 lekë, sipas akt-rakordimit me thesarin për vitin 2025 nuk ka diferenca.
- Gjendja e llogarisë ***601 'Kontribute për sigurime"*** për vitin 2025, paraqitet në bilanc në vlerën 114,510,509 lekë, sipas akt-rakordimit me thesarin për vitin 2025, nuk ka diferenca.
- Gjendja e llogarisë ***602 "Blerje mallra e shërbime"*** paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 445,366,708 lekë sipas akt-rakordimit me Thesarin për vitin 2025 janë në vlerën 445,366,708 lekë diferenca nuk ka.
- Gjendja e llogarisë së fondeve ***606 "Transferime për Buxhetet familjare e Individë"*** paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 457,410,503 lekë, sipas aktrakordimit me Thesarin për vitin 2025 nuk ka pasur diferenca.

Për vitin 2025 totali i te ardhurave ne vlere është 2,037,886,338 lekë dhe totali shpenzimeve është 1,850,824,705 lekë. Diferenca e tyre ne vlerën 187,061,633 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 "Rezultatin e ushtrimit".

Në aneksin nr. 2/3/6 në anekset e raportit të auditimit paraqitet analiza e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 *"Pasqyra e performancën financiare"* të PF të vitit 2025.

Transaksionet financiare nëpërmjet thesarit.
Grupi i Auditimit verifikoi pagesat e kryera nga thesari për pagesat e kryera gjate vitit 2025 nga Bashkia Berat (aparati) dhe Agjensia e Shërbimeve Publike.
Pagesat e kryera nga Bashkia Berat gjate vitit 2025:
1- Urdhër shpenzimi nr.981, datë 30.12.2025 me vlerë 6,681,4989 lekë, (dokumentacioni justifikues për këtë urdhër shpenzim është).
-Fatura tatimore me datë 29.12.2025 me vlerë fature 6,681,498 lekë;
-Situacion nr.2 me vlerë 6,681,498 lekë situacioni është i firmosur nga mbikqyrësi i punimeve, operatori ekonomik i kontraktuar dhe autoriteti kontraktor.
2- Urdhër shpenzimi nr.1025, datë 31.12.2025 me vlerë 1,856,029 lekë, (dokumentacioni justifikues për këtë urdhër shpenzim është).
-Fatura tatimore me datë 31.12.2025 me vlerë fature 1,856,029 lekë;
-Situacion nr.3 me vlerë 1,856,030 lekë situacioni është i firmosur nga mbikqyrësi i punimeve, operatori ekonomik i kontraktuar dhe autoriteti kontraktor.
3- Urdhër shpenzimi nr.469, datë 18.07.2025 me vlerë 2,274,390 lekë, (dokumentacioni justifikues për këtë urdhër shpenzim është).
-Fatura tatimore me datë 14.07.2025 me vlerë fature 2,274,390 lekë;
-Situacion përfundimtar me vlerë 2,274,390 lekë situacioni është i firmosur nga mbikqyrësi i punimeve, operatori ekonomik i kontraktuar dhe autoriteti kontraktor.
- Procesverbali i kolaudimit me datë 20.06.2025 i firmosur nga kolaudatori.
- Certifikata e marrjes në dorëzim të objektit me datë 20.06.2025 i firmosur nga kolaudatori.
4- Urdhër shpenzimi nr.470, datë 21.07.2025 me vlerë 8,868,672 lekë, (dokumentacioni justifikues për këtë urdhër shpenzim është).
-Amendim i kontratës me nr.774/2, datë 12.02.2025;
-Amendim i kontratës me nr.774/4, datë 28.03.2025;

-Fatura tatimore me datë 03.07.2025 me vlerë fature 8,868,672 lekë;
-Situacion përfundimtar me datë 30.04.2025 me vlerë 8,868,672 lekë situacioni është i firmosur nga mbikqyrësi i punimeve, operatori ekonomik i kontraktuar dhe autoriteti kontraktor.
- Procesverbali i kolaudimit me datë 02.07.2025 i firmosur nga kolaudatori.
- Certifikata e marrjes në dorëzim të objektit me datë 08.07.2025 i firmosur nga kolaudatori.
5- Urdhër shpenzimi nr.666, datë 24.09.2025 me vlerë 6,720,000 lekë, (dokumentacioni justifikues për këtë urdhër shpenzim është).
-Fatura tatimore me datë 22.08.2025 me vlerë fature 11,426,400 lekë;
-Fletë hyje me datë 22.08.2025;
-Procesverbal i marrjes në dorëzim me datë 22.08.2025 nga komisioni i marrjes në dorëzim;
6- Urdhër shpenzimi nr.724, datë 15.10.2025 me vlerë 116,160 lekë, (dokumentacioni justifikues për këtë urdhër shpenzim është).
-Fatura tatimore me datë 31.12.2024 me vlerë fature 117,030 lekë;
-Korrigjim fature me datë 25.09.2025 me vlerë fature 116,160 lekë;
-Situacion përfundimtar me datë nr.3 me vlerë 116,160 lekë situacioni është i firmosur nga mbikqyrësi i punimeve, operatori ekonomik i kontraktuar dhe autoriteti kontraktor.
- Procesverbali i kolaudimit me datë 26.02.2025 i firmosur nga kolaudatori.
- Certifikata e marrjes në dorëzim të objektit me datë 18.09.2025 i firmosur nga kolaudatori.
7- Urdhër shpenzimi nr.734, datë 16.10.2025 me vlerë 1,500,320 lekë, (dokumentacioni justifikues për këtë urdhër shpenzim është).
-Fatura tatimore me datë 07.04.2025 me vlerë fature 4,000,320 lekë;
-Situacion nr.1 me vlerë 4,000,000 lekë situacioni është i firmosur nga mbikqyrësi i punimeve, operatori ekonomik i kontraktuar dhe autoriteti kontraktor.
8- Urdhër shpenzimi nr.955, datë 24.12.2025 me vlerë 3,800,924 lekë, (dokumentacioni justifikues për këtë urdhër shpenzim është).
-Fatura tatimore me datë 23.12.2025 me vlerë fature 3,800,924 lekë;
-Situacion nr.2 me vlerë 3,800,924 lekë situacioni është i firmosur nga mbikqyrësi i punimeve, operatori ekonomik i kontraktuar dhe autoriteti kontraktor.
9- Urdhër shpenzimi nr.956, datë 24.12.2025 me vlerë 2,085,694 lekë, (dokumentacioni justifikues për këtë urdhër shpenzim është).
-Fatura tatimore me datë 16.12.2025 me vlerë fature 2,085,694 lekë;
-Situacion nr.2 me vlerë 2,085,694 lekë situacioni është i firmosur nga mbikqyrësi i punimeve, operatori ekonomik i kontraktuar dhe autoriteti kontraktor.
10- Urdhër shpenzimi nr.992, datë 31.12.2025 me vlerë 12,394,200 lekë, (dokumentacioni justifikues për këtë urdhër shpenzim është).
-Fatura tatimore me datë 31.12.2025 me vlerë fature 12,394,200 lekë;
-Situacion nr.8 me vlerë 12,394,200 lekë situacioni është i firmosur nga mbikqyrësi i punimeve, operatori ekonomik i kontraktuar dhe autoriteti kontraktor.
11- Urdhër shpenzimi nr.993, datë 31.12.2025 me vlerë 12,767,109 lekë, (dokumentacioni justifikues për këtë urdhër shpenzim është).
-Fatura tatimore me datë 31.12.2025 me vlerë fature 12,767,109 lekë;
-Situacion nr.1 me vlerë 12,767,109 lekë situacioni është i firmosur nga mbikqyrësi i punimeve, operatori ekonomik i kontraktuar dhe autoriteti kontraktor.
12- Urdhër shpenzimi nr.994, datë 31.12.2025 me vlerë 1,285,850 lekë, (dokumentacioni justifikues për këtë urdhër shpenzim është).
-Fatura tatimore me datë 30.12.2025 me vlerë fature 1,285,850 lekë;

-Situacion me vlerë 12,767,109 lekë situacioni është i firmosur nga mbikqyrësi i punimeve dhe autoriteti kontraktor.
13- Urdhër shpenzimi nr.996, datë 31.12.2025 me vlerë 5,000,000 lekë, (dokumentacioni justifikues për këtë urdhër shpenzim është).
-Vendim nr.67, datë 07.03.2023 nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë;

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. E. C me detyrë Kryetar i Bashkisë Berat
2. Znj. R. Sh me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave
3. Znj. K. S me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës Agjencia e Shërbimeve Publike

4. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Për sa më poshtë në mbështetje të shkronjave (a), (b) dhe (c) të nenit 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit", Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 86/10 prot. datë 28.10.2025 i ka dërguar Bashkisë Berat, "Raportin përfundimtar", për përmirësimin e gjendjes, si dhe ka rekomanduar zbatimin e masave të mëposhtme:

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.
-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Bashkia Berat *ka respektuar* këtë afat, duke kthyer përgjigje sipas shkresës me nr.6262/1 prot., datë 18.11.2025, planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.
Bashkia Berat me shkresën nr. 2664 prot., datë 28.04.2026 ka dërguar në KLSH, raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit prej 6-muajsh, sipas përcaktimit të bërë në pikën 2 të nenit 30 të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

III. Rekomandimet e KLSH
Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me Nr. 6262/1 prot., datë 18.11.2025, janë rekomanduar gjithsej 34 rekomandime:
a. Janë rekomanduar **22 masa organizative**;
b. Janë rekomanduar **4 masa për shpërblim dëmi në vlerën 3,894,590,74 lekë;**
c. Janë rekomanduar **5 masa për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia;**

d. Janë rekomanduar **2 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet;**
e. Janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Berat që të shqyrtojë raportin përfundimtar të auditimit dhe ti kërkojë komisionit vendosjen e **masave disiplinore për 14 punonjës** të cilat janë trajtuar në raportin përfundimtar.

IV. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me Nr. 6262/1 Prot., datë 18.11.2025, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si me poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar (Bashkia Berat)	Pa pranuar
1	Organizative	22 masa	22 masa	-
2	Shpërblim dëmi	4 masa	4 masa	-
3	Për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia	5 masa	5 masa	-
4	Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike	2 masë	2 masë	
5	Masa Disiplinore	14 masa	14 masa	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e subjektit

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	22 masa	7 masa	2 masë	11 masë	2 masa
2	Shpërblim dëmi	4 masa	-	-	-	4 masa
3	Për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia	5 masa	-	2 masa	1 masë	2 masa
4	Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike	2 masë	-	-	1 masë	1 masë
5	Masa Disiplinore	14 masa	8 masa	-	-	6 masë

Konkluzion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:
Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi se:
Nga 34 (tridhjetë e katër) rekomandime të dhëna për t'u zbatuar nga Bashkia Berat, niveli i zbatimit paraqitet si më poshtë vijon:
- 22 (njëzet e dy) rekomandime organizative janë pranuar plotësisht, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 7 (shtatë) prej tyre, janë zbatuar pjesërisht 2 (dy), janë në porces zbatimi 11(njëmbëdhjetë), si dhe 2 (dy) nuk janë zbatuar;
- 4 (katër) masa për shpërblimin e dëmit ekonomik janë pranuar plotësisht dhe janë pa zbatuar;
- 5 (pesë) masa për uljen e borxhit tatimor janë pranuar plotësisht. Theksojmë se nga 5 masa, vetëm 4 (katër) prej tyre janë me vlerë financiare, nga të cilat 2 (dy) prej tyre për vlerën 7,227,791 lekë janë zbatuar pjesërisht, nuk është zbatuar 1(një) masë për vlerën 43,544,191 lekë, si dhe është në proces zbatimi 1(një) masë për vlerën 169,055,157 lekë;
- 2 masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të tyre, të ardhurat e munguara, 1(një) është në proces zbatimi dhe 1(një) nuk është zbatuar;

- 1(një) masë disiplinore ndaj 14 punonjësve, është zbatuar për 8 (tetë) punonjës dhe për 6 (gjashtë) prej tyre nuk është zbatuar.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar si më poshtë në lidhje me:

"Mjedisin e kontrollit"

- Bashkia Berat nuk ka një Kod Etike.
- Nuk është hartuar plan i veprimit për menaxhimin financiar për vitin 2024, për monitorimin dhe arritjen e objektivave,
- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm e për pasojë nuk ka asnjë plan menaxhimi për veprime korrigjuese.
- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit.
- Për periudhën 2024 nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS, i cili nuk ka kryer detyrat për vendosjen e rregullave të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar.

"Menaxhimin e Riskut"

Bashkia Berat nuk ka hartuar një strategji të plotë risku, duke e unifikuar atë me regjistrin e riskut, pasi objektivat dhe planet e veprimit janë të mangëta. Nuk është përcaktuar koordinatori i riskut dhe nuk është ngritur grupi i punës së riskut. Mungojnë planet e veprimit për menaxhimin e riskut dhe nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit dhe tolerancës së riskut, duke mos përcaktuar kështu nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

"Monitorimi"

- Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e sistemit të MFK si dhe plani i veprimit për ecurinë e sistemit të MFK. Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" neni 8, pika 8, germa "b", neni 27, pikat 1-2, neni 16, pika 2-3, neni 21, pika 2; Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1, pika 3.2, pika 3.3; Rregullorja e Brendshme neni 16 "GMS". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.1, në faqet 17-23 të Raportit të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat, nëpërmjet Grupit të Menaxhimit Strategjik, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit; Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit; Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Në lidhje me gjetjet e evidentuara nga auditimi për komponentët e "Mjedisit të Kontrollit", "Menaxhimit të Riskut" dhe "Monitorimit", si dhe rekomandimin përkatës, sqarojmë se Bashkia Berat ka ndërmarrë dhe është në proces të

ndërmarrjes së masave për përmirësimin dhe konsolidimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si vijon: Në lidhje me "Mjedisin e Kontrollit": Kodi i Etikës është i integruar në Rregulloren e Brendshme të institucionit nr. 326 prot., datë 18.01.2023, konkretisht është përcaktuar kodi i etikës, konkretisht në kreun e II Funksionimi i Administratës, në pikën 2 përcaktohen disiplina formale dhe administrative dhe në nenin 8 percaktohet etika e punonjësve të Bashkisë Berat, në përputhje me VKM nr. 874, datë 29.09.2021; Për vitin 2026 është hartuar plani i masave për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i cili parashikon aktivitete konkrete për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe monitorimin e objektivave dhe adresimin e mangësive të evidentuara; Programi i trajnimeve për zhvillimin e kapaciteteve të stafit është parashikuar në planin MFK 2026 dhe është në proces zbatimi nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore; Dokumentimi i mbledhjeve të GMS është parashikuar në Planin MFK 2026 dhe do të realizohet gjatë vitit; Në lidhje me "Menaxhimin e Riskut" Bashkia Berat ka hartuar dhe përditësuar regjistrin e riskut në mënyrë periodike (çdo 6 muaj), konkretisht me nr. 3713 prot., datë 08.07.2025 dhe nr. 7662 prot., datë 31.12.2025; Procesi i identifikimit dhe vlerësimit të riskut realizohet nga njësitë organizative dhe konsolidohet në nivel institucional; Për vitin 2026 është hartuar plani i masave për MFK, i cili adreson risqet e identifikuara dhe rekomandimet e auditimit; Është në proces hartimi dhe miratimi politika e menaxhimit të riskut dhe politika për parandalimin e mashtrimit; Është në proces formalizimi i strukturave përgjegjëse për menaxhimin e riskut (koordinatori dhe grupi i punës); Është parashikuar ngritja e sistemit të monitorimit të riskut dhe raportimit periodik në kuadër të planit MFK 2026; Në lidhje me "Monitorimin" plani i masave për MFK 2026 përfshin aktivitete për monitorimin e sistemit dhe zbatimin e rekomandimeve të auditimit; Raportimi periodik mbi realizimin e objektivave dhe masave është parashikuar dhe do të zbatohet gjatë vitit 2026; Hartimi i rregullave të brendshme për monitorimin e sistemit të MFK është parashikuar në kuadër të masave për përmirësimin e sistemit; Në përfundim, theksojmë se Bashkia Berat ka ndërmarrë hapa konkretë për adresimin e mangësive të evidentuara dhe është në proces të konsolidimit të një sistemi funksional të menaxhimit të riskut dhe monitorimit, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi; Me Urdher të Kryetarit të Bashkisë nr.255, date 02.04.2025 është ngritur grupi i menaxhimit strategjik (GMS) për përgatitjen e PBA 2026-2028. Në lidhje me sistemin e komunikimit të punonjësve të Bashkisë Berat, theksojmë se përdoret komunikimi elektronik (e-mail zyrtar) për ecurinë sa më të shpejtë të proceseve të punës. Asistimi i stafit në lidhje me përdorimin sa më efikas të këtij sistemi realizohet me ndihmën e Specialistëve të IT, kur kërkohet, apo është e nevojshme, rast pas rasti.

Zbatimi: Rekomandimi 1.1 **është në proces zbatimi**

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Berat, konstatohet se:

a. Programet e angazhimit nuk janë hartuar sipas Formatit 8 të paraqitur në MAB;

b. Mungon opinioni i përgjithshëm për funksionimin dhe vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në fund të përmbledhjes ekzekutive dhe në mbyllje të çdo fushe të audituar, si dhe në memorandumin e çdo raporti angazhimi;

c. Rekomandimet janë të karakterit të përgjithshëm dhe jo të mirë përcaktuara se kujt i drejtohen, po i referohen bazës ligjore, duke mos orientuar ndërmarrjen e veprimeve, të cilat do të sjellin përmirësimet në sistem;

d. Memo drejtuar Titullarit rezultojnë tejet të gjata dhe nuk janë një përmbledhje e shkurtër e Raportit Përfundimtar, duke mos paraqitur konkluzionet nëpërmjet gjetjeve dhe rekomandimeve të adresuara dhe se, cilat sisteme janë vlerësuar me risk;

e. Procedura e vlerësimit të brendshëm të cilësisë nuk kryhej e plotë, pasi anekset "Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë" dhe "vetëvlerësimin periodik" nuk janë plotësuar, si dhe i mungon komponenti i tretë "Reagimet e subjektit të audituar" edhe pse pyetësori i reagimit ndaj angazhimit i dërgohej zyrtarisht subjekteve të audituara. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" nenet 11, 12/d,19,20, të MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të MF, i ndryshuar me Urdhrin e Ministrit të MF nr. 4 datë 10.01.2020, Kap. II 2.4.1 dhe 2.4.2; Kap. III, pika 3.5; Kap. IV pika 4.1.11 dhe 4.1.12; Kap. VI pika 6.1 "Niveli i dokumentimit"; Kap. VII pika 7.1.1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.2, në faqet 23-28 të Raportit të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Nga ana e Njësisë së Auditit të Brendshëm të merren masa që të realizohen të gjitha fazat e auditimit, në përputhje me MAB, të kryhet vlerësimi i brendshëm i cilësisë nëpërmjet procesit të monitorimit dhe të vetëvlerësimit periodik. Në raportet e auditimit të kryhen teste substanciale dhe analitike, në mënyrë që auditimet të jenë të thelluara, duke evidentuar mangësitë e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe dhënien e opinionit për to, si dhe formulimin konkret e të plotë të rekomandimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Nga verifikimi i disa dosjeve të auditimit të kryer nga NJAB Berat, ka rezultuar se janë evidentuar përsëri mangësi përgjatë procesit audites. Ky rekomandim do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Zbatimi: Rekomandimi 2.1 **është zbatuar pjesërisht**

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Berat dhe Njësive Shpenzuese së bashku me transfertat e pakushtëzuara dhe specifike, për vitin 2024, kanë diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2024, planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pakushtëzuar dhe specifiken ka vlerën 1,400,890 mijë lekë buxheti i rishikuar ka vlerën 1,630,473 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 1,309,523 mijë lekë ose në masën 80%.

Mosrealizimi i të ardhurave, do të thotë se nga Bashkia Berat në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" neni 39, i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*" neni 9, pika 1.3, germa "c" dhe "ç", Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*" i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, VKB përkatëse. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2.1 , faqe 28-37, të Raportit të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Bashkisë Berat, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit si dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave ashtu si dhe çdo drejtori e Bashkisë Berat që gjeneron të ardhura ka analizuar çdo taksë dhe tarifë dhe faktorët e realizimit të tyre. Kjo analizë është pasqyruar në

planifikimin e të ardhurave për vitin 2026. Çdo drejtor i drejtorive që gjeneron të ardhura bazuar në VKB nr.93 datë 28.12.2021 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Beratit" i ndryshuar, ku janë përcaktuar dhe Drejtoritë përgjegjëse për të ardhurat, është pjesë e GMS ku dhe çdo taksë dhe tarifë është analizuar dhe planifikuar bazuar në një database të plotë dhe të saktë.

Zbatimi: Rekomandimi 3.1 **është zbatuar**

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2024-2026, u konstatua se nuk janë realizuar fazat e përgatitjes si më poshtë:

1. Nuk është hartuar raporti i vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave, i cili miratohet nga Këshilli i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore jo më vonë se data 01.03.2023;
2. Tavanet përfundimtare të PBA-së 2023-2025, janë miratuar jashtë afateve;
3. Nga drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programeve (EMP) nuk janë paraqitur kërkesat buxhetore dhe kërkesat buxhetore shtesë sipas programit të Koordinatorit të GMS, brenda muajit prill 2024;
4. Nga Bashkia Berat nuk janë dokumentuar takimet konsultative me përfaqësues të komunitetit lokal gjatë fazës së përgatitjes së projekt dokumentit të PBA-së.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017 "*Për financat e Vetëqeverisjes Vendore*" neni 33 si dhe përcaktimet e Udhëzimit nr. 5, datë 28.02.2023 "*Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026*". *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2.1 , faqe 28-37, të Raportit të Auditimit).*

4.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të dokumentoj kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Berat dhe të organizojë takime më përfaqësues të komunitetit për hartimin e PBA-së.

Në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Në lidhje me rekomandimin e dhënë nga grupi i auditimit për përmirësimin e procesit të planifikimit buxhetor afatmesëm dhe vjetor, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka marrë masa për forcimin e procedurave të brendshme të planifikimit dhe dokumentimit. Është kërkuar që të gjithë drejtuesve të programeve buxhetore për paraqitjen në kohë të kërkesave buxhetore dhe kërkesave shtesë, në përputhje me udhëzimet e Koordinatorit të GMS; Janë përmirësuar procedurat e dokumentimit të procesit të mbledhjes dhe përpunimit të kërkesave buxhetore, duke siguruar gjurmueshmëri dhe transparencë më të lartë; Është planifikuar organizimi i takimeve konsultative me përfaqësues të komunitetit lokal në fazën e përgatitjes së PBA-së, në përputhje me kërkesat ligjore dhe udhëzimet përkatëse.

Zbatimi: Rekomandimi 4.1 **është zbatuar**

5. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2024 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 648,376,730 lekë dhe realizimi në vlerën 466,126,381 lekë ose në masën 72% me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 182,250,349 lekë. Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulëta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura të debitorëve. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"*, neni 64, Ligjin nr. 68/2017,

datë 27.04.2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika "c", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, *"Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave"* Kreu IV, pika 200, dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, Kreu II, pika 2, germa "a" dhe "b", Kreu III, pika 32. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 37-49 të Raportit të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por, edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave ka analizuar çdo zë taksë dhe tarifë duke u bazuar në një analizë të hollësishme si edhe duke marrë në konsiderat realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura. Kjo analizë është pasqyruar në planifikimin e të ardhurave për vitin 2026.

Zbatimi: Rekomandimi 5.1 **është zbatuar**

6. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të ardhurat nga Agjentët Tatimorë *(Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat; ASHK Berat për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme; Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat në lidhje me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin dhe tatimin mbi të ardhurat personale, DSHTRR Berat në lidhje me taksat vendore të qarkullimit për mjetet e përdorura dhe Dega e Doganës Berat për rentën minerare)* derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Berat dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Berat duke kuadruar edhe me akt-rakordimin vjetor të datës 16.01.2025. Bashkia Berat ka të dhëna vetëm për vlerën e arkëtuar nga këta agjentë, sipas vlerës së depozituar në thesar, por nuk ka bazë të dhënash për detyrimin e plotë që duhet të arkëtojnë agjentët tatimor dhe vlerën e pa arkëtuar prej tyre. Gjithashtu nuk janë mbajtur akt-rakordime për vitin 2024 me agjentët tatimorë Dega e Doganës Berat, ASHK Drejtoria Vendore Berat ndërsa për DRSHTRR, Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Berat disponohet vetëm akt-rakordimi përmbledhës vjetor. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, neni 15, Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" neni 117, pika c, i ndryshuar* si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008, *"Për taksat kombëtare"*. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 37-49 të Raportit të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave është në vazhdim të marrjes së të gjithë hapave ligjorë në bashkëpunim me të gjithë strukturat për pregatitjen e materialeve të nevojshme për ndryshimet e rekomanduara.

Zbatimi: Rekomandimi 6.1 **është në proces zbatimi**

6.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat, të marrë masa për ngritjen e një komisioni, me qëllim verifikimin e taksave dhe tarifave të vjela nga agjentët tatimorë, ku në rast se do të evidentohen diferenca të pa mbledhura për taksat dhe tarifat vendore të cilat gjenerohen nëpërmjet agjentëve tatimorë (të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj), të fillojë procedurat për gjobitjen e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nuk rezulton të jetë ngritur komisioni përkatës.

Zbatimi: Rekomandimi 6.2 **nuk është zbatuar**

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i proceseve të sistemit TAIS të implementuar në Bashkisë Berat konstatohet se:

a. Aplikacioni TAIS i taksave vendore Berat dhe kodi në burimin e tij nuk janë të regjistruara si aset i Bashkisë Berat. Politikat e sigurisë së informacionit mbulojnë të gjitha risqet operacionale dhe ka mundësi të mbrojë në mënyrë të arsyeshme të gjitha asetet e informacioneve kritike kundrejt, humbjeve, dëmtimit dhe abuzimit. *(Ref. ISO 27000 Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit dhe politika të tjera të brendshme, procedura ose rregulla të aplikueshme)*. Mbajtja e pronësisë së proceseve të biznesit;

b. Ambienti fizik i dhomës së rrjetit nuk është në përputhje me praktikat më të mira si dhe standardet e përcaktuara në rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverave (Versioni 48 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI përkatësisht:

Pika 4.3. Parandalimi i zjarrit. Dhoma duhet të jetë e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit. Dhoma duhet të jetë rezistente ndaj zjarrit nëse kabllot dhe sistemet e ftohjes kombinohen në të njëjtën hapësirë sipër tavanit ose nën dysheme.

Pika 4.5. Sistemi Elektrik. Instalimi elektrik i dhomës së serverëve nuk është veçmas instalimit të përgjithshëm.

Pika 4.6. Sistemi i Alarmit. Mungon sistemi i alarmit. Duhet të jenë të tillë që të sinjalizojnë problemet me rrymën elektrike, me ambientin fizik, sensor për rrjedhjen e ujit, sensor për parandalimin e dëmtimeve fizike të strukturës së dhomës;

c. Prodhuesi i sistemit TAIS ka shoqëruar sistemin me rregullore dhe manuale për përdoruesit dhe administratorët të cilat nuk janë të miratuara nga ana e Bashkisë Berat. Në mbështetje të kërkesave kryen ndryshime të sistemit dhe zhvillime në përputhje edhe me ndryshimet e legjislacionit në fuqi pa pasqyruar ndryshimet në manuale. Duke mos përmbushur përcaktimet e Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*" neni 64, gërma "j", ku përcaktohet që: "Miraton strukturën, organikën e kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi";

ç. Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Taksave Vendore të Bashkisë Berat nuk ka rregulla të shkruara për hapjen dhe mbylljen e përdoruesve në sistemin TAIS;

d. Nuk ka raporte të problemeve/incidenteve dhe aksesit të paautorizuar;

dh. Nuk ka rregulla të shkruara dhe formale të sigurisë së informacionit;

e. Nuk ka Procedura formale për menaxhimin e risqeve dhe regjistër të risqeve;

f. Bashkia Berat, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave nuk ka plan emergjence të miratuar dhe politika të vazhdimësisë së punës dhe rimëkëmbjes për proceset kritike për sistemin TAIS. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 37-49 të Raportit të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Bashkia Berat, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të marrë masa për:
- Vlerësimin dhe regjistrimin si aset të sistemit TAIS dhe kodin në burim të tij.
- Ndërtimin e ambienteve të dhomave të serverave në përputhje me praktikat më të mira si dhe standardet e përcaktuara në bazë të VKM nr. 248, datë 27.04.2007, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit" dhe rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Miratimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të rregulloreve dhe manualeve të aplikacionit TAIS.
- Hartimin, miratimin dhe zbatimin e rregullave për hapjen dhe mbylljen e përdoruesve në sistemet e teknologjisë së informacionit procesi i hapjes mbylljes si dhe rastet e incidenteve dhe aksesit të paautorizuar duhet të dokumentohet.
- Të vlerësohen burimet, duke marrë masa për krijimin e Active Directory dhe Domain Controller për një identifikim të qendërzuar të sigurt për kontrollin dhe menaxhimin e shërbimeve.
- Hartimin e regjistrit të risqeve që kërcënojnë infrastrukturën IT si dhe të ngrejë mekanizma për reduktimin në mënyrë efektive dhe eficiente të risqeve të rëndësishëm.
- Hartimin e procedurave të menaxhimit të problemeve dhe incidenteve, si dhe procedurave për inicimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, klasifikimin e tyre sipas rëndësisë, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive për kryerjen e ndryshimeve.
- Konfigurimin fireẉall, sẉitch dhe mikrotik të sistemit TAIS (dhe ruajtjen e konfigurimeve) në përputhje me rekomandimet e prodhuesve dhe standardet e praktikat më të mira të fushës.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerezore dhe Shërbimeve Mbështetëse është në vazhdim të marrjes së masave të nevojshme teknike dhe administrative në përputhje me kërkesat e legjislacionit dhe VKM-së në fuqi. Në përgjigje të këtij rekomandimi nga burimet njerezore theksojmë se janë sistemuar serverat në një "dhomë serverash" sipas rregullores për ndërtimin e dhomës së serverave (versioni 1.0. datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, në të cilën është instaluar një sistem dedektorësh për zjarrin dhe gjithashtu është instaluar ventilimi i pajisjeve me ajër të kondicionuar. Përsa i përket miratimit dhe përditësimit të vazhdueshëm të rregulloreve dhe manualeve të aplikacionit TAIS, si dhe lidhur me hapjen dhe mbylljen e përdoruesve në sistemet e teknologjisë së informacionit dhe dokumentimit të incidenteve të aksesit të paautorizuar, thesojmë se rregullorja për funksionimin e sistemit TAIS ekziston dhe është funsionale dhe e zbatueshme në vijimësi nga të gjitha palët. Ndërsa lidhur me mosdokumentimin e rasteve të incidenteve të aksesit të paautorizuar, thesojmë se nuk ka patur raste, rrjedhimisht dhe nuk ka asnjë dokumentim të tillë, të pretenduar. Hapja dhe dhe mbyllja e sistemit kryhet individualisht nga punonjësit përdorues, që kanë akses dhe sipas procedurave përkatëse për gjithësecilin që zotëron një user personal. Përsa i përket marrjes së masave për krijimin e Active Directory dhe Domain Controller për një identifikim të qendërzuar të sigurt për kontrollin dhe menaxhimin e shërbimeve, është dakordësuar me kompaninë që realizon mirëmbajtjen e sistemit TAIS, që nëpërmjet bashkëpunimit të ndërmjetëm të parashikohet dhe të amendohet në kontratën e re që do të lidhet ndërmjet palëve. Në lidhje me hartimin e regjistrit të risqeve, për kërcënimet infrastrukturore IT, si dhe të ngritjes së mekanizmave për reduktimin në mënyrë efektive dhe eficiente të risqeve të rëndësishëm, është duke u punuar nga Specialistët e IT për realizimin e tij, si dhe për hartimin e procedurave të menaxhimit të problemeve dhe incidenteve, procedurave për inicimin, rishikimin, aprovimin e ndryshimeve, klasifikimin e tyre sipas rëndësisë, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive për kryerjen e ndryshimeve. Përsa i përket konfigurimit fireëall, sëitch dhe mikrotik të sistemit

TAIS në përputhje me rekomandimet e prodhuesve dhe standartet e praktikat më të mira të fushës, theksojmë se ky proces realizohet aktualisht, si nga ana e Bashkisë Berat, po ashtu edhe nga ana e kompanisë që realizon mirëmbajtjen e sistemit TAIS.

Zbatimi: Rekomandimi 7.1 **është në proces zbatimi**

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të subjekteve të cilët kanë aplikuar për çregjistrim apo pezullim NIPT-i në QKB konstatohet se, në 224 raste këto subjekte kanë ende statusin aktiv në QKB sipas verifikimeve të kryera nga grupi i auditimit. Kjo situatë ka ndodhur për mos plotësim dokumentacioni apo detyrimet tatimore të pa likuiduara ndër vite. Nga data e aplikimit për mbyllje nga DTT Bashkia Berat nuk janë përllogaritur më detyrimet tatimore për këto subjekte. Në lidhje me verifikimin e gjendjes funksionale pra, ushtrimit të aktivitetit nga subjektet që kanë aplikuar për çregjistrim apo pezullim nga DTT janë hartuar procesverbalet e verifikimit në terren vetëm për 27 subjekte, ndërsa për pjesën tjetër nga inspektorët e kësaj drejtorie nuk janë marrë masa për verifikimin në terren mbi statusin e subjekteve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKB nr. 93, datë 28.12.2021 "*Për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Berat*".*(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 37-49 të Raportit të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të marrë masa të menjëhershme për kryerjen e inspektimeve në terren në lidhje me statusin e subjekteve që kanë aplikuar për çregjistrim në QKB, për rastet që konstatohet se këto subjekte ushtrojnë aktivitet t'u përllogariten taksat dhe tarifat vendore përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave nga inspektimet në terren ka konstatuar me Akt-Verifikimi nr i serisë 0000202-0000203, datë 08.05.2025, datë 10.05.2025 se subjektet kishin pezulluar aktivitetin ndërkohe e ushtronin atë. Subjekteve i'u la detyrë te aktivizojnë NIPT dhe të përmbushin detyrimet brenda 5 ditëve. Akt-Verifikimi nr i serisë 0000205 -0000206, datë 26.08.2025, datë 22.10.2025 subjektet ushtronin aktivitet pa u pajisur me NIPT. Subjekteve i'u la 7 ditë afat për pajisjen me dokumentacionin përkatës dhe paraqitjen e tyre pranë zyrës së Tatim Taksave në Bashki. Akt-Verifikimi nr i serisë 0000208 -0000209 -0000210-0000211 -0000212- 0000213-0000214-0000215- 0000216-0000217-0000218-0000219-0000220 datë 14.04.2026, datë 16.04.2026, datë 20.04.2026, datë 23.04.2026, datë 24.04.2026, subjektet kishin aplikuar për pezullim, subjektet ishin të mbyllur dhe nuk ushtronin aktivitet.

Zbatimi: Rekomandimi 8.1 **është zbatuar pjesërisht**

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të karburantit si dhe nga verifikimi në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit konstatohet se përgjatë vitit 2024 në territorin e Bashkisë Berat dhe njësive administrative është ushtruar aktivitet për tregtimin e karburantit nga 15 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre.

Nga auditimi i dosjeve përkatëse të subjekteve të mësipërme, rezultoi se në fund të vitit 2024, gjithsej rezultojnë 11 subjekte të pajisura me autorizim me afat 1-5 vjeçar, këto subjekte e kanë paguar të plotë vlerën e autorizimit sipas rastit. Ndërkohë që për 4 subjekte me aktivitet tregtimin e karburanteve që operojnë në territorin e Bashkisë Berat të pa pajisur me autorizimin përkatës përkatës janë dërguar shkresat përkatëse për pajisje me licence, konkretisht:

- Subjektit "A" ShPK dhe për dijeni dhe ISHTI-it për bashkëpunim për marrjen e masave për pezullimin e aktivitetit, subjektit "G" ShPK dhe për dijeni dhe ISHTI-it, subjektit "G" dhe për dijeni dhe ISHTI-it, dhe për subjektin "G" i cili ushtron aktivitet pa u pajisur me licencën përkatëse.

- Për subjektin "R" nga Bashkia Berat janë ngritur pretendimet e ky subjekt është në proces licencimi por nuk disponohet asnjë dokumentacion vërtetues në lidhje me këtë situatë. Për më tepër nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa licencë, kërkesë për bashkëpunim nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Transportit, Pronave dhe Shërbimeve. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 170, datë 25.04.2002*, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre"* i ndryshuar, Kapitulli II dhe III, pika 4, dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, *"Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj"* i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, germa "b", dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, Kapitulli II, pika 1, germa "b" dhe pika 9 dhe 15. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 37-49 të Raportit të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Bashkia Berat, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Transportit, Pronave dhe Shërbimeve në bashkëpunim me Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrë masa të menjëhershme për pezullimin e subjekteve, që ushtrojnë aktivitet për tregtimin karburanti pa u pajisur me autorizim/licencë.

Menjëherë

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Drejtoria e Mbrojtjes Civlie, Pronave, Transportit dhe Mjedisit bazuar në VKM-ne nr. 970, datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", VKB nr.93 datë 28.12.2021 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Beratit" i ndryshuar, në lidhje me konstatimet e evidentuara dhe qëndrimin e mbajtur, sqarojmë se ka vepruar në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi, në mënyrë të veçantë me përcaktimet e VKM nr. 970, datë 02.12.2015, e cila rregullon procedurat dhe kushtet për pajisjen me licencë për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj. Referuar kësaj VKM-je, ushtrimi i aktivitetit për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, naftës për automjete dhe vajrave lubrifikantë pa u pajisur më parë me licencën përkatëse përbën shkelje të drejtpërdrejtë të legjislacionit në fuqi dhe sjell detyrimin për marrjen e masave administrative për pezullimin e aktivitetit.

Nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Mjedisit ka ndjekur në vazhdimësi ecurinë e subjekteve dhe arkëtimin e vlerave nga të cilat janë arkëtuar 2,600,000 lekë nga 3 (tre) subjekte, janë në gjendje pasive 2 (dy) subjekte për të cilat është e pamundur arkëtimi i detyrimit të lënë dhe është në proces ndjekje në mënyrë shkresore 1 (një) subjekt për të cilin rezulton detyrimi 1,000,000 lekë i paarkëtuar. Situata e subjekteve paraqitet si më poshtë: 1-Për subjektin A, Bashkia Berat ka kryer në vazhdimësi njoftimet përkatëse administrative ndaj subjektit, duke i kërkuar pajisjen me dokumentacionin ligjor dhe ndërprerjen e aktivitetit në mungesë të licencës, ndaj të cilave nuk ka pasur asnjë reagim. Bashkia Berat me shkresën me nr. 6622 prot datë 14.11.2025, i ka kërkuar Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial kërkesën për bashkëpunim duke e vendosur në dijeni për situatën e subjektin dhe masat e marra nga Bashkia Berat.

Zbatimi: Rekomandimi 9.1 **është në proces zbatimi**

10. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat rezultoi se për periudhën objekt auditimi (01.01.2024 – 31.12.2024), në Bashkinë Berat dhe njësitë e saj shpenzuese (*Agjencia e Shërbimeve Publike dhe Qendra Arsimore Berat*) janë realizuar gjithsej **24** procedura me vlerë të lartë me fond limit 640,408 mijë lekë dhe vlerë kontrate të lidhur pa TVSh 564,610 mijë lekë, me një diferencë prej 75,798 mijë lekë ose 11%.

U audituan **12** procedura prokurimi nga **24** të realizuara me vlerë të fondit limit 580,503 mijë lekë ose 90 % e fondit të prokuruar.
Nga auditimi u konstatua se në procedurën e prokurimit "Blerje Karburanti", me vlerë totale të fondit limit 24,394 mijë lekë pa TVSh, u konstatuan parregullsi në hartimin e fondit limit, mosrespektimin e metodave të përcaktuara për hartimin e fondit limit, etj.
Nga auditimi në 7 procedura me fond limit prej 464,507 mijë lekë janë konstatuar shkelje të dispozitave të LPP, konkretisht parregullsi në hartimin e kritereve jo në përputhje me tipologjinë e objektit që prokurohet, si më poshtë:
- "Ndërtim i shkollës 9 vjeçare 22 tetori dhe parkim nëntokësor" me fond limit 376,475 mijë lekë e zhvilluar gjatë vitit 2024.
-"Ndërhyrje rehabilituese në muret mbajtës dhe terrenet në territorin e Bashkisë në kuadër të mbrojtjes civile" me fond limit 11,320 mijë lekë e zhvilluar gjatë vitit 2024.
-"Rehabilitim i nyjes së trafikut Spitali Rajonal Bashkia Berat" me fond limit 24,067 mijë lekë e zhvilluar gjatë vitit 2024.
- "Ndërtim i shpatullave të urës së Lapardhasë 2" me fond limit 9,999 mijë lekë e zhvilluar gjatë vitit 2024.
-"Blerje karburant për nevojat e Bashkisë Berat" me fond limit 24,394 mijë lekë e zhvilluar gjatë vitit 2024.
-"Blerje materiale dekori" me fond limit 14,450 mijë lekë e zhvilluar gjatë vitit 2024.
-"Mbikëqyrje punimesh për objektin "Ndërtim i shkollës 9-vjeçare 22 Tetori dhe parkim nëntokësor". me fond limit 3,748 mijë lekë e zhvilluar gjatë vitit 2024.
- Në **9** procedura nga **12** të audituara, u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Berat, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kritereve të vendosura në DT, si vijon:
- "Ndërtim i shkollës 9 vjeçare 22 tetori dhe parkim nëntokësor" me fond limit 376,475 mijë lekë e zhvilluar gjatë vitit 2024.
-"Ndërhyrje rehabilituese në muret mbajtës dhe terrenet në territorin e Bashkisë në kuadër të mbrojtjes civile" me fond limit 11,320 mijë lekë e zhvilluar gjatë vitit 2024.
-"Rehabilitim i nyjes së trafikut Spitali Rajonal Bashkia Berat" me fond limit 24,067 mijë lekë e zhvilluar gjatë vitit 2024.
- "Ndërtim i shpatullave të urës së Lapardhasë 2" me fond limit 9,999 mijë lekë e zhvilluar gjatë vitit 2024.
-"Blerje karburant për nevojat e Bashkisë Berat" me fond limit 24,394 mijë lekë e zhvilluar gjatë vitit 2024.
-"Blerje materiale dekori" me fond limit 14,450 mijë lekë e zhvilluar gjatë vitit 2024.
-"Blerje materiale asfalti me fond limit 39,999,848 lekë" e zhvilluar gjatë vitit 2024.
-"Vendosje tende në tregun e gjelbërt Berat-Green Market" me fond limit 6,339 mijë lekë e zhvilluar gjatë vitit 2024.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*"; neni 2, neni 3, pika 2, neni 35, neni 39, pika 2, neni 77 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar neni 2, pika 2, shkronja "c", neni 15, pika 3, shkronja "b", neni 39, pika 4, neni 40, pika 1, neni 43, pika 2, shkronja "c", neni 44, pika 1, neni 55, pika 4, neni 78, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4. faqe 50-123 të Raportit të Auditimit).*
10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Prokurimit Publik (NJP përkatëse) në Bashkinë Berat, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kritereve

për kualifikim, duhet t'i argumentojë teknikisht dhe ligjërisht ato duke pasur gjithmonë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, grafikun e punimeve, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre, harmonizimin me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike, me qëllim për të garantuar trajtim të barabartë të OE, duke nxitur gjithashtu konkurrencën midis tyre.

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Janë marrë masat që në cdo procedurë prokurimi të zhvilluar nga autoriteti kontraktor kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të objetin të prokurimit të janë të argumentuara sipas kërkesave ligjore. Në të gjitha procedurat e prokurimit të zhviluara kriteret janë argumentuar sipas proces verbalit të argumentimit të kritereve dhe janë paqyruar në sistemin elektronik të prokurimit sipas llojit të procedurës referuar ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe VKM nr.285 datë 29.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar.

Zbatimi: Rekomandimi 10.1 **është zbatuar**

10.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e B/OE të cilët nuk plotësojnë kriteret kualifikuese të DST-ve.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, nuk rezulton të jetë ngritur një grup pune dhe të ketë kryer analizën për veprimtarinë e KVO-ve përgjatë vlerësimit të ofertave ekonomike.

Zbatimi: Rekomandimi 10.2 **nuk është zbatuar**

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen teknike të zbatimit, për objektet, përkatësisht:

- "Rikonstruksioni i shkollës së mesme Babë Dudë Karbunara", me nr. 5013 prot., datë 06.10.2022 dhe vlerë kontrate me TVSh në shumën 433,517 mijë lekë.
-"Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet të varfra dhe të pafavorizuara", me nr. 6244 prot., datë 05.12.2023 dhe vlerë kontrate me TVSh në shumën 61,560 mijë lekë.
- "Ndërtimi i tregut të gjelbër Berat (Green Market)", me nr. 6196 prot., datë 04.12.2023 dhe vlerë kontrate me TVSh në shumën 19,961 mijë lekë.
- "Ndërtimi i rrugës pranë Vala Park Berat", me nr. 7176/1 prot., datë 08.01.2024 dhe vlerë kontrate me TVSh në shumën 13,644 mijë lekë.

Rezultoi se, nga kontrolli i bërë në dokumentet e administruara në dosje disa prej inxhinierëve të Bashkisë Berat pjesë e grupit të punës për hartimin e projekt të zbatimit, ***nuk janë pajisur me licencën e projektimit***. Ky veprim, është në kundërshtim me neni **5** të Ligjit Nr. **8402, datë 10.09.1998** "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", sipas të cilit "Objektet e përkufizuara në **nenin 3** të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të ***pajisur me licencën përkatëse***. Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në **kreun II** të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4. faqe 123-135 të Raportit të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat në bashkëpunim me DPZHT të marrë masa që në të ardhmen për çdo projekt zbatimi, të hartohen nga Inxhinierë të pajisur me licencën përkatëse për projektim, ose në mungesë të inxhinierëve të licencuar pjesë e stafit të DPZHT, projektet e zbatimit t'i nënshtrohen procedurave të prokurimit publik, duke siguruar hartimin e projekteve të

zbatimit nga studio projektimi të licencuara, për të garantuar projekte me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Rekomandimi është pranuar dhe është siguruar që çdo projekt zbatimi në vazhdim të hartohet nga inxhinierë të pajisur me licencën përkatëse të projektimit dhe studio projektuese të licensuara.

Zbatimi: Rekomandimi 11.1 **është në proces zbatimi**

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të kontratës për punë publike me nr. 91 prot., datë 08.01.2024 me objekt: "Ndërtimi i rrugës pranë Vala Park Berat" Bashkia Berat, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Berat, përfaqësuar nga Kryetari Z. E. D dhe shoqërisë "R" SHPK me Lic. Nr. NZ.79, përfaqësuar nga Administratori Z. A. R me vlerë të kontratës 13,644,852 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës brenda 4 javëve nga data e nënshkrimit, u konstatua se nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Berat, nuk është kryer oponenca teknike për projektet e zbatimit.

Për sa më sipër, është në mospërputhje me Ligjin Nr. 120/2020 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", neni 6 si dhe, VKM nr. 610, datë 22.09.2022 "*Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të Përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe Mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të Punimeve*", neni 41, pika 1, germa (c). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4. faqe 123-135 të Raportit të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Berat në bashkëpunim me DPZHT, të marrë masa që të pajisë me Oponencë Teknike çdo projekt zbatimi, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Rekomandimi është pranuar dhe është siguruar që çdo projekt zbatimi është pajisur me oponencen teknike.

Zbatimi: Rekomandimi 12.1 **është në proces zbatimi**

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i listave të inventarit nuk janë kryer procedurat për përditësimin dhe miratimin e inventarit përfundimtar të pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Bashkinë Berat dhe të 4 Njësive Administrative që ka në territorin e saj kjo bashki. Për një pjesë nuk disponohet informacion në lidhje me gjendjen reale dhe statusin e tyre, sa nga këto prona janë të zëna, sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë.

Veprime në kundërshtim me Ligji nr. 8744, datë 22.02.2001 "*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore*" nenin 18, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001"*Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore*", pikën 18, 22, Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020 "*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*", Kreu IV.

Nga Bashkia Berat dhe Sektori i Menaxhimit të Pronave nuk janë ngritur grupe pune për administrimin e aseteve. Asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë Berat dhe Njësive Administrative që përmbledh kjo Bashki nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale. Nuk janë zbatuar pikat 9, 10, 11 dhe 22 të VKM nr. 500, datë 14.8.2001 "*Për inventarizimin e pronave të*

paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqe 135-144 të Raportit të Auditimit).*

13.1. Rekomandim: Titullari i Bashkisë Berat të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për verifikimin në terren dhe përditësimin e statusit të të gjithë aseteve që kjo bashki ka në administrim, së bashku me njësitë administrative. Grupi i punës duhet të përditësojë listën e inventarit dhe ta nisi për miratim në organet përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Në lidhje me rekomandimin për marrjen e masave për verifikimin në terren dhe përditësimin e statusit të aseteve në administrim të Bashkisë Berat, ju informojmë se Bashkia ka ndërmarrë hapat e nevojshëm në këtë drejtim. Me Urdhërin e Brendshëm me nr. 388 prot datë 27.04.2026 të Kryetarit të Bashkisë Berat "Për verifikimin dhe përditësimin e aseteve në bashkinë Berat", është ngritur grupi i punës për verifikimin në terren të situatës faktike të aseteve që ashkia Berat ka në administrim së bashku me njësitë administrative. Ky proces paraqet edhe një sërë vështirësish praktike, të lidhura kryesisht me procedurat e regjistrimit të pronave pranë Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të cilat shpesh rezultojnë të zgjatura në kohë dhe të shoqëruara me kërkesa të detajuara dokumentacioni. Gjithashtu, një ndikim të konsiderueshëm paraqet edhe kostoja e lartë financiare për regjistrimin dhe përditësimin e pasurive, veçanërisht për një numër të madh asetesh në administrim.

Zbatimi: Rekomandimi 13.1 **është në proces zbatimi**

14. Gjetje nga auditimi*:* Nga auditimi i dokumentacionit të Drejtorisë së Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave, Shërbimit Veterinar dhe regjistrit të subjekteve aktiv sipas AKBN u konstatua se në Bashkinë Berat ushtrojnë veprimtarinë ekonomike 4 (katër) subjekte të cilët shfrytëzojnë fondin pyjor/kullosor pa lidhur një kontratë qiraje, konkretisht subjektet:.

- "T" shpk ushtron veprimtarinë ekonomike nga viti 2014 duke shfrytëzuar sipërfaqen prej 11 Ha,
- "B" shpk ushtron veprimtarinë e tij ekonomike në NJ/A Roshnik me status aktiv, duke shfrytëzuar sipërfaqen prej 16.7 Ha.
- "T" shpk ushtron veprimtarinë ekonomike nga viti 2017 duke shfrytëzuar sipërfaqen prej 2.084 Ha.
- "K" shpk ushtron veprimtarinë ekonomike nga viti 2021 duke shfrytëzuar sipërfaqen prej 13.5 Ha.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 25, pika 3 të ligjit nr.57/2020 "*Për pyjet*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqe 135-144 të Raportit të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar të përfundojë procedurat ligjore me MTM, në lidhje me heqjen nga fondi pyjor dhe ndryshimin e zërit kadastral të sipërfaqeve përkatëse të guroreve të sipërcituara. Gjithashtu të kryhet një vlerësim për dëmin që ka pasur shfrytëzimi i sipërfaqeve nga aktiviteti i guroreve dhe t'jua faturojë atë subjekteve përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar i është drejtuar Ministrisë së Mjedisit për heqje nga fondi pyjor kullosor publik të sipërfaqes që kryejnë aktivitetin mineral për shfrytëzimin per tre subjekte perkatësisht T, T Sh.p.k, K shpk, ndërsa për subjektin B Sh.p.k struktura e pyjeve prane Bashkisë Berat i është drejtuar me kërkesë për kryerjen e aplikimit online sipas VKM nr 888, datë 27.12.2022.

Ne lidhje me demin e shkaktuar subjektet nuk kanë marrë miratim për heqje nga fondi pyjor nga Ministria e Mjedisit, dhe si e tillë nuk kanë një kontratë të lidhur me Bashkinë Berat dhe në këto kushte nuk mund të nisim dot njoftimin për dëmin e shkaktuar.

Zbatimi: Rekomandimi 14.1 **është në proces zbatimi**

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, u konstatua se në të gjitha rastet, pra në pesë raste, dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, nuk është i plotë më konkretisht në rastet e mëposhtme:
1. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 1377/4 prot., datë 03.06.2024, për objektin ***"Godinë banimi dhe shërbimesh 1 dhe 6 kate me 1 kat parkimi nën-tokë"***, me adresë në lagjen "Donika Kastrioti", Berat, me zhvillues "B" Shpk, me problematika si më poshtë vijon:
- Leja e ndërtimit është miratuar në mungesë të projektit hidraulik.
- Dokumentet e pronësisë nuk janë ngarkuar të noterizuara, nuk është marrë siguri e lartë se mbi pronën në zhvillim nuk janë kryer transaksione ose tjetërsime. Nga auditimi i kësaj procedure, është konstatuar se dy kartelat janë rifreskuar në datat 21.04.2016 dhe 13.10.2023, ndërsa aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është bërë në datë 06.03.2024.
- Mungon dokumenti i regjistrimit në QKB dhe / ose ekstrakti historik tregtar për subjektet që kanë hartuar projektet ndërtimore (konstruktiv, elektrik, ngrohje-ftohje, gjeologjik),

2. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 4851/4 prot., datë 16.10.2024, për objektin ***"Magazinë për grumbullimin, përpunimin e produkteve bujqësore"***, me adresë në lagjen Otllak, Berat, me zhvillues z. E. C, me problematika si më poshtë vijon:
- Leja e ndërtimit është miratuar në mungesë të projektit H-VAC.
- Dokumentet e pronësisë nuk janë ngarkuar të noterizuara, nuk është marrë siguri e lartë se mbi pronën në zhvillim nuk janë kryer transaksione ose tjetërsime. Nga auditimi i kësaj procedure, është konstatuar se kartelat janë rifreskuar në datat 20.05.2023 dhe 27.05.2023, ndërsa aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është bërë në datë 14.09.2024.
- Mungon dokumenti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe / ose ekstrakti historik tregtar për subjektin që ka hartuar projektin konstruktiv.

3. Certifikatë përdorimi miratuar me Vendim nr. 1596/3 prot., datë 16.04.2024, për objektin ***"Rikonstruksion objekti ekzistues dhe shtesë anësore (shtesë kati)"***, me adresë në lagjen "30 Vjetori", Berat, me zhvillues z. F. Xh, me problematika si më poshtë vijon:
- Mungojnë fotot në 4 drejtime të objektit.
- Mungon akti i miratimit nga PMNZSH.
- Mungon projekti as-built.
- Mungon deklarata e përputhshmërisë nga subjekti zhvillues.

4. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 5286/3 prot., datë 25.11.2024, për objektin ***"Ndërtim magazine bujqësie"***, me adresë në fshatin Duhanas, Berat, me zhvillues z. L. H, me problematika si më poshtë vijon:
- Mungojnë fotot ne 4 drejtime të objektit.
- Mungojnë aktet e miratimit nga OSHEE, PMNZSH dhe UK, si dhe ai për menaxhimin e mbetjeve urbane.
- Mungon projekti për mirëmbajtjen e objektit.

5. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 3957/4 prot., datë 18.09.2024, për objektin ***"Godinë banimi 2 kate"***, me adresë në fshatin Veterrik, Berat, me zhvillues z. L.T, me problematika si më poshtë vijon:
- Mungojnë aktet e miratimit nga OSHEE, UK,

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e , me nenin 54 të Ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 *"Për noterinë"*, i ndryshuar; VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* neni 15, , pika 1, nënpika e), nenin 27/2 të, pika 1, nënpika j) i ndryshuar, VKM-së nr. 943, datë 28.12.2016, *"Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 759", neni 25* pika 1, nënpika ç). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6. faqe 144-148 të Raportit të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve (DPULMI) dhe Bashkia Berat të merren masa për:

- Të miratuar vetëm ato aplikime për pajisje me leje ndërtimi të cilat respektojnë kërkesat dhe dispozitave ligjore dhe rregullatore në lidhje me dokumentacionin që duhet dorëzuar në sistemin e-lejet, siç janë projekti hidraulik, projekti i instalimeve të ngrohje – ftohje – ventilim, vërtetimet e regjistrimit në QKB, etj;
- Të kërkuar nga ASHK, jo vetëm dhënien e miratimit apo miratimin në heshtje, por, në çdo rast që kërkohet mendimi i DVASHK, përgjigja duhet të përmbajë statusin juridik të pronës / pronave apo kartelën e pasurisë / kartelat e pasurive, si dhe hartën / hartat kadastrale për pronën/ pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Në shqyrtimin e dosjes së lejes së ndertimit miratuar me Vendim nr. 1377/4 prot., datë 03.06.2024, projekti i munguar në fazën e lejes do të kërkohet në procedurat në vazhdim që objekti do të ndjek deri në marrjen e certificates së përdorimit. Në lidhje me kartelat e pasurise së paluajtshme që nuk janë ngarkuar të arzhonuara gjatë 3 muajve të fundit, sqarojmë se është dërguar për mendim në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) ku pergjigjia është konformë dokumentit të pronësisë të ngarkuar në sistem e-leje. Në lidhje me vertetimet e statusit aktiv për të gjithë subjektet që kanë hartuar projektet ndertimore, në sistemin e-lejen janë ngarkuar projektet dhe licensat perkatese per cdo projekt dhe QKB per cdo subjekt eshte e verfikueshme per statusin aktiv ne faqen e Qendres Kombetare te Biznesit. Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-leje rezultoi se licensa e hartuesit të relacionit-projektit gjeologjik është e bashkëlidhur me relacionin ngarkuar në sistem. Në sistemin e-leje janë ngarkuar projektet dhe licencat përkatëse për cdo projekte dhe QKB për cdo subjekt eshte e verfikueshme per statusin.

Zbatimi: Rekomandimi 15.1 **është në proces zbatimi**

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur nga Kryeinspektori i IMT Berat, blloqet e vendimit të prishjes, u konstatua se nga 25 raste (gjithsej) në **7** raste**,** nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e "Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm", konkretisht:

1. Vendim për prishje nr. 285 datë 10.01.2024.
2. Vendim për prishje nr. 287 datë 23.01.2024 .
3. Vendim për prishje nr. 288 datë 12.03.2024.
4. Vendim për prishje nr. 290 datë 12.04.2024.
5. Vendim për prishje nr. 291 datë 25.04.2024.
6. Vendim për prishje nr. 292 datë 09.09.2024.
7. Vendim për prishje nr. 293 datë 21.10.2024.

Veprime në kundërshtim me *nenin 5 pika "d" dhe nenin 13 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar dhe në kundërshtim me nenin 52 pika 6 të Ligjit Nr. 107 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin*

e Territorit" i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7. faqe 148-154 të Raportit të Auditimit).

16.1. Rekomandim: Kryeinspektori i IMT-së Bashkia Berat, të nxjerrë Urdhër Ekzekutimi për prishjen e objekteve të kundërligjshëm për 7 subjekte që janë me vendim për "Prishje Objekti të Kundërligjshëm".

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Në mbështetje të pikës 2, të nenit 3, të ligjit nr. 127/2024,"Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga data 1 janar 2015 deri më 30 nëntor 2024, inspektoratet vendore të mbrojtjes së territorit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, si dhe Policia e Shtetit e Policia Bashkiake", si dhe në zbatim të VKM nr. 274, datë 09.05.2025 "Për përcaktimin e procedurave që ndiqen për shfuqizimin e masave administrative të paekzekutuar", masat administrative janë shfuqizuar.

Zbatimi: Rekomandimi 16.1 **është zbatuar**

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shkresave përcjellëse u konstatua se në **2 raste,** nga Kryeinspektori i IMT Berat është bërë "Kërkesë për mbështetje" drejtuar Agjencisë së Shërbimeve Publike" dhe "Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit" në lidhje me ekzekutimin për prishjen e objekteve të kundërligjshëm.

-Në 6 raste nga Kryeinspektori IMT Berat nuk është bërë "Kërkesë për mbështetje" drejtuar Institucioneve ligj zbatuese, në lidhje me ekzekutimin për prishjen e objekteve të kundërligjshëm, duke qenë se, IMT Berat nuk zotëron mjete për ekzekutimin e *"Vendimeve për Prishje".*

-Në 2 raste nga IMT Berat është punuar me dy standarde në lidhje me prishjet e ndërtimeve pa leje. Në dy raste është zbatuar Urdhri i Kryetarit të Bashkisë Berat për prishje të ndërtimeve pa leje në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Policinë e Shtetit, ndërsa në lidhje me vendimet për prishje të lëshuar gjatë vitit 2024 nga vetë IMT Berat nuk është ekzekutuar asnjë dhe pse janë bërë dy kërkesa për bashkëpunim me institucione të tjera ligj zbatuese. *Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me, neni 5, pika d, ligji nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7. faqe 148-154 të Raportit të Auditimit).*

17.1. Rekomandim: Në të gjitha rastet kur ka një urdhër ekzekutimi nga Kryeinspektori i IMT për prishjen e objektit të kundërligjshëm që nuk mund të ekzekutohen me mjetet e veta, të kërkohet mbështetje me mjete nga Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit për prishjen e objektit të kundërligjshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Kryeinspektori që prej fillimit të ushtrimit të detyrës dhe aktualisht i drejtohet shkresërisht për bashkëpunim për mjete dhe burime njerëzore Agjensisë së Shërbimeve Publike përkatësisht me shkresën nr.4594 prot., datë.11.08.2025, nr.4689 prot., datë 15.08.2025, nr.5196 prot., datë 12.09.2025, nr.1162 prot., datë 14.02.2026., nr.1211 prot., datë 23.02.2026 si dhe Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit me shkresën nr.3995 prot., datë 17.07.2025., nr.4556 prot., datë 08.08.2025., nr.2228 prot., datë 06.09.2025 për të realizuar ekzekutimin e vendimeve të prishjes. Inspektorati i Mbrojtjes së Teritorit ka vetëm një mjet në inventar por dhe kjo aktualisht është jashtë përdorimit në servis. Ka vetëm dy inspektor në detyrë, nuk ka fadromë apo mjete të tipit të ngjashëm dhe persona të trajnuar për përdorimin e tyre në mënyrë që objektet e kundërligjshme të prishen nga ana e IMT drejtpërdrejt.

Zbatimi: Rekomandimi 17.1 **është në proces zbatimi**

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbajtur nga inspektorët e IMTV, procesverbalet e kontrollit dhe aktet administrative u konstatua se në **asnjë rast** nga IMT-ja e Bashkisë Berat nuk është bërë kallëzim penal subjekte që kanë kryer ndërtime informale pa leje ndërtimi, në kundërshtim të nenit 5 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007*"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar, pika dh), si dhe nenit 52 i Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar, pika 7. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7. faqe 148-154 të Raportit të Auditimit).*

18.1. Rekomandim: Në të gjitha rastet kur konstatohen punime pa leje ndërtimi për banesa apo njësi shërbimi, të referohen me kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit dërgon në çdo rast informacion pranë Komisariatit Vendor të Policisë dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor. Nuk janë përgatitur konkretisht kallëzime pasi gjatë momentit të konstatimeve në çdo rast ka qënë prezent dhe sektori i krimeve nga komisariati dhe kanë bërë dhe ata njëkohësisht vazhdimin e procedurës së referimit të veprës penale ndërtim pa leje pranë instancës kompetente.

Zbatimi: Rekomandimi 18.1 **është zbatuar**

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se në 3 raste edhe pse janë mbajtur akt konstatime për ndërtime pa leje ndërtimi nga Inspektorët në terren nga ana e Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura brenda afatit 10 ditor për nxjerrjen e vendimit për "Dënim me Gjobë" në kundërshtim me nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"* i ndryshuar. Subjektet më poshtë, për të cilët nga IMT Berat nuk është marrë Vendim me gjobë.

-R. M Akt Konstatimi 18.03.2024
-O. Sh Akt Konstatimi 10.06.2024
-J. Sh Akt Konstatimi 23.10.2024

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7. faqe 148-154 të Raportit të Auditimit).

19.1. Rekomandim: Kryeinspektori i IMT-së Bashkia Berat në vijim për subjektet që konstatohen me shkelje të marrë masa që të vijojë nxjerrjen e vendimit me "Dënim me Gjobë" brenda afatit 10 ditor siç e përcakton ligji.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Çdo rast që është mbajtur në bllokun e procesverbaleve të konstatimit të kundërvajtjes nga inspektorët është vijuar procedura vazhduese për nxjerrjen e vendimit të denimit me gjobë dhe vendimit të prishjes.

Zbatimi: Rekomandimi 19.1 **është zbatuar**

20. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur i Raportit Përfundimtar të Auditimit me nr. 31/8 prot. datë 15.05.2024, statusi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

- Mbi respektimin e afatit ligjor prej 20 ditësh, Bashkia Berat ka respektuar këtë afat, në përputhje me nenin 15, shkronja "j", të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, duke kthyer përgjigje sipas shkresës me nr.200/6 Prot., datë 05.06.2024, mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH.
- Mbi respektimin e afatit ligjor prej 6 muajsh, Bashkia Berat ka marrë masat për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, në përputhje me

nenin 30 të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*, duke kthyer përgjigje me anë të shkresës me Nr. 200/7 Prot., datë 14.11.2024.
- Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 13 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 13 masa. Nga masat e pranuara është zbatuar pjesërisht 1 masë, në proces zbatimi 4 masa, zbatuar 4 masa dhe pa zbatuar 4 masa.
- Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 2 masa me vlerë 852,850 lekë, deri më datë 30.07.2024**,** të cilat janë pranuar plotësisht. Nga masat e pranuara 2 masa nuk janë zbatuar
- Për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia janë rekomanduar 5 masa, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga 5 masat e pranuara rezulton 1 masë zbatuar pjesërisht, 1 masë zbatuar, 2 masa pa zbatuar dhe 1 masë në proces zbatimi.
- Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, të ardhura të munguara janë rekomanduar 3 masa**,** të cilat janë pranuar plotësisht. Nga 3 masat e pranuara rezulton 1 masa zbatuar pjesërisht, 1 masë pa zbatuar dhe 1 masë në proces zbatimi.
- Janë rekomanduar 16 masa disiplinore, gjendja e të cilave paraqitet si më poshtë;
Sipas "Ligjit për Nëpunësin Civil" i janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Berat që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore për 16 punonjës.
Nga verifikimi rezultoi se janë dhënë 15 masa disiplinore "vërejtje". Statusi i këtij rekomandimi konsiderohet zbatuar pjesërisht.
- Janë rekomanduar 9 masa administrative, gjendja e të cilave paraqitet si më poshtë;
Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2012, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*"; nenin 132 të ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", si dhe shkronjat (b, c, ç) e nenin 58-"Llojet e masave disiplinore", të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "*Për kundërvajtjet administrative*", i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për 9 (nëntë) punonjës,
Nga verifikimi rezultoi se referuar shkresës me nr. 4787/3 prot., datë 20.02.2025 e administruar në shkresën me protokoll nr. 31/13 prot., datë 21.02.2025 është dërguar vendimi nr.07, datë 20.02.2025 i Agjencisë së Prokurimit Publik për Bashkinë Berat.
Nisur nga sa më sipër, *veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 15, "Të drejtat e KLSH" të ligjit Nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe (199-228) të Raportit të Auditimit).*
20.1. Rekomandim: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit*", për përmirësimin e gjendjes ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshpejtimin e atyre në proces:
***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezultoi se është rikërkuar zbatimi i 2 masave organizative, 2 masave për shpërblimin e dëmit, 1 masë për elimimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, të ardhurat e munguara, 1 masë për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia dhe 1 masë disiplinore. Sa më sipër, ka rezultuar se 2 masat organizative janë zbatuar, 2 masat për shpërblimin e dëmit ekonomik janë në proces zbatimi, 1 masë për efektet negative është në proces zbatimi, 1 masë për arkëtimin e detyrimeve, taksa dhe qira, është në proces zbatimi, si dhe 1 masë displinore është zbatuar.

Zbatimi: Rekomandimi 20.1 **është në proces zbatimi**

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*" neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 "*Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë*", nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", **nga Titullari i njësisë publike,** të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **3,894,590.74 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 5013 prot., datë 06.10.2022 dhe objekt: "Rindërtimi i shkollës së mesme "Babë Dudë Karbunara" Bashkia Berat, me vlerë 433,517,127 lekë me TVSH, të lidhur me subjektin "B" SHPK me NIPT J62 dhe Lic. Nr. NZ.09, përfaqësuar nga Administratori Znj. D. A & OE "L" SHPK me NIPT K24 dhe Lic. Nr. NZ.483, përfaqësuar nga Administratori Z. A. Ll & OE "A" SHPK me NIPT L42 dhe Lic. Nr. NZ.70, përfaqësuar nga Administratori Z. N. Ç, *rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara si dhe zëra pune të realizuar jo në përputhje me specifikimet teknike*, për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km; Kasetë shkarkimi me llamarinë bakri 1.0 mm; Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë bakri Ø 120 mm], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Berat, në vlerën **2,473,089 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 123-135 të Raportit të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Berat në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancia e punimeve të dëmit ekonomik në vlerën **2,473,089 lekë pa TVSH,** përfituar padrejtësisht nga kontraktori "B" SHPK & OE "L" SHPK & OE "A" SHPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara në volumet e situacionuara dhe jo në përputhje me specifikimet teknike.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 6244 prot., datë 05.12.2023 me objekt: "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet të varfëra dhe të pafavorizuara" Bashkia Berat, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Berat, përfaqësuar nga Kryetari Z. E. D dhe kontraktorit "L" SHPK me NIPT K01 dhe Lic. Nr. NZ.480, përfaqësuar nga Administratori Z. M. K & OE "S" SHPK me NIPT K13 dhe Lic. Nr. NZ.--, përfaqësuar nga Administratori Z. S. H me vlerë të kontratës 61,560,900 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 180 ditë, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [*Veshje muri të jashtëm me polisterol jeshil t=5cm, + rrjetë + suva; Bojë hidroplastike; F.V Dyer druri importi cilësia II-të; F.V Bolier 100 litër import*], me pasojë **dëm ekonomik** në buxhetin e Bashkisë Berat, në vlerën **202,437.74 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim

me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 123-135 të Raportit të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Berat në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancia e punimeve të dëmit ekonomik në vlerën **202,437.74 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga kontraktori "L" SHPK & "S" SHPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara në volumet e situacionuara dhe jo në përputhje me specifikimet teknike.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 6196 prot., datë 04.12.2023 me objekt: "Ndërtimi i tregut të gjelbër Berat (Green Market)" Bashkia Berat, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Berat, përfaqësuar nga Kryetari Z. E. D dhe kontraktorit "K." SHPK me NIPT L78 dhe Lic. Nr. NZ.759, përfaqësuar nga Administratori Z. K. C & "C.M" SHPK me NIPT L88 dhe Lic. Nr. NZ.77, përfaqësuar nga Administratori Z. M. C, me vlerë të kontratës 19,961,880 lekë me TVSH dhe, afat të realizimit të kontratës 180 ditë, *rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara* për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [*Ndërtim mure struktura monolite betoni C 25/30; Strukturë monolite betoni C 12/15;*], me pasojë **dëm ekonomik** në buxhetin e Bashkisë Berat, në vlerën **74,840 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 123-135 të Raportit të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Berat në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancia e punimeve të dëmit ekonomik në vlerën **74,840 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga kontraktori, OE "K" SHPK & "C. M" SHPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara në volumet e situacionuara.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 91 prot., datë 08.01.2024 me objekt: "Ndërtimi i rrugës pranë Vala Park Berat" Bashkia Berat, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Berat, përfaqësuar nga Kryetari Z. E. D dhe shoqërisë "R. C" SHPK me NIPT L43 dhe Lic. Nr. NZ.79, përfaqësuar nga Administratori Z. A. R me vlerë të kontratës 13,644,852 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës brenda 4 javëve nga data e nënshkrimit dhe garanci punimesh 2 vite, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka, Gërmim dheu gropa shtyllash, Transport material ndërtimi, dheu me auto deri 5 km, FV Shtylla metalike konike ndriçimi H=9m, PAICC-3, FV Krah shtylla metalike KRH-MSI 1500/1500/10, FV Ndriçues smart VP CLI CR M-S 250 Ë GG FAE, FV Elektroda tokëzimi të xinguara 50x3 mm, L=150 cm., Përcjellës tokëzimi bakri Cu, S=50 mm2 I zhveshur, FV Puseta plastike 40x40x40, kapak të forte RIC 1084+1086, FV Tuba PVC f=200 mm të brinjëzuar (për vendosjen e shtyllave), FV Morseteri shtylle 3P + Sig 10 A + kapak, FV Tub plastic D=110 mm, FV Përcjellës Cu të izoluar me gomë, për ndriçim, me isolator, sexion 1.5 mm2, FV Përcjellës Cu të izoluar me gomë, për ndriçim, me isolator, sexion 2.5 mm2, FV Përcjellës Cu të izoluar me gomë, për ndriçim, me isolator, sexion 4 mm2, FV Përcjellës Cu të izoluar me gomë, për ndriçim, me isolator, sexion 6 mm2, Shtresë rëre nën dhe mbi tubacione +

kompaktësimi] si dhe penalitet për pune jashtë afatit të kontratës, me pasojë **dëm ekonomik** në buxhetin e Bashkisë Berat, në vlerën **1,144,224 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 123-135 të Raportit të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Berat në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancia e punimeve të vlerës **1,144,224 lekë pa TVSH lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga shoqëria sipërmarrëse "R" SHPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara në volumet e situacionuara.

Menjëherë

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Në lidhje me 4 (katër) rekomandimet për zbritjen nga garancia e punimeve të vlerave të konstatuara si dëm ekonomik, total 3,894,590.74 lekë pa TVSH, Bashkia Berat sqaron se këto masa nuk mund të zbatohen në këtë moment, pasi është e kushtëzuar nga përfundimi i afatit të garancisë së kontratave përkatëse dhe plotësimi i kushteve procedurale të kthimit të garancisë. Rastet e konstatuara do të trajtohen në momentin e përfundimit të periudhës së garancisë së punimeve, ku bashkia do të procedojë me zbritjen e vlerave përkatëse të dëmit ekonomik nga garancitë kontraktore, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kontratat respektive.

Zbatimi: Rekomandimi 1.1 **Pa zbatuar**
Zbatimi: Rekomandimi 2.1 **Pa zbatuar**
Zbatimi: Rekomandimi 3.1 **Pa zbatuar**
Zbatimi: Rekomandimi 4.1 **Pa zbatuar**

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË TYRE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se Bashkia Berat në datën 01.01.2024 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta dhe granti në vlerën 17,587 mijë lekë. Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2024 është planifikuar për likuidim vlera 17,578 mijë lekë. Gjatë vitit 2024 është likuiduar vlera prej 1,738 mijë lekë për detyrimet e prapambetura dhe ka mbetur për likuidim vlera 15,840 mijë lekë.

Detyrime të reja të krijuara janë në vlerën 49,376 mijë lekë. Totali progresiv i detyrimeve të prapambetura të raportuara nga Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit janë në vlerën 65,217 mijë lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" neni 55. Marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion dhe krijimi i detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", pikat 82-91. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.1, faqe 28-37, të Raportit të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve

paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Në lidhje me rekomandimin për menaxhimin dhe prioritarizimin e detyrimeve të prapambetura, Bashkia Berat sqaron se struktura e detyrimeve të raportuara në fund të vitit 2024 është e përbërë nga kategori me natyrë të ndryshme financiare dhe ligjore, të cilat nuk reflektojnë një situatë homogjene të mungesës së likuiditetit. Në stokun e detyrimeve perfshihen 987,360 lekë detyrime për mallra, për blerje ushqime për kopshte dhe cerdhe, të vitit 2019. Bashkia është në proces gjyqësor me operatorin M. K. ShPK, për mosrespektim kontrate. Gjithashtu përfshihen 15,742,863 lekë detyrime për investime në vitet 2017-2019 të cilat nuk janë marrë në dorëzim përfundimtar pasi nuk janë kryer punimet sipas kontratës. Për rrjedhojë, këto detyrime nuk janë të likuidueshme në gjendjen aktuale, deri në përmbylljen e procedurave të marrjes në dorëzim dhe plotësimin e dokumentacionit final teknik dhe ligjor.

Ndërkohë, rritja e detyrimeve gjatë vitit 2024 në vlerën 48,487 mijë lekë lidhet kryesisht me një detyrim të krijuar nga një vendim gjyqësor për shpronësim objekti, i cili përbën detyrim të njohur ligjor për bashkinë tonë dhe i cili nuk ka natyrën e angazhimeve të krijuara nga procedurat e zakonshme të shpenzimeve buxhetore. Bashkia Berat ka vlerësuar që likuidimi i këtij detyrimi të realizohet në mënyrë të programuar brenda një periudhe 3-vjeçare, në përputhje me kapacitetet buxhetore dhe parimet e qëndrueshmërisë fiskale.

Zbatimi: Rekomandimi 1.1 **është në proces zbatimi**

2. Gjetje nga auditimi: Për zbatimin e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna për vitin 2024, Bashkia Berat ka shpenzuar vlerën 9,193 mijë lekë. Gjatë vitit 2024 janë kontabilizuar 10 (dhjetë) vendime gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna më vlerë 9,193 mijë lekë, të cilat janë likuiduar. brenda vitit 2024. Vlera totale 9,193 mijë lekë e shpenzuar për periudhën 01.01.2024- 31.12.2024 nga Bashkia Berat, për zbatimin e vendimeve gjyqësore, konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet**.**

Veprime këto në kundërshtim me UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*" i ndryshuar, pika 60. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.1, faqe 28-37 të Raportit të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat të ngrejë një grup pune për të analizuar të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien e çështjeve gjyqësore, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, nuk rezulton që të jetë ngritur grup pune me qëllim kryerjen e analizës për humbjen e proceseve gjyqësore. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Zbatimi: Rekomandimi 2.1 **nuk është zbatuar**

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA

1. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i pagesave të tarifave të qirasë rezultoi se, në fund të vitit 2024 janë debitorë 2 (dy) shoqëri qiramarrëse **në vlerën 343,893 lekë.** Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*", i ndryshuar Kreu VI, pika 2/e. Debitorët të analizuar paraqiten si më poshtë:
1. R. B. nuk ka bërë asnjë pagesë gjatë vitit 2024 për kontratën e ATM në lulishten në lagjen "Çelepias", duke mbetur debitor për shumën 84,000 lekë.
2. B. T. ka detyrim vjetor për vitin 2024 tarifën në vlerën 3,118,716 lekë, ka paguar 2,858,823 lekë dhe mbetet debitor vetëm për muajin dhjetor 2024 në vlerën 259,893 lekë, pagesë të cilën ka afat ta shlyejë deri në muajin shkurt të vitit pasardhës.
Nga auditimi i dokumentacionit të kontratave të lidhura dhe arkëtimeve të kryera nga ana e familjarëve për banesat sociale rezultoi se **në fund të vitit 2024 janë debitorë 8 familje në vlerën 341,380 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.5, faqe 135-144 të Raportit të Auditimit).*
1.1. Rekomandim: Sektori i Pronave dhe Strehimit në bashkëpunim me Sektorin Juridik Bashkia Berat të marrin masa të menjëhershme dhe të ndjekin të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës **682,273 lekë,** si dhe të bëhet menjëherë përditësimi i kontratave të qirave për vitet në vazhdim.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Për 10 (dhjetë) debitorë të datës 31.12.2024 të gjetur nga auditimi është ndjekur arkëtimi i vlerave të debisë nga sektori i Pronave dhe Strehimit. Arkëtimet e vlerave të debisë për sa trajtuar nga gjetja e auditim, janë ndjekur nga specialisti i këtij sektori në ditarët përkatës të të ardhurave të Bashkisë Berat, nga të cilët rezulton që 9 (nëntë) debitorë kanë likujduar totalisht detyrimin e tyre dhe për 1 (një) prej tyre ngelet pa likujduar vlera 20,032 lekë.

Zbatimi: Rekomandimi 1.1 **është zbatuar pjesërisht**

2. Gjetje nga auditimi: Përgjatë vitit 2024 në territorin e Bashkisë Berat kanë ushtruar aktivitet 3 (tre) subjekte në fushën e ndërtimit të cilat nuk janë të pajisur me nipt Sekondar referuar kontratave si më poshtë:
- Kontrata e datës 18.11.2024, lidhur ndërmjet Bashkisë Berat dhe OE *"A"* ShPK me objekt *"Rehabilitim i nyjes së trafikut Spitali Rajonal Bashkia Berat"* me afat përfundimi të punimeve 62 ditë kalendarike më datë 18.01.2025, për të cilën nuk janë përllogaritur detyrimet tatimore në vlerën 33,500 lekë.
- Kontrata e datës 12.11.2024, lidhur ndërmjet Bashkisë Berat dhe OE *"A"* ShPK me objekt *"Vendosje tendash në Tregun e Gjelbër Berat Green Market"* me afat përfundimi të punimeve 93 ditë kalendarike më datë 12.02.2025, për të cilën nuk janë përllogaritur detyrimet tatimore në vlerën 44,667 lekë.
- Kontrata e datës 23.08.2024, lidhur ndërmjet Bashkisë Berat dhe OE *"I"* ShPK me objekt *"Master plani i ndriçimit të qytetit të Beratit"* me afat përfundimi të punimeve 62 ditë kalendarike më datë 23.10.2024, për të cilën nuk janë përllogaritur detyrimet tatimore në vlerën 33,500 lekë.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 22 dhe nenet 48-49, të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, *"Për regjistrimin e biznesit"* i ndryshuar, ku këto subjekte duhet të shlyejnë detyrimet për taksat dhe tarifat vendore ndaj institucionit. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 37-49 të Raportit të Auditimit).*
2.1. Rekomandimi: Bashkia Berat, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha

shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimeve për subjektet që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Berat të pa pajisur me NIPT sekondar në vlerën **111,667 lekë.**

Menjëherë

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike ka ndërmarrë veprimet administrative për identifikimin dhe njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Berat të pa pajisur me NIPT sekondar. Konkretisht, subjektet përkatëse janë njoftuar zyrtarisht përmes shkresave me nr. 7029 prot. nr. 7030 prot. dhe nr. 7031.prot datë 12.12.2025 duke i'u kërkuar likuidimin e detyrimeve përkatëse. Njëkohësisht, për subjektet që nuk kanë reflektuar pas njoftimeve të kryera po ndiqen procedurat dhe masat ligjore përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të arkëtimit të plotë të vlerës së detyrimeve ndaj Bashkisë Berat.

Zbatimi: Rekomandimi 2.1 **është në proces zbatimi**

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se deri më datë 31.12.2023, për mospagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë abonentët familjarë në vlerën 167,436,492 lekë. Përgjatë vitit 2024 për llogari të detyrimeve që i përkasin vitit 2023 është likuiduar vlera 19,271,814 lekë si dhe janë krijuar debitorë në vlerën 27,324,330 lekë. Gjendja debitore më 31.12.2024, është në vlerën **175,489,008 lekë.**

1. Vlera **3,575,875 lekë** e cila i përket **6,488 familjeve** është për mosarkëtimin e taksës së truallit;
2. Vlera **26,697,488 lekë** e cila i përket **5,266 familjeve** është për mosarkëtimin e taksës së ndërtesës;
3. Vlera **74,236,231 lekë** e cila i përket **7,985 familjeve** është për mosarkëtimin e taksës së tokës bujqësore;
4. Vlera **33,663,540 lekë** e cila i përket **5,417 familjeve** është për mosarkëtimin i tarifës së pastrimit;
5. Vlera **10,774,725 lekë** e cila i përket **2,726 familjeve** është për mosarkëtimin i tarifës së ndriçimit;
6. Vlera **6,089,749 lekë** e cila i përket **5,930 familjeve** është për mosarkëtimin i tarifës së ndriçimit;
7. Vlera **4,540,866 lekë** e cila i përket **4,997 familjeve** është për mosarkëtimin i tarifës së arsimit;
8. Vlera **6,128,461 lekë** e cila i përket **3,074 familjeve** është për mosarkëtimin i tarifës sëvaditjes dhe kullimit;
9. Vlera **86,570 lekë** e cila i përket **126 familjeve** është për mos përllogaritje kamatvonese:
9. Vlera **9,695,502 lekë** nga debitorët sipas akt-kontrolleve në Njësitë Administrative Otllak, Velabisht. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, Kreu XI, nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, neni 9, pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, *"Për financat e qeverisjes vendore"*, neni 35.*(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 37-49 të Raportit të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Bashkia Berat, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat administrative e ligjore duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **175,489,008 lekë** për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave ka nisur zbatimin e rekomandimeve kjo e bazuar dhe në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat

Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, përkatësisht:
Janë dërguar bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare për debitorët progresiv për uljen e debisë, që fillojnë me nr.6305 deri 6435 prot., datë 25.11.2024 (gjithësej 130 subjekte), me nr.6778 deri 6916 prot., datë 11.12.2024 (gjithësej 138 subjekte). Shuma e arkëtuar nga kjo masë e marrë 6,565,550 lekë. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Zbatimi: Rekomandimi 3.1 **është në proces zbatimi**

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se deri më datë 31.12.2023, për mospagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet si biznes i vogël dhe biznes i madh në vlerën **134,778,718 lekë.** Përgjatë vitit 2024 për llogari të detyrimeve që i përkasin vitit 2023 është likuiduar vlera 10,200,451 lekë si dhe janë krijuar debitorë në vlerën 21,142,173 lekë. Në total detyrimet tatimore në mënyrë progresive, më datë 31.12.2024, për subjektet biznes i vogël dhe i madh janë në vlerën **155,920,891 lekë.**
Nga auditimi i të dhënave të pasqyruara në Sistemin TAIS, më datë 26.02.2025, grupi i auditimit gjeneroi një Raport Përmbledhës mbi gjendjen e debisë deri më 31.12.2024, ku evidentohet se gjendja debitore është në vlerën totale 171,344,392.52 lekë. Në lidhje me këtë situatë grupi i auditimit kërkoi gjenerim raporti përmbledhës mbi debinë nga kompania që kryer shërbimin e mirëmbajtjes. Me email-in e datës 27.02.2025, ora 11:54, përfaqësuesja e kompanisë nëpërmjet email-it hm@i ka dërguar një raport pranë institucionit Bashkia Berat specialistit të IT në adresën @bashkiaberat.gov.al ku gjendja debitore më 31.12.2024, është në vlerën 134,455,123.16 lekë. ***Për sa trajtuar sipër për të njëjtën periudhë në Sistemin TAIS të aplikuar nga Bashkia Berat janë gjeneruar Raporte Debie me vlera të ndryshme.***
Në lidhje me këtë situatë DTT e Bashkisë Berat për asnjë nga subjektet si biznes i vogël dhe i madh, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe me vlera të kosiderueshme, janë njoftuar dhe rinjoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë nisur urdhër bllokimet e llogarive, por në asnjë rast nuk është kërkuar kallëzim penal në zbatim të Ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995, *"Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë"* i ndryshuar, neni 181. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, neni 9, pika 1.3., Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për financat e qeverisjes vendore"*, neni 35, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"*, neni 3, pikat 9-10 dhe Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Kreu XI, nenet 88-104. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 37-49 të Raportit të Auditimit).*
4.1. Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Berat të merren masa për ngritjen e një grupi pune në të cilën të përfshihen specialist të IT, ku në bashkëpunim me kompaninë e kontraktuar për shërbimin e mirëmbajtës të sistemit TAIS, të saktësojë dhe të dokumentojë vlerën e debitorëve për kategorinë biznes i madh dhe i vogël. Në rast se nga procesi i verifikimit konstatohen diferenca ndërmjet debitorëve faktit dhe atyre të regjistruar në sistemin TAIS të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, diferencat nga personat përgjegjës.

Menjëherë

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Në zbatim të rekomandimit janë ndërmarrë masat për ngritjen e grupit të punës, Urdhër i Kryetarit te Bashkisë Nr. 329, datë 20.04.2026, nr.2429 prot "Për saktësimin dhe dokumentimin e debitorëve në sistemin TAIS" është ngritur grupi i punës i perberë nga 5 anëtarë të Drejtorisë së Taksave e Tarifave me përfshirjen e specialistëve të IT-së, në bashkëpunim me subjektin e kontraktuar për mirëmbajtjen e sistemit TAIS. Aktualisht,

procesi ndodhet në fazën e verifikimit, rakordimit dhe dokumentimit të të dhënave që lidhen me vlerën e debitorëve për kategoritë biznes i madhë dhe biznes i vogël, me qëllim evidentimin e saktë të detyrimeve dhe pasqyrimin korrekt të tyre në sistem.

Zbatimi: Rekomandimi 4.1 **është në proces zbatimi**

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Dega Berat janë dërguar zyrtarisht me shkresë listat e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi. Nga auditimi rezultoi se deri më 31.12.2024, për mospagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë detyrimi për këtë taksë është në vlerën 41,353,273 lekë për 1,415 përfitues. Përgjatë vitit 2024 vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është 2,266,700 lekë për 81 persona nga e cila është arkëtuar vlera 75,774 lekë dhe janë krijuar debitorë në vlerën 2,190,926 lekë, ndërsa gjendja debitore më 31.12.2024, është në vlerën **43,544,199 lekë për 1,496 persona.** Për më tepër nga Bashkia Berat për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitore si dhe nuk u evidentuan raste që institucioni të jetë drejtuar ASHK Berat për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, *"Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje"*, neni 27, pika *"d"*, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, *"Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim"* i ndryshuar, pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, 37-49 të Raportit të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave mbi subjektet debitore për *"Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet"* dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 1,496 debitorë në vlerën 43,544,191 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të dërgojë informacion periodik në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit lidhur me listën e debitorëve për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Berat të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Nga DPTLMI dhe nga Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave është komunikuar në lidhje me situatën e 1,496 debitorëve të konstatuar për mospagesën e "Taksës së ndikimit në Infrastrukturë" në vlerën 43,544,191 lekë, por ende nuk ka hapa shkresor për arkëtimin e kësaj takse. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Zbatimi: Rekomandimi 5.1 **nuk është zbatuar**

E. PËR MASA ADMINISTRATIVE.

E.1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik (APP).

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me nenet 3, 76, 92 dhe 98 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23/12/2020 "*Për Prokurimin Publik*", si dhe nenet 41, 67, 78, 82 dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, personat përgjegjës të evidentuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2012, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*"; nenin 132 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", si dhe shkronjat (b, c, ç) e nenin 58, të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "*Për kundërvajtjet administrative*", **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik,** të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për:

a- Njësinë e Prokurimit dhe hartuesit e specifikimeve teknike, për mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, veprime të cilat direkt ose indirekt çojnë në mospjesëmarrjen e OE në procedura duke ulur konkurrencën ose skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme por me kapacitet për zbatimin e procedurës, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, respektivisht:

1- Procedura me objekt: **"***Ndërtim i shkollës 9 vjeçare 22 tetori dhe parkim nëntokësor"*, me nr. REF-01195-04-15-2024.

2- Procedura me objekt: *"Ndërhyrje rehabilituese në muret mbajtës dhe terrenet në territorin e Bashkisë në kuadër të mbrojtjes civile"*, *Bashkia Berat*, me nr. REF-12891-07-11-2024.

3- Procedura me objekt: *Rehabilitim i nyjes së trafikut Spitali Rajonal Bashkia Berat"*, me nr. REF-21376-09-24-2024.

4- Procedura me objekt: "*Ndërtim i shpatullave të urës së Lapardhasë 2", Bashkia Berat,*, me nr. REF-11942-07-03-2024.

5- Procedura me objekt: "*Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë", Bashkia Berat* me nr. REF-03823-05-07-2024.

6- Procedura me objekt: "*Mbikqyrje punimesh për objektin, Ndërtim i shkollës 9 vjeçare 22 tetori dhe parkim nëntokësor", Bashkia Berat,,* me nr. REF-08620-06-10-2024.

7- Procedura me objekt: "*Blerje materiale dekori", Bashkia Berat,,* me nr. REF-20449-09-18-2024.

Veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", si dhe nenet 41 dhe 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

b- Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme ose midis OE të skualifikuar KVO të vlerësonte kriterin kryesorë "*Çmimi më i leverdishëm*", respektivisht:

1- Procedura me objekt: **"***Ndërtim i shkollës 9 vjeçare 22 tetori dhe parkim nëntokësor"*, me fond limit 376,475 mijë lekë, me nr. REF-01195-04-15-2024.

2- Procedura me objekt: *"Ndërhyrje rehabilituese në muret mbajtës dhe terrenet në territorin e Bashkisë në kuadër të mbrojtjes civile"*, me nr. REF-12891-07-11-2024.

3- Procedura me objekt: *Rehabilitim i nyjes së trafikut Spitali Rajonal Bashkia Berat"*, , me nr. REF-21376-09-24-2024.

4- Procedura me objekt: "*Ndërtim i shpatullave të urës së Lapardhasë 2", Bashkia Berat*, me nr. REF-11942-07-03-2024.

5- Procedura me objekt: "*Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë", Bashkia Berat,,* me nr. REF-03823-05-07-2024.

6- Procedura me objekt: "*Vendosje tende në tregun e gjelbërt Berat-Green Market", Bashkia Berat,* me nr. REF-21798-09-26-2024.
7- Procedura me objekt: "*Blerje Materiale Asfalti", Bashkia Berat,,* me nr. REF-98485-03-18-2024.
8- Procedura me objekt: "*Blerje materiale dekori", Bashkia Berat,,* me nr. REF-20449-09-18-2024.
9- Procedura me objekt: "*Blerje pjesë këmbimi dhe shërbime për mjetet e transportit ", Bashkia Berat,,* me nr. REF-17008-08-26-2024.
Veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenet 3- "Parimet e përzgjedhjeje", 9- "Anulimi i një procedure", 76- "Kriteret detyruese për skualifikim", 92- "Shqyrtimi i ofertave", si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, nenet 67- "Klasifikimi i ofertave", 82- "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", 83- "Njoftimi i fituesit" *(Trajtuar në pikën 4 faqe 76-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Me vendimin nr. 08 datë 24.02.2026 të Agjencia e Prokurimit Publik, **vendosi:**
Të dënojë me gjobë sipas shumave personat e më poshtëm:

1.Znj. R. V 30,000 (tridhjetë mijë) lekë	Derdhur në bankë 30.000 lekë dt 17.3.2026
2 Znj. J. M 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë	0 lekë
3.Z. R. S 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë	Derdhur në bankë 50.000 lekë dt 12.3.2026
4.Z. F. D 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë.	0 lekë
5.Znj. E. D 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë;	Derdhur në bankë 50.000 lekë dt 10.3.2026
6.Z. B. Ç 60,000 (gjashtdhjetë mijë) lekë;	Derdhur në bankë 60.000 lekë dt 18.3.2026
6.Z. P. S 70,000 (shtatëdhjetë mijë) lekë;	Derdhur në bankë 70.000 lekë dt 12.3.2026
8.Z. A. B 80,000 (tetëdhjetë mijë) lekë;	Derdhur në bankë 80.000 lekë dt 12.3.2026
SHUMA 440.000 Lekë	**Shuma e derdhur 340.000 lekë**
	Zbatimi: Rekomandimi F.1 **është në proces zbatimi**

G. MASA DISIPLINORE

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja, mbështetur në nenin 15 *"Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së"*, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, nenin 58 *"Llojet e masave disiplinore"*, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil"*, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Berat**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

G.1. PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE.

a -"Vërejtje" neni 58 shkronja (a), për 14 punonjës si më poshtë:

1. **Znj. J. M,** në cilësinë e Drejtorit të Agjencisë së Shërbimeve Publike,
2. **Z. R. S,** në cilësinë e Përgjegjësit të Mirëmbajtjeve të Rrugëve;
3. **Z. E. A,** në cilësinë e anëtarit të marrjen në dorëzim të materialeve;

4. **Z. E. M,** në cilësinë e anëtarit të marrjen në dorëzim të materialeve;
5. **Z. G. L,** në cilësinë e anëtarit të marrjen në dorëzim të materialeve;
Për mos zbatimin e kërkesave të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik"*, neni 45. *(Trajtuar në pikën 4 faqe 104-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
6. **Z. S. T.,** në cilësinë e ish-Drejtorit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, për mangësitë e mëposhtme:
Për mos zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 9632, datë 30.102006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, kreu XI.
7. Znj. J. M, me detyrë Kryeinspektor i IMT-së Bashkia Berat nga periudha 03.04.2024 e në vazhdim, pasi nga auditimi u konstatua se:
-Në 8 raste, nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e "Urdhrit të Ekzekutimit për Prishjen e Objektit të Kundërligjshëm", që do të thotë se objektet e konstatuara të Kundërligjshëm për të cilat ka një vendim prishje, vijojnë të pa ekzekutuara nga IMT-ja e Bashkisë Berat duke u bërë shkaktar i rritjes së numrit të ndërtimeve informale që kalojnë në procesin e legalizimit, ku subjektet kanë përfituar parcela ndërtimore në pronësi publike, në zonat që kanë përparësi zhvillimin e turizmit, në kundërshtim me nenin 5 pika "d" dhe nenin 13 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*" i ndryshuar dhe në kundërshtim me nenin 52 pika 6 të Ligjit Nr. 107 datë 31.07.2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*" i ndryshuar.
-Në 6 raste nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është bërë "Kërkesë për mbështetje" drejtuar Institucioneve ligjzbatuese, në lidhje me ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, çfarë ka bërë që objektet e konstatuara të Kundërligjshëm për të cilat ka një vendim prishje**.** vijojnë të pa ekzekutuara nga IMT-ja e Bashkisë Berat.
8. **Z. G. C,** në cilësinë e inspektorit pranë IMTV, Bashkia Berat,
Për mangësitë e konstatuara në lidhje me mos-ushtrimin e aktivitetit inspektues. Për parregullsitë e konstatuara në zbatimin në terren të lejeve të ndërtimit të miratuara.
9. Znj. A. M, në cilësinë e Drejtorit, Drejtoria E Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit Të Investimeve, në një rast. (drejtori aktual).
10. Znj. E. Dh, në cilësinë e Drejtorit, Drejtoria E Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit Të Investimeve, në tre raste. (ish drejtor).
11. Z. L. B, në cilësinë e Drejtorit, Drejtoria E Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit Të Investimeve, në një rast. (ish drejtor).
12. Z. E. N, në cilësinë specialist për planifikimin e territorit dhe regjistrit elektronik pranë DPULMI; në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit të miratuara, për **5 (pesë)** raste. Problematikat e konstatuara kanë të bëjnë me: **i)** në pesë raste, dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë; **ii)** në dy raste, dokumentacion që është ngarkuar në sistem për të vërtetuar të drejtat mbi pronën, nuk është i rifreskuar; **iii)** në një rast nuk janë respektuar kondicionet urbane (lartësia maksimale).
13. Znj. V. K, në cilësinë e specialistit për monitorimin e investimeve dhe regjistrit elektronik pranë DPULMI, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të certifikatave të përdorimit të miratuara, për **1 (një)** rast. Problematikat e konstatuara kanë të bëjnë me: **i)** në një raste, dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë.

14. Znj. I. H, në cilësinë e specialist projektesh dhe regjistri elektronik pranë DPULMI, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit, për **1 (një)** rast. Problematikat e konstatuara kanë të bëjnë me: **i)** në një raste, dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë; **ii)** në një rast, i vetmi dokumentacion që është ngarkuar në sistem për të vërtetuar të drejtat mbi pronën, nuk është i rifreskuar.

G. 2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.
Për ish punonjësit e më poshtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e përmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e tyre.

1. **Z. A. N,** në cilësinë e ish-Drejtorit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, për mangësitë e mëposhtme:
Për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, kreu XI,.

G.3. Për të gjithë punonjësit e tjerë të trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për të cilët nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i të auditmit, **lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë Berat**, fillimin ose jo të procedurave disiplinore në referim të Ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", VKM nr. 115, datë 05.3.2014, "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil*" dhe shkronja "e" dhe "ç" të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale të punës.

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Në përgjigje të këtij rekomandimi theksojmë se për pikën a), nga Kryetari i Bashkisë Berat janë nxjerrë urdhërat për masa disiplinore konkretisht: "Për dhënie mase disiplinore" për: 1. znj. J. M, Urdhër nr. 154, datë 19.02.2026, 2. z. R. S, Urdhër nr. 153, datë 19.02.2026, 3. z. E. A, Urdhër nr. 152, datë 19.02.2026, 4. z. E. M, Urdhër nr. 151, datë 19.02.2026, 5. z. Gj. L, Urdhër nr. 150, datë 19.02.2026, 6. znj. J. M, Urdhër nr. 149, datë 19.02.2026, 7. znj. G. C, Urdhër nr. 148, datë 19.02.2026, 8. znj. E. Dh, Urdhër nr. 146, datë 19.02.2026.
Për punonjësit: 1. z. S. T, 2. znj. E. N, 3. znj. V. K, 4. znj. I. H, të cilët gëzojnë statusin e "nëpunësit civil", procedura disiplinore ndaj tyre është ndjekur nga Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Berat si "epror direkt" i tyre bazuar dhe në zbatim të ligjit nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil".
Në përfundim të procesit disiplinor Sekretari i Përgjithshëm ka nxjerrë vendimet përkatëse: 1. z. S. T, Vendim nr. 01, datë 04.02.2026, nr. 403/7 prot., datë 04.02.2026, "Për shqyrtimin e rekomandimit të Grupit të Auditimit, për dhënie mase disiplinore "Nëpunësit Civil"; 2. znj. E. N, Vendim nr. 02, datë 04.02.2026, nr. 403/8 prot., datë 04.02.2026, "Për shqyrtimin e rekomandimit të Grupit të Auditimit, për dhënie mase disiplinore "Nëpunësit Civil"; 3. znj. V. K, Vendim nr. 03, datë 04.02.2026, nr. 403/9 prot., datë 04.02.2026, "Për shqyrtimin e rekomandimit të Grupit të Auditimit, për dhënie mase disiplinore "Nëpunësit Civil"; 4. znj. I. H, Vendim nr. 04, datë 04.02.2026, nr. 403/10 prot., datë 04.02.2026, "Për shqyrtimin e rekomandimit të Grupit të

Auditimit, për dhënie mase disiplinore "Nëpunësit Civil". Për punonjësit e tjerë, znj. A. M dhe z. L. B theksojmë se janë larguar nga detyra përkatësisht me Urdhërin nr. 626, datë 09.09.2025 dhe me Urdhërin nr. 273, datë 30.04.2024. Sa më sipër për punonjësit me statusin e nëpunësit civil nuk dokumentohet vendosja e masës disiplinore.

Zbatimi: Rekomandimi G.1 **është zbatuar plotësisht**

G.4. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.

Për punonjësit që do të jepen masa disiplinore, pas përfundimeve të afateve ankimore, Bashkia Berat, të ndërmarrë veprimet si më poshtë**:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.

G.4.a Nga verifikimi rezultoi se: Nga komisioni disiplinor i Bashkisë Berat nuk është dhënë masë disiplinore për punonjësit me status civil dhe nuk ka njoftim në Departamentin e Administratës Publike.

Zbatimi: Rekomandimi G.4 **nuk është zbatuar**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. E. C me detyrë Kryetar i Bashkisë Berat
2. Znj. A. T me detyrë Sekretar i Përgjithshmëm i Bashkisë Berat

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve auditimi financiar i dërguar me shkresën 975 prot., datë 12.02.2026 në mënyrë të përmbledhur paraqitet zbatimi i rekomandimeve si më poshtë:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Bashkia Berat *ka respektuar* këtë afat, duke kthyer përgjigje sipas shkresës me nr.975 prot., datë 12.02.2026, planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Sa më sipër Bashkia Berat është brenda afatit 6-mujor dhe në këto kushte nuk mund të shprehemi për zbatimin ose moszbatimin e këtij detyrimi.

III. Rekomandimet e KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me Nr. 6262/1 prot., datë 12.02.2026, janë rekomanduar gjithsej 34 rekomandime:

a. Janë rekomanduar **20 masa organizative**;

c. Janë rekomanduar **2 masa për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia;**

d. Janë rekomanduar **1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet;**
e. Janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Berat që të shqyrtojë raportin përfundimtar të auditimit dhe ti kërkojë komisionit vendosjen e **masave disiplinore për 4 punonjës** të cilat janë trajtuar në raportin përfundimtar.

IV. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me Nr. 975 Prot., datë 12.02.2026, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si me poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar (Bashkia Berat)	Pa pranuar
1	Organizative	20 masa	20 masa	-
2	Për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia	2 masa	2 masa	-
3	Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike	1 masë	1 masë	
4	Masa Disiplinore	4 masa	4 masa	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e subjektit

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	20 masa	15 masa	-	5 masë	-
2	Për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia	2 masa	-	-	1 masë	1 masë
3	Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike	1 masë	-	-	-	1 masë
4	Masa Disiplinore	4 masa	-	-	-	4 masë

Konkluzion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:
Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi se:
Nga 24 (Njëzet e katër) rekomandime të dhëna për t'u zbatuar nga Bashkia Berat, niveli i zbatimit paraqitet si më poshtë vijon:
- 20 (njëzet) rekomandime organizative janë pranuar plotësisht, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 15 (pesëmbëdhjetë) prej tyre dhe në proces zbatimi janë 5 (pesë) masa;
- 2 (dy) masa për uljen e borxhit tatimor janë pranuar plotësisht nga të cilat 1 (një) masë në proces zbatimi dhe 1 (një) masë pa zbatuar.
- 1 (një) masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të tyre, të ardhurat e munguara, nuk është zbatuar e cila do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual;
- 1 (një) masë disiplinore ndaj 4 punonjësve, nuk është zbatuar.

A. <u>MASA ORGANIZATIVE</u>

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua që mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike, në Bashkinë Berat, mbahet në mënyrë manuale duke përdorur programi Excel, e cila ka risk të lartë për sa i përket sigurisë në saktësinë e informacionit

që gjenerohet nga ky sistemi për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave kontabël të njësisë dhe njësive të vartësisë. Programi Excel nuk përbën një "bartës informatik" të specializuar, i cili të garantojë mos manipulimin e të dhënave, si dhe mundësinë e gjenerimit dhe printimit të informacionit në çdo kohë.

Veprimet e kryera në këtë mënyrë ndikojnë në mos besueshmërinë dhe riskun që bartin në vetvete këto programe duke qenë të ndryshueshme në çdo kohë, të cilat gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekte. Kjo gjë çon dhe në mos kuadrim të drejtë dhe të saktë si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare si dhe në ruajtjen e gjurmës së auditimit, Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 6/d, neni 12/dh. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2 faqe 19-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa që mbajtja e kontabilitetit në Bashkinë Berat dhe njësitë e varësisë të kryhet nëpërmjet programeve financiare të autorizuara të pa manipulueshme, në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare si dhe në ruajtjen e gjurmës së auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezultoi se Bashkia Berat aktualisht përdor sistemin financiar të autorizuar Alpha Ëeb, nëpërmjet të cilit realizohet regjistrimi dhe administrimi i transaksioneve financiare dhe kontabël

Zbatimi: Rekomandimi 1.1 **është zbatuar**

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me vlerësimin, seleksionimin e kryer, gjendjen e aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit dhe proces verbalin e asgjësimit të inventarëve të nxjerra jashtë përdorimit të Bashkisë Berat (qendër) u konstatua që procesi është kryer me shkresë të pa protokolluar në zyrën e protokoll arkivës. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 "*Për arkivat*", neni 15, neni 22 si dhe në kundërshtim te elementeve të përcaktuara ligjërisht në nenet 11-20 të "*Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*". *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 17-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa për ruajtjen e gjurmës së auditimit në procesin e protokollimit të proces verbaleve në lidhje me vlerësimin dhe gjendjen e aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit dhe proces verbaleve të asgjësimit të inventarëve të nxjerra jashtë përdorimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, sqarojmë se Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka zbatuar te gjitha procedurat e përcaktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi për administrimin e aktiveve. Procesverbalet e komisioneve për vlerësimin e gjendjes së aktiveve, si dhe dokumentacioni shoqërues për nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit, për periudhen 2025, është hartuar, administruar dhe protokolluar sipas rregullave të administrimit të dokumentacionit zyrtar, duke siguruar identifikimin e datës, numrit të protokollit, strukturës përgjegjëse dhe personave që kanë marrë pjesë në proces.

Zbatimi: Rekomandimi 2.1 **është zbatuar**

3. Gjetje nga auditimi: Llogaria (520) "*Disponibilitete në thesar*" paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar të bilancit të konsoliduar në fund të vitit 2024 në shumën 300,621,128 lekë.
Sipas akt rakordimit me thesarin të ardhurat e trashëguara për vitin 2025 për Bashkinë qendër Berat janë 169,848,326 lekë. Nga akt rakordimi me thesarin për Bashkinë qendër Berat për llogarinë 466 *"Kreditore për mjete në ruajtje"* rezulton në ketë llogari në fund të vitit 2024 vlera prej 128,161,802 lekë dhe llogaria sponsorizime 1,416,002 lekë. Totali i të Ardhurave të trashëguara plus llogaria 466 *"Kreditore për mjete ne ruajtje"* dhe sponsorizime gjendje është 299,426,130 lekë.
Nga auditimi i të dhënave të paraqitura konstatohet që ka mos rakordim të llogarisë 520 "*Disponibilitete në thesar*" për vlerën 1,194,998 lekë (300,621,128 lekë - 299,426,130 lekë. Nga ana e Drejtorisë se Financës dhe Buxhetit Bashkia Berat nuk u paraqiten të dhëna në lidhje me rakordimin e llogarisë 520 "*Disponibilitete në thesar*" me Degën e thesarit Berat për të gjitha njësitë e varësisë, duke mos dhënë siguri për saktësinë e paraqitjes së kësaj llogarie në pasqyrat financiare të konsoliduar.
Këto veprime janë në papajtueshmëri me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i ndryshuar, neni 22, pika 3, germa "dh" dhe në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar pika 50. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2 faqe 19-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa të saktësojë mospërputhjen e llogarisë 520 *"Disponibilitete në thesar"* për vlerën 1,416,002 lekë, duke pasqyruar saktë vlerat e saj në llogaritë kontabël dhe pasqyrën e pozicionit financiar.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezultoi se raportimi financiar është kryer në mënyrë plotësisht të saktë dhe në përputhje me ligjin. Mospërputhja e pretenduar prej 1,194,998 lekë nuk është gabim kontabël, por ju paraqesim tabelën si më poshtë (individual vs. i konsoliduar)

	Bashkia Qender	**Drejtoria e Arsimit**	**Agjencia e Sherbimeve Publike**	**Drejtoria e Bujqesise**	**520**
Te ardhurat e trasheguara	168,432,325				
Sponsorizimet	1,416,002				
Llogaria 466	128,161,802	1,904,533	351,092	355,374	
Totali	**298,010,129**	**1,904,533**	**351,092**	**355,374**	**300,621,128**

Identifikimi i gabimit: Vlera 1,416,002 lekë nuk është diferencë, por është **gjendja e llogarisë së sponsorizimeve**, e cila është tashmë e përfshirë brenda shumës së rakorduar prej 298,010129 lekë.
1. Akt-rakordimet individuale me Degën e Thesarit Berat për **të gjitha njësitë e varësisë** për vitin 2024.
2. Tabela përmbledhëse (Pasqyra Rekonstruktive) e konsolidimit të llogarisë 520, ku vërtetohet se: *Bashkia Qendër (298,010,129 lekë) + Njësitë e Varësisë (2,621,128 lekë) = Totali i Bilancit (300,621,128 lekë).*

Zbatimi: Rekomandimi 3.1 **është zbatuar**

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar të bilancit të konsoliduar u konstatua se llogaria 4342 "*Operacione me shtetin (të drejta)*" paraqitet në fund të vitit 2024 në vlerën 75,156,906 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi mospërputhje me shumën e kredituar të llogarive përkatëse (401–408, 42, 431, 435, 436, 437, 467, 464), duke rezultuar një diferencë prej 68,645,239 lekë (143,802,145 lekë – 75,156,906 lekë). Gjithashtu, u konstatua se gjendja e llogarisë 4342 në pasqyrën e pozicionit financiar të konsoliduar nuk është në përputhje me

llogarinë 7206 *"Financim i pritshëm nga buxheti"* të Pasqyrës së Performancës Financiare, e cila paraqitet në vlerën 75,039,876 lekë. Diferenca prej 117,030 lekë evidentohet në pasqyrat financiare të Bashkisë (qendër).
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i ndryshuar ,neni 22, pika 3, germa "dh", Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme",* i ndryshuar Kreu III. i ndryshuar, pika 32 si dhe pika 3.2 nënpika 59. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2 faqe 23-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa të saktësojë mospërputhjen e llogarisë 4342 *"Operacione me shtetin të drejta"* për vlerën 68,645,239 lekë duke pasqyruar saktë vlerat e saj në llogaritë kontabël dhe pasqyrën e pozicionit financiar.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezultoi se në vitin 2025 është kryer analiza dhe rakordimi i plotë i kësaj llogarie me llogaritë përkatëse kundërparti dhe dokumentacionin mbështetës.

Zbatimi: Rekomandimi 4.1 **është zbatuar**

4.2. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa të saktësojë pasqyrimin e llogarisë 4342 *''Operacione me shtetin të drejta'* në kundër parti të llogarisë 7206 *"Financim i pritshëm nga buxheti"* lekë duke pasqyruar saktë vlerat e saj në llogaritë kontabël dhe pasqyrën e pozicionit financiar.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezultoi se Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka kryer saktësimin e plotë të llogarisë 4342 ''Operacione me shtetin të drejta'' me llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" gjatë vitit ushtrimor 2025. Pas verifikimit dhe rakordimit të të gjitha transaksioneve, janë kryer rregullimet e nevojshme në librat kontabël, duke bërë të mundur që vlerat e këtyre llogarive të pasqyrohen me saktësi në Pasqyrën e Pozicionit Financiar dhe në të gjitha raportet zyrtare të kësaj periudhe.

Zbatimi: Rekomandimi 4.2 **është zbatuar**

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës së pozicionit financiar sipas njësive shpenzuese me të dhënat e llogarive të pozicionit financiar sipas thesarit u konstatua që llogaria 486 *"Shpenzime të periudhave të ardhshme"* sipas pasqyrës së pozicionit financiar të bilancit të konsoliduar rezulton me vlerë 66,204,480 lekë, ndërsa sipas të dhënave të thesarit *"Pasqyra e gjeneruar nga SIFQ"* është në vlerën zero lekë ose është pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar më shumë se thesari në vlerën prej 66,204,480 lekë. Vlera prej 66,204,480 lekë e pasqyruar më shumë se thesari "*Pasqyra e gjeneruar nga SIFQ"* konstatohet në pasqyrën e pozicionit financiar të Bashkisë qendër Berat në vlerën 65,217,230 lekë dhe në Drejtorinë e Arsimit në vlerën 987,350 lekë. Llogaria 486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme"* është pasqyruar gabim në ketë pozicion të pasqyrës financiare pasi në ketë llogari duhet të paraqiten vetëm shpenzimet e parapaguara ndërkohë që vlera prej 66,204,480 lekë ka kundër parti llogarinë 467 *"Kreditore te ndryshëm".* Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i ndryshuar, neni 22, pika 3, germa "dh", udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit*

të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2 , faqe 24-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa të saktësojë mospërputhjen me vlerë 66,204,480 lekë të llogarisë 486 *"Shpenzime të periudhave të ardhshme"* sipas pasqyrës së pozicionit financiar të bilancit të konsoliduar me të dhënat e pasqyrës së pozicionit financiar sipas thesarit si dhe të marrë masa që në ketë llogari të pasqyroje vetëm shpenzimet e parapaguara.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezultoi se vlera prej 66,204,480 lekë përfaqëson detyrime të prapambetura të institucionit, të evidentuara mbi bazën e faturave të papaguara që kanë kaluar afatin 60-ditor të pagesës dhe që rakordohen periodikisht me Degën e Thesarit. Këto vlera janë pasqyruar në evidencat kontabël me qëllim monitorimin dhe raportimin e detyrimeve të prapambetura, bazuar në dokumentacionin justifikues dhe akt-rakordimet përkatëse. Për rrjedhojë, diferenca ndërmjet pasqyrave financiare të institucionit dhe të dhënave të gjeneruara nga sistemi SIFQ lidhet me mënyrën e evidentimit dhe raportimit të këtyre detyrimeve në evidencat kontabël të Bashkisë. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka analizuar rekomandimin dhe vlerëson se vlerat e pasqyruara në këtë llogari mbështeten në detyrime reale, të dokumentuara dhe të rakorduara me Thesarin. Për rrjedhojë, trajtimi kontabël i ndjekur deri më sot është konsideruar i nevojshëm për evidentimin dhe ndjekjen e detyrimeve të prapambetura të institucionit deri në një orientim ose unifikim të mëtejshëm të praktikës nga organet kompetente.

Zbatimi: Rekomandimi 5.1 **është zbatuar**

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës së pozicionit financiar të bilancit të konsoliduar u konstatua që për 59 projekte, në vlerën 85,469,521 lekë (kosto historike) që janë të përfshirë në llogarinë 202 "*Studime dhe kërkime"*, nuk ka informacion të saktë se cilit investim i përkasin dhe nëse këto investime janë kryer apo jo. Nuk ka informacion nëse kanë përfunduar investimet përkatëse sipas këtyre projekteve. Kjo ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave te llogarisë 202 "*Studime dhe kërkime"* si dhe të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Veprime këto në kundërshtim me; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75, dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar, Kreu II Aneksi 1 pika 2, klasa 2, dhe pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2 faqe 25-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa të identifikojë, 59 projektet në vlerën 85,469,521 lekë, se cilit investim i përkasin dhe nëse këto investime janë kryer apo jo. Për projektet e përfunduara, të marrë masa për kapitalizimin e tyre në llogaritë përkatëse të aktiveve.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezultoi se jo të gjitha projektet përbëjnë domosdoshmërisht investime kapitale që plotësojnë kriteret për t'u njohur si aktive afatgjata dhe për t'u futur në kontabilitet. Një pjesë e tyre përfaqësojnë studime, projektime, preventive, ekspertiza ose dokumentacione teknike të

hartuara për qëllime planifikimi, të cilat nuk janë shoqëruar me realizimin e investimit përkatës. Për rrjedhojë, në mungesë të realizimit të investimit ose të përfitimeve ekonomike/shërbimore të ardhshme që burojnë prej tyre, këto projekte nuk përmbushin kushtet për t'u kapitalizuar në llogaritë e aktiveve afatgjata. Kontabilizimi mund të kryhet vetëm për ato projekte që lidhen drejtpërdrejt me investime të realizuara ose që plotësojnë kriteret e njohjes si aktiv sipas kuadrit ligjor dhe standardeve kontabël në fuqi. Konkretisht ne vitin 2025 eshte kontabilizuar Oponenca Teknike "Rruga Antipatrea Kryqezimi i spitalit rajonal kryqezimi Bypass".

Zbatimi: Rekomandimi 6.1 **është zbatuar**

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi saktësinë e Llogarisë 210 "*Toka, troje terrene*" dhe llogarisë 212*"Ndërtime e konstruksione"*, rezultoi se këto llogari nuk paraqesin një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2024, pasi mungojnë analizat për to, nuk janë hedhur në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të trojeve nën objekt për ndërtesat e shkollave zyrave në Njësitë Administrative etj. Bashkia Berat ka evidentuar një numër të konsiderueshëm objektesh në proces verifikimi për regjistrim, të cilat i përkasin ish-komunave. Këto objekte nuk janë të shoqëruara me kartelat përkatëse, nuk janë përfshirë në kontabilitet, nuk është kryer saktësimi i tyre, dokumentimi me kartelë, inventarizimi fizik, si dhe rivlerësimi sipas normave për secilin objekt. Sipas SMPS, Bashkia (qendër) administron 74 objekte ndërtesash dhe konstruksionesh me truall 135,210 m², nga të cilat vetëm për 26 objekte (53,621 m²) disponohet dokumentacion pronësie, ndërsa për 48 objekte (81,589 m²) nuk ka asnjë dokument. Gjithashtu në Llogarinë 211 *"Pyje, kullota, plantacione"* nuk është pasqyruar sipërfaqja prej 5,541 ha e pyjeve, djerrës, kullotave, bimësisë pyjore dhe veprave ujore të kaluara me VKM. Mungon dokumentacioni pronësor dhe nuk është kryer verifikimi fizik për vitin 2024.*(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 26-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin e pronave të Bashkisë Berat të kaluara me VKM për llogarinë (210) "*Toka, troje terrene*", për llogarinë 211 "*Pyje Plantacione*" dhe për llogarinë 212 *"Ndërtime e konstruksione"* mbi gjendjen fizike, për hartimin e regjistrit fizik të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar, për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Në lidhje me rekomandimin për marrjen e masave për verifikimin në terren dhe përditësimin e statusit të aseteve në administrim të Bashkisë Berat, ju informojmë se Bashkia ka ndërmarrë hapat e nevojshëm në këtë drejtim. Me Urdhërin e Brendshëm me nr. 388 prot datë 27.04.2026 të Kryetarit të Bashkisë Berat "Për verifikimin dhe përditësimin e aseteve në bashkinë Berat", është ngritur grupi i punës për verifikimin në terren të situatës faktike të aseteve që bashkia Berat ka në administrim së bashku me njësitë administrative. Ky proces paraqet edhe një sërë vështirësish praktike, të lidhura kryesisht me procedurat e regjistrimit të pronave pranë Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të cilat shpesh rezultojnë të zgjatura në kohë dhe të shoqëruara me kërkesa të detajuara dokumentacioni. Gjithashtu, një ndikim të konsiderueshëm paraqet edhe kostoja e lartë financiare për regjistrimin dhe përditësimin e pasurive, veçanërisht për një numër të madh asetesh në administrim.

Zbatimi: Rekomandimi 7.1 **është në proces zbatimi**

8. Gjetje nga auditimi: Llogaria 213 *" Rruge, rrjete, vepra ujore"* paraqitet në fund të vitit 2024 në vlerën 1,131,945,985 lekë. Nga auditimi u konstatua që në këtë vlerë përfshihet vlera prej 155,965,659 lekë për 8 objekte për ujësjellës-kanalizime, që duheshin transferuar në *"Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat Sha"* me NIPT M23.

- Nga auditimi i dokumentacionit dhe nga informacioni kontabël u konstatua se nga totali i llogarisë **"***Rrugë rrjete vepra ujore***"** që rezulton 1,131,945,985 lekë, vlera 135,931,670 lekë është e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Mungesa e analizës ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

Veprime këto në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 *"Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura"* kreu II pika 14, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme"* i ndryshuar, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 29-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masat për kryerjen e veprimeve kontabël në lidhje me zbritjen e vlerës për 8 objekte për ujësjellës-kanalizimeve në shumën 155,965,659 lekë, nga llogaritë e klasës 2 të AAMGJ.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezultoi se janë ndërmarrë veprimet për verifikimin e dokumentacionit teknik, juridik dhe kontabël që lidhet me këto aktive dhe eshte kryer procesi i transferimit në shumën 750,335,825 lekë (149,263,733 për vitin 2024 dhe 601,072,092 për vitin 2025) nga llogaritë e klasës 2 të Aktiveve Afatgjata Materiale të Qëndrueshme. Megjithatë, procesi nuk ka përfunduar plotësisht për dy (2) aktive, për të cilat nuk ka qenë e mundur të sigurohet i gjithë informacioni teknik i nevojshëm për identifikimin dhe dokumentimin e plotë të tyre. Kjo situatë lidhet me faktin se këto aktive janë krijuar dhe regjistruar shumë vite më parë, ndërsa dokumentacioni teknik shoqërues rezulton i paplotë ose i munguar në arkivat administrative. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, po vijon verifikimet dhe kërkimet për sigurimin e informacionit teknik të nevojshëm, me qëllim përfundimin e procesit të transferimit dhe plotësimin e dokumentacionit përkatës, duke garantuar ruajtjen e gjurmës së auditimit dhe administrimin korrekt të aktiveve.

Zbatimi: Rekomandimi 8.1 **është në proces zbatimi**

8.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin e pronave të Bashkisë për llogarinë 213 *"Rruge, rrjete, vepra ujore"*, mbi gjendjen fizike për hartimin e regjistrit fizik të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Në lidhje me rekomandimin për marrjen e masave për verifikimin në terren dhe përditësimin e statusit të aseteve në administrim të Bashkisë Berat, ju informojmë se Bashkia ka ndërmarrë hapat e nevojshëm në këtë drejtim. Me Urdhërin e Brendshëm me nr. 388 prot datë 27.04.2026 të Kryetarit të Bashkisë Berat "Për verifikimin dhe

përditësimin e aseteve në bashkinë Berat", është ngritur grupi i punës për verifikimin në terren të situatës faktike të aseteve që bashkia Berat ka në administrim së bashku me njësitë administrative. Ky proces paraqet edhe një sërë vështirësish praktike, të lidhura kryesisht me procedurat e regjistrimit të pronave pranë Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të cilat shpesh rezultojnë të zgjatura në kohë dhe të shoqëruara me kërkesa të detajuara dokumentacioni. Gjithashtu, një ndikim të konsiderueshëm paraqet edhe kostoja e lartë financiare për regjistrimin dhe përditësimin e pasurive, veçanërisht për një numër të madh asetesh në administrim.

Zbatimi: Rekomandimi 8.2 **është në proces zbatimi**

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontabilizimit të llogarisë *26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta"* u konstatua që në pasqyrën e pozicionit financiare të konsoliduar, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 60,091,462 lekë në fund te vitit 2024.

Nga të dhënat shkresore të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në lidhje me kontabilizimin e llogarisë 26*''Pjesmarrje ne kapitalin e vet ''* u konstatua se*:*

Bashkia Berat është aksionare me 23,01 % të aksioneve ose në vlerë kapitali 2,301,000 lekë (10,000,000*23,01%) në Shoqërinë e re të krijuar *''Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat Sha''* me NIPT M23.

Bashkia Berat është aksionare 100% ne shoqërinë "*B. G*" sha me NIPT K83 dhe vlera e kapitalit të Bashkisë Berat në këtë shoqëri është në vlerën 55,790,462 lekë.

Bashkia Berat është aksionare 100% në shoqërinë *''F. T''* sha me NIPT L13 dhe vlera e kapitalit në këtë shoqëri është 2,000,000 lekë.

Nga auditimi konstatohet që Drejtoria e financës dhe Buxhetit e Bashkisë Berat ka pasqyruar në aktive pjesëmarrjen në kapital ne këto tre shoqëri dhe total në pasqyrën e pozicionit financiar të konsoliduar është paraqitur vlera 60,091,462 lekë (2,301,000+55,790,462+2,000,000). Nga kryqëzimi i të dhënave të pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Berat me të dhënat e llogarive të pozicionit financiar sipas thesarit *"Pasqyra e gjeneruar nga SIFQ"* u konstatua që llogaria 26*''Pjesmarrje ne kapitalin e vet''* sipas të dhënave të thesarit është në vlerën zero lekë me një diference prej 60,091,462 lekë e pasqyruar më shumë se thesari në pasqyrat e pozicionit financiar.

Vlera prej 60,091,462 lekë e pasqyruar më shumë se thesari konstatohet në pasqyrën e pozicionit financiar të Bashkisë(qendër) Berat.

Bashkia Berat vazhdon të jetë aksionare e "*F. T* '' sha me NIPT L13 me vlerë kapitali 2,000,000 lekë dhe është pjesëmarrëse 100% e kapitalit të kësaj shoqërie megjithëse duhet të kishte nxjerre në shitje aksionet e kësaj kompanie sipas përcaktimit të nenit 8 të Ligjit nr. 105/2020 *"Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 79/2017 "Për Sportin"*, i ndryshuar neni 22. Veprimet janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2 , faqe 31-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa të saktësojë mospërputhjen me vlerë 60,091,462 lekë të llogarisë *26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta"* sipas pasqyrës së pozicionit financiar të bilancit të konsoliduar me të dhënat e pasqyrës se pozicionit financiar sipas thesarit. Të merren masa për saktësimin e procedurës së pjesëmarrjes në kapital të shoqërisë *"F.T''* sha me NIPT L132.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezultoi se kjo vlerë përfaqëson pjesëmarrjen e Bashkisë Berat në kapitalin aksionar të shoqërive tregtare, konkretisht: Shoqëria "Sh. R." sh.a., në vlerën 2,301,000 lekë; Shoqëria "B. C." sh.a., në vlerën 55,790,462 lekë; Shoqëria "F" sh.a., në vlerën 2,000,000 lekë.
Këto vlera janë pasqyruar në pasqyrat financiare të Bashkisë Berat mbi bazën e dokumentacionit ligjor dhe financiar që vërteton pjesëmarrjen në kapitalin aksionar të shoqërive përkatëse dhe për rrjedhojë, përbëjnë aktive financiare të Bashkisë. Diferenca e konstatuar ndërmjet Pasqyrës së Pozicionit Financiar të konsoliduar dhe pasqyrës së gjeneruar nga sistemi i Thesarit (SIFQ) lidhet me faktin se pjesëmarrjet në kapital nuk gjenerohen automatikisht nga raportet standarde të sistemit të thesarit, pasi ato nuk burojnë nga transaksione të ekzekutimit buxhetor, por nga të drejta pronësie të Bashkisë mbi kapitalin aksionar të shoqërive tregtare. Për këtë arsye, këto vlera evidentohen dhe raportohen në pasqyrat financiare të institucionit mbi bazën e evidencave kontabël dhe dokumentacionit mbështetës.

Zbatimi: Rekomandimi 9.1 **është zbatuar**

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të realizimeve faktike të buxhetit për vitin 2024 për llogarinë 230-231 *"Investime"* sipas thesarit rezultojnë në vlerën prej 460,566,870 lekë, ndërsa vlera debitore e llogarisë 230-231*"Investime"* sipas pasqyrës statistikore Formati nr.6 "*Investimet*" për vitin 2024 është në vlerën 446,824,783 lekë ose me një diference të pasqyruar më pak në pasqyrën Formati nr.6 *"Investimet"* për vlerën prej 13,742,087 lekë (460,566,870-446,824,783).
Për vitin 2024 ka pasur kapitalizime të investimeve në aktive në vlerën 119,352,831 lekë. Në mbyllje të pasqyrave financiare më 31.12.2024, llogaria 230 "*Investime për aktive afatgjata jo materiale"* paraqiten në vlerën zero lekë dhe llogaria 231 "*Investime për aktive afatgjata materiale"* në vlerën 2,514,688,876 lekë, e cila nuk kuadron me totalin e llogarive (115+105+106) në vlerën prej 2,638,188,722 lekë. Saktësisht, llogaria 115 "*Nga fondet e veta të investimeve*" paraqitet në vlerën 416,724,691 lekë, llogaria 105 "*Teprica e grandeve kapitale të brendshme*" paraqitet në vlerën 1,950,016,193 lekë dhe llogaria 106 "*Teprica e granteve kapitale, të huaja*" në vlerën 271,447,838 lekë. Nga auditimi rezultoi se llogaria 231*"Investime për aktive afatgjata materiale"* është nënvlerësuar në vlerën 123,499,846 lekë (2,638,188,722 – 2,514,688,876), si pasojë e moskryerjes së saktë të veprimeve të kontabilizimit për llogaritë më sipër, e cila ka sjellë që investimet për aktive afatgjata materiale të pasqyrohen me vlerë të ulët në pasqyrën e pozicionit financiar.
Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar, Aneksi 1, germa "c", dhe "b". (*Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 33-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa të saktësojë mospërputhjen me vlerë prej 123,499,846 lekë që rezulton midis totalit të llogarive 115 "*Nga fondet e veta të investimeve*" 105 "*Teprica e grandeve kapitale të brendshme*" , 106 "*Teprica e Granteve kapitale, Të Huaja*" dhe vlerës së pasqyruar në llogarinë 231 "*Investime për aktive afatgjata materiale"* në pasqyrën e pozicionit financiar të pasqyrave financiare të konsoliduar.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezultoi se gjatë hartimit të PF 2025 është kryer analiza e detajuar dhe rakordimi i të gjitha llogarive të përfshira në këtë proces. Si rezultat, mospërputhja e konstatuar është trajtuar

dhe sistemuar në pasqyrat financiare të vitit 2025, duke siguruar rakordimin e llogarive 115, 105 dhe 106 me llogarinë 231 "Investime për aktive afatgjata materiale" dhe paraqitjen e drejtë të tyre në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.

Zbatimi: Rekomandimi 10.1 **është zbatuar**

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të kontabilitetit për llogarinë 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*" rezultoi se kjo llogari është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të vitit 2024 në vlerën prej 130,772,801 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave. Për sa më sipër fonde që u përkasin objekteve të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Berat janë në 146 raste në vlerën 102,230,772 lekë. Fondet gjenden të ngurtësuara në Degën e Thesarit Berat dhe i përkasin periudhave të mëparshme të trashëguara nga ish komunat dhe në vazhdim, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave nuk janë marrë masa për te njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 102,230,772 lekë. Veprimet janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar, pika 3.2 "*Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)*" kreu Llogaria 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje"* dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar, Kapitulli II, pika 6.
(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 37-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa që të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin garancive të mbajtura që u përkasin objekteve të përfunduara dhe të marra në dorëzim, në 146 raste në vlerën 102,230,772 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezultoi se Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, ka kryer ndër vite njoftime të vazhdueshme ndaj subjekteve përkatëse për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe ndjekjen e procedurave për shlyerjen e detyrimeve që lidhen me garancitë e mbajtura. Njoftimet janë kryer në mënyrë periodike, në përputhje me dokumentacionin dhe të dhënat e disponuara nga institucioni, duke u kërkuar subjekteve të paraqesin dokumentacionin përkatës që vërteton plotësimin e kushteve për lirimin dhe likuidimin e garancive të kontratave të përfunduara dhe të marra në dorëzim. Për rastet kur subjektet kanë paraqitur dokumentacionin e kërkuar dhe kanë përmbushur kushtet ligjore e kontraktuale, janë kryer procedurat përkatëse për shlyerjen e detyrimeve. Ndërkohë, për rastet e mbetura, institucioni vijon të mbajë komunikim dhe të ndjekë procedurat administrative përkatëse deri në plotësimin e dokumentacionit dhe përfundimin e procesit të likuidimit të garancive.

Zbatimi: Rekomandimi 11.1 **është në proces zbatimi**

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 467 "*Kreditorë të ndryshëm*" sipas te dhënave të kontabilitetit u konstatua se, në këtë llogari janë klasifikuar detyrimet e prapambetura ndaj të treteve në vlerën 74,843,769 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie u konstatua se në 11 raste janë klasifikuar detyrime të prapambetura ndaj te treteve që i përkasin viteve 2017, 2019, 2022 dhe 2023 në vlerën 65,375,559 lekë të cilat duhet të ishin likuiduar sipas planit te likuidimit.

Mos likuidimi i detyrimeve ndaj të tretëve në afatin e përcaktuar në ligj, në Bashkinë Berat, ka shkaktuar mbartjen nga vitet e kaluara të këtyre detyrimeve financiare duke rritur riskun e ekspozimit të bashkisë ndaj proceseve gjyqësore. Këto problematika konstatohet se nuk respektojnë parimin e kryerjes së pagesës sipas parimit hyrje e parë dalje e parë.
Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar neni 52, me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, pikat 153-172, Udhëzimin e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr. 5, datë 27.12.2014 "*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura",* pikat 27-30. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2 faqe 38-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në Bashkinë Berat të marrë masa që të kryejë likuidimet e detyrimeve të prapambetura që kanë rezultuar në fund të vitit 2024, duke respektuar radhën e kryerjes së pagesave.

Brenda vitit 2026

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Në lidhje me rekomandimin për menaxhimin dhe prioritarizimin e detyrimeve të prapambetura, Bashkia Berat sqaron se struktura e detyrimeve të raportuara në fund të vitit 2024 është e përbërë nga kategori me natyrë të ndryshme financiare dhe ligjore, të cilat nuk reflektojnë një situatë homogjene të mungesës së likuiditetit. Në stokun e detyrimeve perfshihen 987,360 lekë detyrime për mallra, për blerje ushqime për kopshte dhe cerdhe, të vitit 2019. Bashkia është në proces gjyqësor me operatorin "M" ShPK, për mosrespektim kontrate. Gjithashtu përfshihen 15,742,863 lekë detyrime për investime në vitet 2017-2019 të cilat nuk janë marrë në dorëzim përfundimtar pasi nuk janë kryer punimet sipas kontratës. Për rrjedhojë, këto detyrime nuk janë të likuidueshme në gjendjen aktuale, deri në përmbylljen e procedurave të marrjes në dorëzim dhe plotësimin e dokumentacionit final teknik dhe ligjor.
Ndërkohë, rritja e detyrimeve gjatë vitit 2024 në vlerën 48,487 mijë lekë lidhet kryesisht me një detyrim të krijuar nga një vendim gjyqësor për shpronësim objekti, i cili përbën detyrim të njohur ligjor për bashkinë tonë dhe i cili nuk ka natyrën e angazhimeve të krijuara nga procedurat e zakonshme të shpenzimeve buxhetore. Bashkia Berat ka vlerësuar që likuidimi i këtij detyrimi të realizohet në mënyrë të programuar brenda një periudhe 3-vjeçare, në përputhje me kapacitetet buxhetore dhe parimet e qëndrueshmërisë fiskale.

Zbatimi: Rekomandimi 12.1 **është në proces zbatimi**

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës së pozicionit financiar duke krahasuar pasqyrat individuale të Bashkisë dhe njësive të varësisë me llogaritë sipas thesarit *"Pasqyra e gjeneruar nga SIFQ"* u konstatua se, llogaria 470 *''Llogari në pritje- të ardhura për t'u marrë''* sipas të dhënave të thesarit është në vlerën 326,183,562 lekë, ndërsa sipas pasqyrës së pozicionit financiar të bilancit të konsoliduar rezulton në vlerën 439,542,345 lekë ose me një diference prej 113,358,783 lekë e regjistruar më shumë në pasqyrat e pozicionit financiar sesa në të dhënat e thesarit. Vlera prej 113,358,783 lekë e pasqyruar më shumë se thesari konstatohet në pasqyrën e pozicionit financiar të Bashkisë qendër Berat. Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave nuk ka marrë masa për të rakorduar llogarinë kontabël të kësaj llogarie, të pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar, me të dhënat e regjistruara në thesar.
Veprime në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i ndryshuar ,neni 22, pika 3, germa "dh"; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39. *(Më hollësisht trajtuar*

në nënpikën III.2 faqe 39-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa të saktësojë mospërputhjen e vlerës prej 113,358,783 lekë të llogarisë 470 *''Llogari në pritje- të ardhura për t'u marrë''* sipas pasqyrës së pozicionit financiar të bilancit të konsoliduar krahasuar me të dhënat e pasqyrës së pozicionit financiar sipas thesarit.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezultoi se kjo vlerë përfaqëson të ardhura të konstatuara dhe të evidentuara në kontabilitet si të drejta të arkëtueshme të Bashkisë. Mospërputhja me të dhënat e gjeneruara nga sistemi SIFQ lidhet me faktin se këto të ardhura nuk janë arkëtuar ende dhe për rrjedhojë nuk pasqyrohen në raportet standarde të Thesarit, të cilat bazohen kryesisht në transaksionet financiare të realizuara. Për këtë arsye, vlera e llogarisë 470 evidentohet në pasqyrat financiare të Bashkisë, por nuk gjenerohet automatikisht nga sistemi SIFQ.

Zbatimi: Rekomandimi 13.1 **është zbatuar**

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës së pozicionit financiar sipas pasqyrave individuale të Bashkisë dhe njësive të varësisë me të dhënat e llogarive të pozicionit financiar sipas thesarit u konstatua që llogaria 16,17,18*''Huate Afat Gjata''* sipas të dhënave të thesarit *"Pasqyra e gjeneruar nga SIFQ"* është në vlerën zero lekë, ndërsa sipas pasqyrës së pozicionit financiar të bilancit të konsoliduar rezulton me vlerë 4,205,734 lekë ose me një diference prej 4,205,734 lekë e regjistruar në pasqyrat e pozicionit financiar më shume se thesari. Vlera prej 4,205,734 lekë e pasqyruar më shumë se thesari konstatohet në pasqyrën e pozicionit financiar të Bashkisë qendër Berat. Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave nuk ka marre masa për të rakorduar llogaritë kontabël të këtyre llogarive, të pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar, me të dhënat e regjistruara në thesar.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i ndryshuar ,neni 22, pika 3, germa "dh"; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2 , faqe 40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa të saktësojë mospërputhjen në vlerën prej 4,205,734 lekë të llogarisë 16,17,18*''Huate Afat Gjata''* sipas pasqyrës së pozicionit financiar të bilancit të konsoliduar krahasuar me të dhënat e pasqyrës së pozicionit financiar sipas thesarit.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezultoi se kjo vlerë përfaqëson detyrime afatgjata të evidentuara në kontabilitetin e Bashkisë mbi bazën e dokumentacionit financiar dhe kontraktual përkatës. Mospërputhja me të dhënat e gjeneruara nga sistemi SIFQ lidhet me faktin se detyrimet afatgjata nuk pasqyrohen gjithmonë në raportet standarde të Thesarit në të njëjtën mënyrë si në pasqyrat financiare të institucionit. Për rrjedhojë, vlera e huave afatgjata evidentohet në pasqyrat financiare të Bashkisë bazuar në evidencat kontabël dhe dokumentacionin mbështetës, ndërsa nuk gjenerohet automatikisht në të njëjtën formë nga sistemi SIFQ.

Zbatimi: Rekomandimi 14.1 **është zbatuar**

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar të bilancit të konsoliduar

u konstatua që çelja e llogarisë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 3,469,751,402 lekë dhe në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 3,171,164,116 lekë. Llogaria 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* kreditohet për shtesat e vitit sipas pasqyrës nr. 7/b *"Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)"* në vlerën 182,054,066 lekë, kreditohet për amortizimin e pakësimit të aktiveve në vlerën 20,161,708 lekë dhe kreditohet për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 901,324 lekë sipas llogarisë 63 *"Ndryshimi i gjendjes së inventarit".*
Llogaria 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* debitohet për pakësimet e aktiveve të vitit në vlerën 40,036,294 lekë dhe debitohet për amortizimin shtesë të vitit 2024 në vlerën 198,197,904 lekë.
Llogaria 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* është paraqitur në vlerën 3,171,164,116 lekë në fund të vitit 2024 dhe duhej të paraqitej në vlerën 3,249,874,264 lekë ose është paraqitur 78,710,148 lekë më pak (3,286,794,012 + 182,054,066 - 901,324 + 20,161,708 - 40,036,294 - 198,197,904 - 3,171,164,116). Llogaria 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* është nënvlerësuar për vlerën 78,710,148 lekë.
Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar Kreu II ''Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme'' pika 17. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 40-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
15.1. Rekomandim: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave e Bashkisë Berat të marrë masa që të saktësojë llogarinë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* e cila është nënvlerësuar për vlerën 78,710,148 lekë në fund të vitit 2024.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezultoi se gjatë ushtrimit financiar 2025 janë kryer verifikimet dhe rregullimet e nevojshme kontabël, të cilat janë reflektuar në pasqyrat financiare të vitit 2025.

Zbatimi: Rekomandimi 15.1 **është zbatuar**

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së performances së bilancit të konsoliduar u konstatua që ka pasaktësi në paraqitjen e të ardhurave sipas llojit të tyre e cila vjen si pasojë e mos administrimit të saktë të llojeve të detyrimeve tatimore sipas llojit të tyre. Referuar akt rakordimit me thesarin për të ardhurat e vitit, u konstatua pasaktësi në pasqyrimin e taksave dhe tarifave vendore nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave. Sipas akt rakordimit me thesarin të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore janë në vlerën 466,126,380.86 lekë, ndërsa në pasqyrën e pozicionit financiar janë paraqitur në vlerën 430,951,467 lekë ose 35,174,913 lekë më pak e cila ka sjellë uljen e rezultatit të veprimtarisë së vitit ushtrimor llogarinë 85 "*Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor*" në vlerën 35,174,913 lekë. Për rrjedhojë rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor i pasqyruar në pasqyrën e konsoliduar duhet të ishte 174,509,804 lekë (1,674,716,346 +35,174,913 - 1,535,381,455).
Veprime në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 *''Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes* së përgjithshme" i ndryshuar paragrafi 37, si dhe pika 14, seksioni 3.1 paragrafi 39. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2 , faqe 43-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa që të saktësojë të ardhurat e konstatuara që kanë ndikuar në pakësimin e llogarisë 85 "*Rezultat i*

veprimtarisë së vitit ushtrimor" në vlerën 35,174,913 lekë.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezultoi se gjatë vitit 2026 janë ndërmarrë veprime për rakordimin e të dhënave financiare dhe evidentimin e saktë të të ardhurave sipas natyrës dhe periudhës së përkatëse të njohjes së tyre, me qëllim pasqyrimin korrekt të ndikimit në rezultatin e ushtrimit financiar. Si rezultat i verifikimeve të kryera, janë identifikuar dhe sistemuar rastet që kanë ndikuar në diferencën e konstatuar, duke siguruar që të ardhurat të pasqyrohen në llogaritë përkatëse kontabël dhe në pasqyrat financiare në përputhje me dokumentacionin justifikues dhe parimet e kontabilitetit publik. Për rrjedhojë, janë marrë masat e nevojshme për saktësimin e evidencave kontabël dhe paraqitjen e drejtë të rezultatit të veprimtarisë së ushtrimit financiar në pasqyrat financiare të institucionit.

Zbatimi: Rekomandimi 16.1 **është zbatuar**

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së performances financiare u konstatua që llogaria 606 "*Transferime për Buxhetet familjare e Individë"* paraqitet në bilancin e konsoliduar për vitin 2024 në vlerën 472,699,919 lekë, ku përfshihen pagesa për invalidë, pagesa paaftësie dhe pagesa të ndihmës financiare. Nga auditimi i shpenzimeve të pasqyruara në ketë llogari u konstatua që sipas akt rakordimit me thesarin kjo llogari është në vlerën 484,649,259 lekë dhe nuk përputhet me raportimin në pasqyrat e konsoliduar të performacës financiare. Për sa me sipër janë pasqyruar më pak shpenzime në pasqyrën e performacës financiare për vlerën prej 11,949,340 lekë. Kjo vlerë konstatohet mospërputhjeje në pasqyrat financiare të Drejtorisë Arsimore pasi nuk është raportuar si shpenzim nga kjo njësi shpenzuese. Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave nuk ka marrë masa për të rakorduar llogarinë kontabël të bilancit me të dhënat e regjistruara në thesar për ketë llogari.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i ndryshuar ,neni 22, pika 3, germa "dh"; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 *''Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes* së përgjithshme" i ndryshuar pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2 ,faqe 45-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa që të saktësojë mospërputhjen në shumë prej 11,949,340 lekë të llogarisë 606 "*Transferime për Buxhetet familjare e Individë"* të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar krahasuar me të dhënat e thesarit.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezultoi se diferenca e konstatuar është marrë në konsideratë gjatë hartimit të pasqyrave financiare të vitit 2025 dhe është reflektuar në evidencat financiare të këtij ushtrimi.

Zbatimi: Rekomandimi 17.1 **është zbatuar**

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduar të Bashkisë Berat u konstatua që në Pasqyrën e Flukseve monetare *"Cash Flow"* Formati nr. 3 janë pasqyruar shpenzime në total në vlerën 2,798,391,928 lekë**.** Nga auditimi i shpenzimeve buxhetore sipas akt rakordimeve me thesarin të Bashkisë Berat(qendër) dhe secilën nga njësitë e varësisë rezulton që shpenzime buxhetore të realizuara për vitin 2024 janë 2,061,653,310 lekë ose janë pasqyruar më shumë shpenzime në vlerën 736,738,618 lekë në pasqyrën e Flukseve monetare *"Cash Flow"*,

rrjedhimisht kjo vlerë është dubluar edhe në akordimet e fondeve buxhetore. Nga auditimi i pasqyrave individuale të flukseve monetare u konstatua që Bashkia Qendër Berat ka raportuar shpenzime 740,946,147 lekë më shumë në pasqyrën Flukseve monetare *"Cash Flow"* krahasuar me shpenzimet buxhetore pasi për vlerën 716,762,301 lekë e ka regjistruar si shpenzim buxhetor në ketë pasqyre dhe jo *"Lëvizje e brendshme e transferta të tjera"* për transferimin e buxhetit të njësite të varësisë. Nga auditimi i paraqitjes së shpenzimeve në pasqyrën *"Cash Flow"* Formati nr.3 me të dhënat sipas akt rakordimeve me thesarin u konstatua që Bashkia qendër Berat ka paraqitur në pasqyrën *"Cash Flow"* shpenzime për investime më shumë se thesari në shumën 28,241,596 lekë dhe në llogarinë 255 "*Huadhënie e Nën huadhënie"* shpenzime në vlerën 4,057,750 lekë më pak se thesari.

Njësia shpenzuese, Agjencia e Shërbimeve Publike ka raportuar shpenzime buxhetore më pak se thesari në pasqyrën e Flukseve monetare *"Cash Flow"* Formati nr. 3 në vlerën prej 208,166 lekë pasi transferimin e fondeve nga njësia Bashkia Qendër nuk e ka regjistruar si shpenzim buxhetor në këtë pasqyre shpenzim i cili është kryer.

Njësia shpenzuese, Drejtoria e Arsimit ka raportuar shpenzimeve buxhetore më pak se thesari në pasqyrën Flukseve monetare *"Cash Flow"* Formati nr. 3 në vlerën prej 3,174,270 lekë pasi transferimin e fondeve nga njësia Bashkia Qendër nuk e ka regjistruar si shpenzim buxhetor në ketë pasqyre pasi shpenzimi sipas situacionit të thesarit është kryer.

Njësia shpenzuese, Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit, Pyjeve, Ujerave ka raportuar shpenzimeve buxhetore më pak se thesari në pasqyrën e Flukseve monetare *"Cash Flow"* Formati nr. 3 në vlerën prej 825,096 lekë pasi transferimin e fondeve nga njësia Bashkia Qendër nuk e ka regjistruar si shpenzim buxhetor në këtë pasqyre pasi shpenzimi sipas situacionit të thesarit është kryer.

Pasqyra e Flukseve monetare *"Cash Flow"* Formati nr. 3 i pasqyrave financiare të bilancit të konsoliduar nuk paraqet një pamje të drejte të saj për vitin 2024 pasi ka dublime në raportimin e fondeve të akorduara dhe shpenzimeve të realizuara.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i ndryshuar ,neni 22, pika 3, germa "dh"; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 *''Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes* së përgjithshme" i ndryshuar pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2,faqe 46-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në bashkëpunim me njësitë e varësisë të marrin masa të saktësojnë mospërputhjet e konstatuara në pasqyrën e flukseve monetare për paraqitjen e saktë dhe të drejtë të saj, duke mënjanuar dublimet në paraqitjen fondeve të akorduara buxhetore dhe shpenzimeve buxhetore.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezultoi se gjatë rishikimit të pasqyrave financiare është konstatuar dublikimi i disa veprimeve që lidhen me paraqitjen e fondeve buxhetore dhe shpenzimeve buxhetore. Për rrjedhojë, gjatë hartimit të pasqyrave financiare të vitit 2025 është kryer sistemimi i këtyre veprimeve, duke eliminuar dublikimet e konstatuara dhe duke siguruar paraqitjen më të saktë të flukseve monetare.

Zbatimi: Rekomandimi 18.1 **është zbatuar**

B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me kontabilizimin e detyrimeve në llogarinë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* u konstatua që kjo llogari në pasqyrat financiare të bilancit të konsoliduar është paraqitur në vlerën 488,436,848 lekë. Nga verifikimi i të dhënave që disponon Sektori i Administrimit të Sistemit Elektronik të Lejeve, lidhur me debitorët e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezultoi se nuk janë kontabilizuar vlerat progresive të këtyre debitorëve në shumën 43,619,973 lekë në fund të vitit 2024. Gjithashtu, referuar raportit të mëparshëm të auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, u konstatua se nuk është kryer kontabilizimi i detyrimeve të shtatë debitorëve, subjekte që kanë lidhur kontrata me AKBN-në për marrjen me qira dhe shfrytëzimin e fondit pyjor/kullosor, në vlerën 126,595,000 lekë, në mbyllje të vitit 2024. Vlera e debitorëve në fund të vitit 2024 duhej të paraqitej në vlerën prej 658,651,821 lekë (488,436,848 + 43,619,973 + 126,595,000). Si rrjedhojë, llogaria 468 "*Debitorë të ndryshëm*" nuk pasqyron pamjen reale dhe të drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar të konsoliduar të Bashkisë Berat. Për shkak të kontabilizimit jo të plotë të debitorëve, rezultojnë të ardhura të munguara në vlerën 170,214,973 lekë (658,651,821 lekë – 488,436,848 lekë). Nga ana e Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të Bashkisë Berat rezultoi se nuk janë marrë masat e duhura për uljen e detyrimeve debitorë dhe rritjen e performancës në arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore.
Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* i ndryshuar, kreu II, neni 12, pika 3/g/gj, Rregulloren e brendshme të funksionimit të Bashkisë Berat, datë 25.02.2019, Kreu VI, neni 36, pika 2.3. (*Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2 ,faqe 21-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa të kontabilizojë në llogarinë 468 "*Debitorë të ndryshëm*" debitorët e pa pasqyruar për taksën e ndikimit në infrastrukturë për vlerën 43,619,973 lekë, si dhe debitorët që i përkasin shtatë subjekteve, në vlerën prej 126,595,000 lekë, të cilat kanë lidhur kontrata me AKBN-në për marrjen me qira për shfrytëzimin e fondit pyjor/kullosor.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezultoi se gjatë vitit 2025 janë marrë masat për evidentimin dhe pasqyrimin në kontabilitet të detyrimeve që lidhen me taksën e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 43,619,973 lekë, si dhe të detyrimeve të subjekteve që kanë lidhur kontrata me AKBN-në për marrjen me qira dhe shfrytëzimin e fondit pyjor/kullosor në vlerën 126,595,000 lekë.

Zbatimi: Rekomandimi 1.1 **është zbatuar**

1.2. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave e Bashkisë Berat të marrë masa shteruese ligjore për arkëtimin e debitorëve të prapambetur për taksat dhe tarifat vendore, të cilat rezultojnë në fund të vitit 2024 në vlerën prej 658,651,821 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Për 10 (dhjetë) debitorë të datës 31.12.2024 të gjetur nga auditimi është ndjekur arkëtimi i vlerave të debisë nga sektori i Pronave dhe Strehimit. Arkëtimet e vlerave të debisë për sa trajtuar nga gjetja e auditim, janë ndjekur nga specialisti i këtij

sektori në ditarët përkatës të të ardhurave të Bashkisë Berat, nga të cilët rezulton që 9 (nëntë) debitorë kanë likujduar totalisht detyrimin e tyre dhe për 1 (një) prej tyre ngelet pa likujduar vlera 20,032 lekë.
Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike ka ndërmarrë veprimet administrative për identifikimin dhe njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Berat të pa pajisur me NIPT sekondar. Konkretisht, subjektet përkatëse janë njoftuar zyrtarisht përmes shkresave me nr. 7029 prot. nr. 7030 prot. dhe nr. 7031.prot datë 12.12.2025 duke i'u kërkuar likuidimin e detyrimeve përkatëse. Njëkohësisht, për subjektet që nuk kanë reflektuar pas njoftimeve të kryera po ndiqen procedurat dhe masat ligjore përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të arkëtimit të plotë të vlerës së detyrimeve ndaj Bashkisë Berat. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave ka nisur zbatimin e rekomandimeve kjo e bazuar dhe në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, përkatësisht:
Janë dërguar bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare për debitorët progresiv për uljen e debisë, që fillojnë me nr.6305 deri 6435 prot., datë 25.11.2024 (gjithësej 130 subjekte), me nr.6778 deri 6916 prot., datë 11.12.2024 (gjithësej 138 subjekte). Shuma e arkëtuar nga kjo masë e marrë 6,565,550 lekë.

Zbatimi: Rekomandimi 1.2 **është në proces zbatimi**

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË TYRE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ditarit të shpenzimeve të Bashkisë qendër Berat, u konstatua që përgjatë vitit 2024 bashkia ka kryer likuidime për shpenzime gjyqësore dhe shpenzime përmbarimore me 26 urdhër shpenzime në vlerën 14,207,257 lekë të cilat janë përdorim i fondeve pa ekonomicitet 3E, në vlerën 14,207,257 lekë. Mos analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe mos nxjerrja e përgjegjësive administrative, ndikon negativisht për korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore e në shmangien e uljen e shpenzimeve financiare me kosto negative në buxhet. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 2, si dhe me Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar pika 60. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa ekonomicitet të Buxhetit të Bashkisë në vlerën 14,207,257 lekë, për shpenzime gjyqësore dhe përmbarimore, të lidhura me pagesat e kryera në zbatim të vendimeve gjyqësore për çështje të humbura nga institucioni.

Menjëherë dhe në vijimësi

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, nuk rezulton që të jetë ngritur grup pune me qëllim kryerjen e analizës për krijimin e vlerës 14,207,257 lekë, si rrjedhojë e moslikujdimit në kohë të detyrimeve të krijuara nga vendimet gjyqësore. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Zbatimi: Rekomandimi 1.1 **nuk është zbatuar**

D. MASA DISIPLINORE

D.1. Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*"; shkronjat (b, c, ç) e nenit 58 të Ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*"; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*"; nenit 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "*Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë*", kontratës individuale, si dhe shkronja (k) e nenit 64, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17/12/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i **rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Berat** të vlerësojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH–së, për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024, si dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore, si vijon:

"*Vërejtje*" për 4 (katër) punonjësit, si më poshtë:

1. Znj. R. S *në cilësinë e nëpunësit zbatues në Bashkinë Berat.*
2. Znj. K. S, *në cilësinë e nëpunësit zbatues në Agjencinë e Shërbimeve Publike.*
3. Znj. Th. H *në cilësinë e nëpunësit zbatues në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujërave, Pyjeve dhe Shërbimit Veterinar.*
4. Znj. E. M, *në cilësinë e nëpunësit zbatues në Drejtorinë e Arsimit.*
për parregullsitë dhe pasaktësitë e konstatuara në pasqyrat financiare në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i ndryshuar Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar.

***Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH*:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nuk dokumentohet vendosja e masës disiplinore për punonjësit e mësipërm.

Zbatimi: Rekomandimi D.1 **nuk është zbatuar**

E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit pjesë e shërbimit civil, për të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Berat, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:
a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.
b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.
G.4. Nga verifikimi rezultoi se: Nga komisioni disiplinor i Bashkisë Berat nuk është dhënë masë disiplinore për punonjësit me status civil dhe nuk ka njoftim në Departamentin e Administratës Publike.

Zbatimi: Rekomandimi E **nuk është zbatuar**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. E. C me detyrë Kryetar i Bashkisë Berat
2. Znj. A. T me detyrë Sekretar i Përgjithshmëm i Bashkisë Berat

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si më poshtë vijon:
-Nuk dokumentohet trajnimi i burimeve njerëzore të rekrutuar gjatë vitit 2025 mbi rregulloren e brendshme, integritetin dhe etikën.
- Nuk dokumentohet procedura e ndjekur për komunikimin dhe njohjen e stafit të Bashkisë Berat për ndryshimet ligjore të ndodhura në fusha të ndryshme.
- Nuk administrohet plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Nuk administrohen raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të kontrollit të brendshëm.
- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Ndërsa nga shoqëritë aksionare, ku bashkia është aksionere dhe nga ndërmarrjet në varësi të saj Bashkia Berat merr raportime ne lidhje me vendim-marrjen e këshillit drejtues, por mungojnë raportimet periodike për përformancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat.
- Në rregulloren e brendshme, jo për çdo strukturë të Bashkisë Berat, përcaktohet afat për raportimin ndaj eprorit, mbi realizimin e planit të punës/objektivave.
- Në rregulloren e brendshme, por edhe me urdhër të titullarit, nuk ka të përcaktuar linja komunikimi ndërmjet drejtorive/sektorëve të ndryshëm të bashkisë, konkretisht Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore me qëllim shkëmbimin e informacionit sa subjekte janë pajisur me leje ndërtimi/infrastrukture, si dhe nëse këta të fundit janë me seli kryesore në Bashkinë Berat apo duhet të pajisen me NIPT sekondar, duke vijuar me përfshirjen e tyre në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore, si dhe tarifimin e tyre nga sektori i taksave dhe tarifave).
- Në Bashkinë Berat nuk janë hartuar "Hartat e proçeseve të punës".
- Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e MFK-së, nuk është parashikuar dhe hartuar një program trajnimi, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet dhe zbatimin e kërkesave kryesore në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit përveç trajnimeve që janë organizuar nga ASPA.
-Nuk administrohet urdhri për caktimin e Koordinatorit të MFK dhe të Riskut.
-Bashkia Berat nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik".
-Nuk administrohen proçesverbalet e takimit të GMS, për të dokumentuar funksionimin e këtij grupi.
-Është krijuar regjistri i riskut, por nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut
- Nuk ka procedurë të shkruar specifike për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar nenet 18,19,20,21,22,23,24; Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike"; Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1 , faqe 15-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Bashkisë Berat, të marrë masa për rishikimin dhe përditësimin e rregullores së brendshme, me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave, përgjegjësive, linjave të komunikimit dhe afateve të raportimit për çdo strukturë/pozicion pune, si dhe për hartimin dhe miratimin e dokumentit "Harta e proceseve të punës". Gjithashtu, të hartojë dhe zbatojë një program vjetor trajnimi për stafin, me fokus në menaxhimin financiar dhe kontrollin, integritetin dhe etikën, duke siguruar dokumentimin e trajnimeve të zhvilluara dhe të procesit të njohjes së punonjësve të rinj me rregulloren e brendshme, aktet e institucionit dhe ndryshimet ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, të marrë masa për forcimin dhe formalizimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nëpërmjet hartimit, miratimit dhe monitorimit periodik të planit vjetor të veprimit, evidentimit dhe raportimit të mangësive të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe përcaktimit të masave korrigjuese. Gjithashtu, të marrë masa për caktimin me urdhër të Koordinatorit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Koordinatorit të Riskut, si dhe për hartimin dhe miratimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut.

Të formalizohen linjat e komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet drejtorive/sektorëve, veçanërisht ndërmjet Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, me qëllim evidentimin dhe përfshirjen në regjistrin e taksapaguesve të subjekteve të pajisura me leje ndërtimi/infrastrukture dhe aplikimin e detyrimeve përkatëse. Gjithashtu, të hartohet dhe miratohet një procedurë e shkruar për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Berat përgjatë vitit 2025, u konstatua se:

- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në kundërshtim me nenin 12, shkronja "b" të Ligjit nr. 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik",* i ndryshuar;
- Nuk pasqyrohet metodologjia e vlerësimit të riskut për sistemet. Konkretisht në një dokument "Excel" pasqyrohet vlerësimi i tyre sipas shkallëve të riskut "I lartë", "I mesëm" dhe "I ulët", por nuk pasqyrohet metoda e ndjekur për klasifikimin sipas shkallëve të riskut.
- Raportimi mbi aktivitetin vjetor 2025 të sektorit të auditimit të brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, nuk është sipas strukturës së përcaktuar në shkronjën "ç" të nenit 14 në Ligjin nr. 114/2015, "Për Auditin e Brendshëm Publik", i ndryshuar, pasi nuk jepet informacion për veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve;
- Drejtuesi i NJAB Berat, kryen vlerësimin e cilësisë së auditimit të kryer edhe për ato auditime, në të cilat ka qenë i angazhuar në grupin audites;

- Nuk dokumentohet plotësimin i formatit standard 1 “Pyetësor vlerësimi për mjedisin e kontrollit të brendshëm”, që shërben për hartimin e planit vjetor të auditimit të brendshëm, përcaktuar në pikën 3.2 të Manualit të Auditimit të Brendshëm;
- Nuk dokumentohet plotësimi i formatit standard 2 “Pyetësori për Planin Strategjik – Të kuptosh procedurat e Auditimit të Brendshëm”, që përdoret gjatë hartimit të planit strategjik të auditimit të brendshëm, përcaktuar në pikën 3.2 të Manualit të Auditimit të Brendshëm;
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:
- Ligjin nr. 114/2015 *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”*, i ndryshuar, neni 11, pika 2, shkronja “b”; nenin 13, shkronja “ç”; nenin 14;
- VKM-në nr. 83, datë 03.02.2016 *“Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”*, i ndryshuar, pika 3;
- Udhëzimin nr. 42, datë 27.10.2020 *“Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”*;
- Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, Kreu VI, pika 3.1.3 dhe paragrafi 6.3.*(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1 , faqe 15-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm të marrin masa për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, dokumentimin e metodologjisë së vlerësimit të riskut, raportimin e plotë të aktivitetit vjetor dhe zbatimin e kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm për vlerësimin e cilësisë, hartimin e planit vjetor dhe strategjik, si dhe plotësimin e administrimin e formateve standarde përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të hartimit të PBA-së dhe dokumentimit të hapave të ndjekura rezultoi se:
-Raporti për vlerësimin dhe parashikimin e të ardhurave afatmesme nuk është paraqitur në Këshillin Bashkiak, në kundërshtim me afatet e përcaktuar në pikën 58 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *“Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”.*
-**Tavanet Buxhetore** për PBA 2025-2027 janë paraqitur dhe miratuar me VKB nr.37, datë 29.04.2024 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 311/1 prot., datë 02.05.2024, në kundërshtim me afatet e përcaktuara në pikën 63 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *“Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”.*
-Udhëzimi i Kryetarit për përgatitjen e buxhetit afatmesëm nuk është hartuar.
- **Tavanet përfundimtare** të PBA 2025-2027 janë miratuar me VKB nr.56 datë 30.07.2024 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr.540/1 prot., datë 05.08.2024, në kundërshtim me ligjin nr.68/2017*“Për financat e vetëqeverisjes vendore”*, neni 37, pika 1
- Faza e dytë e PBA 2025-2027, kalendari i konsultimeve publike nuk është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak.
Veprime dhe mosveprime janë në mospërputhje me Udhëzimin nr.23, datë 30.12.2018 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore*” pikat 58,63, 64, 79. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 26-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masat e nevojshme që të ndjekë të gjitha fazat e planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor duke e miratuar brenda afateve ligjore.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i realizimit të shpenzimeve buxhetore të Bashkisë Berat, të financuara nga të ardhurat e veta, së bashku me transfertat e pakushtëzuara dhe specifike për vitin 2025, u konstatuan devijime midis vlerave të planifikuara dhe realizimit faktik të shpenzimeve.
Për vitin 2025, planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pakushtëzuar dhe specifiken ka vlerën 1,759,789 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 1,461,690 mijë lekë ose në masën 83%.
Për vitin 2025 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 637,974 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 532,165 mijë lekë ose në masën 83%.
Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore u konstatua se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulëta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real.
Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2025 investimet me të ardhurat e veta dhe transfertat janë planifikuar në vlerën 264,583 mijë lekë, realizuar 112,743 mijë lekë, ose në masën 42.6%
Mosrealizimi i të ardhurave, do të thotë se nga Bashkia Berat në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime reale të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" neni 39, i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*" neni 9, pika 1.3, gema "c" dhe "ç", Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*" i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, VKB përkatëse. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5 , faqe 37-45, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.
4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Bashkisë Berat, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime reale. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në datën 31.12.2024 detyrimet e prapambetura ishin në vlerën 66,204 mijë lekë, të cilat u likuiduan gjatë vitit 2025. Në të njëjtin vit u krijuan detyrime të reja, duke bërë që në datën 31.12.2025 stoku i detyrimeve të prapambetura të rezultojë në vlerën 107,274 mijë lekë, nga të cilat 15,742 mijë lekë për investime, 1,274 mijë lekë për mallra dhe shërbime, 85,550 mijë lekë për vendime gjyqësore dhe 4,706 mijë lekë për investime të financuara nga buxheti i shtetit.
Nga auditimi dhe analizimi i përbërjes së stokut të detyrimeve të prapambetura u konstatua se një pjesë e tyre paraqet problematika të dokumentacionit, kontraktore ose juridike, të cilat kushtëzojnë

mundësinë e likuidimit të menjëhershëm. Konkretisht, detyrimet për investime të viteve 2017-2019, në vlerën **15,742,863 lekë**, rezultojnë me mungesë të akteve të marrjes në dorëzim të objekteve, ndërsa detyrimi në vlerën **987,350 lekë**, për blerje ushqimesh për kopshte dhe çerdhe, është objekt i procesit gjyqësor. Gjithashtu, për detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore me vlera të konsiderueshme, konstatohet se likuidimi është kryer pjesërisht dhe është planifikuar i shtrirë në disa vite buxhetore.
Në këto kushte, stoku i detyrimeve të prapambetura përfshin detyrime me natyrë dhe status të ndryshëm, ku për një pjesë të tyre mundësia e likuidimit kushtëzohet nga zgjidhja e problematikave të dokumentacionit, kontraktore dhe juridike, ndërsa për pjesën tjetër nuk rezultojnë pengesa të kësaj natyre për vijimin e shlyerjes së tyre.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 65; Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pikat 153-162; si dhe UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", pikat 82-91. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 37-45, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrin masa për trajtimin e stokut të detyrimeve të prapambetura sipas natyrës dhe statusit të tyre. Për detyrimet që paraqesin mangësi dokumentacioni, problematika kontraktore ose juridike, të merren masa për zgjidhjen e problematikave që pengojnë likuidimin dhe, pas plotësimit të kushteve ligjore, të procedohet me shlyerjen e tyre. Për detyrimet e tjera, për të cilat nuk rezultojnë pengesa për likuidim, të vijojë shlyerja e tyre me prioritet, në përputhje me planifikimin buxhetor dhe legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Berat për vitin 2025 rezultoi se llogaria 4342 "*Të tjera operacione me shtetin*" është paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar në vlerën 92,807,849 lekë. Kjo vlerë përputhet me shumën e paraqitur në llogarinë 7206 "*Financim i pritshëm nga buxheti*" në Pasqyrën e Performancës Financiare.
Nga analiza e gjendjes së llogarive të klasës 4, sipas të dhënave të pasqyrave financiare, rezultoi se detyrimet dhe të drejtat e evidentuara në këto llogari paraqiten si më poshtë:

- *Llogaritë 401–408 "Furnitorë dhe llogari të lidhura me to": 4,526,552 lekë;*
- *Llogaria 421 "Detyrime ndaj personelit": 47,297,760 lekë;*
- *Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim/taksa": 4,239,213 lekë;*
- *Llogaria 435 "Sigurime shoqërore": 14,275,015 lekë;*
- *Llogaria 436 "Sigurime shëndetësore": 1,964,925 lekë;*
- *Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm": 127,779,017 lekë.*

Nga rakordimi dhe analiza e të dhënave të mësipërme me informacionin e paraqitur në tabelën PF23 "Përmbledhëse e llogarisë 4342 *"Të tjera operacione me shtetin"*, rezultoi se llogaria 4342 "*Të tjera operacione me shtetin (të drejta)*" duhej të paraqitej në vlerën 200,195,835 lekë, si përfaqësuese e shumave të financimit të pritshëm nga buxheti për shpenzimet e kryera dhe të financueshme/rimbursueshme nga shteti. Në fakt, në pasqyrat financiare, kjo llogari është paraqitur në vlerën 92,807,849 lekë. Për rrjedhojë, gjendja e llogarisë 4342 "*Të tjera operacione me shtetin (të drejta)*" rezultoi e nënvlerësuar me 107,387,986 lekë. Si rezultat, paraqitja e llogarisë 4342 në pasqyrat financiare të vitit 2025 nuk pasqyron vlerën e plotë të të drejtave që njësia e qeverisjes vendore ka ndaj buxhetit të shtetit, duke ndikuar në paraqitjen e drejtë të pozicionit financiar të Bashkisë Berat, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022

*"*Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme". (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 46-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të kryejë sistemimet kontabël të llogarisë 4342 *"Të tjera operacione me shtetin"* dhe llogarinë 7206 *"Financim i pritshëm nga buxheti"* për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 210 "*Toka, troje terrene",* u konstatua se nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave nuk janë hedhur në kartelat e kontabilitetit;

a) Trojet nën objekt, të objekteve si godina e Bashkisë dhe trualli përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, dhe të zyrave në Njësive Administrative, etj., sipas regjistrit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 "*Ndërtime e konstruksione*".

b) trualli i godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë,

c) trojet të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë, si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhej bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse.

Nga auditimi mbi saktësinë e Llogarisë 210 "*Toka, troje terrene*", rezultoi se kjo llogari nuk paraqet një pamje të drejtë për pasqyrat financiare të vitit 2025, pasi kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale në llogarinë 210 "*Toka, troje terrene*", si dhe paraqitja e gjendjes së kësaj llogarie në Pasqyrat Financiare rezultojnë të paplota, për shkak të mungesës së analizave shoqëruese dhe detajuese.

Mungesa e analizimit të kësaj llogarie ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

Këto veprime janë në kundërshtim me; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar, Kreu III, pika 30.*(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.3, faqe 46-74, të Raportit të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat në bashkëpunim me Drejtorinë e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit, Shërbimeve dhe Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të ngrenë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin dhe vlerësimin e pronave të Bashkisë Berat të kaluara me VKM për llogarinë 210 "*Toka, troje terrene*". Gjithashtu nga ana e Drejtorisë Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të merren masa për kontabilizimin e saktë të kësaj llogarie.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur u konstatua se llogaria. 211 "*Pyje, kullota, plantacione*", është kontabilizuar në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 6,800,972 lekë.

Bashkia Berat nuk ka bërë vlerësimin e pyjeve dhe kullotave të transferuara, për rrjedhojë dhe në kontabilitet nuk ka të pasqyruar vlerën e pyjeve dhe kullotave të Bashkisë Berat, të transferuara me VKM nr. 433, datë 08.06.2016, e ndryshuar, pika 6, shtojca me nr.4, e cila përmban, listën e

inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Berat, me numër rendor nga 1(një) deri 1,149 (një mijë e njëqind e dyzet e nëntë).
Për këto sipërfaqe nuk është bërë verifikimi fizik dhe vlerësimi i tyre, me qëllim përcaktimin e saktë të vlerës kontabël të llogarisë 211 "*Pyje, kullota, plantacione*".
Gjithashtu, për këto llogari, në Bashkinë Berat mungon një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, periudhat e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj.
Sa më sipër llogaria 211 "*Pyje Plantacione",* nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2025.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.139/2015*"Për Vetëqeverisjen Vendore"* i ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 1.2 *"Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë";* Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",* i ndryshuar, pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",* i ndryshuar Kap III, pika 30,. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 46-74, të Projekt Raportit të Auditimit).*
8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin dhe vlerësimin e pronave të Bashkisë Berat për llogarinë 211 "*Pyje Plantacione*" në lidhje me gjendjen fizike për hartimin e regjistrit fizik të aktiveve që Bashkia zotëron.

Menjëherë dhe në vijimësi.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të Bashkisë Berat llogaria 466 *"Kreditorë për mjete në ruajtje"* në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerë 104,396 mijë lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Në këtë llogari janë kontabilizuar ngurtësime me vlerë 48,573 mijë lekë, për të cilat ka kaluar afati i garancisë.
Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, si dhe nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 48,573 mijë lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 46-74 të Projekt Raportit të Auditimit).*
9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa për verifikimin e garancive të kontabilizuara në llogarinë 466 *"Kreditorë për mjete në ruajtje"* , dhe të zhbllokojë garancitë për të cilat nuk ka pretendime për cilësinë e investimit.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*", në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2025 paraqitet në vlerën 107,274 mijë lekë.
Referuar udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018, "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*", i ndryshuar , llogaria

486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*" përdoret vetëm nga degët e thesarit për të evidentuar gjatë vitit detyrimet dhe monitorimin e situatës financiare, ku në fund të vitit fiskal kjo llogari nuk paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar.
Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018, "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*", i ndryshuar me Udhëtimin e MFE nr. 5 Kreu III, pika 3.1, paragrafi 15. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 46-74 të Raportit të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa të mos kryejë kontabilizimin e llogarisë 486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*", në pasqyrën e pozicionit financiar. Detyrimet e prapambetura të kontabilizohen në llogarinë 4342 "Operacione me shtetin" me kundëparti llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm"

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi se:
-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **22 (njëzet e dy)** masa organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, 7 (shtatë) janë zbatuar, 11 (njëmbëdhjetë) janë në proces zbatimi, 2 (dy) është zbatuar pjesërisht, 2 (dy) pa zbatuar. Nga rekomandimet e pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht **1 (një)** rekomandim do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.
-Për shpërblimin e dëmit janë lënë **4 (katër) rekomandime** për 4 subjekte në vlerën 3,894,590 lekë dhe janë pranuar plotësisht, të cilat nuk janë zbatuar.
-Për elimimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike është lënë 2 **(dy) rekomandime** nga të cilat 1 (një) është në proces zbatimi dhe 1 (një) pa zbatuar. Rekomandimi i pa zbatuar do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.
-Për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia janë lënë **5 (pesë) rekomandime,** të cilat janë 2 (dy) janë zbatuar pjesërisht, 1 (një) në proces zbatimi dhe 2 (dy) masa pa zbatuar. Nga rekomandimet e pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht **1 (një)** rekomandim do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.
Nisur nga sa më sipër, *veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 15, "Të drejtat e KLSH" të ligjit Nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe (74-125) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandim: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit*", për përmirësimin e gjendjes ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

Menjëherë

A. MASA ORGANIZATIVE

6.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat, të marrë masa për ngritjen e një komisioni, me qëllim verifikimin e taksave dhe tarifave të vjela nga agjentët tatimorë, ku në rast se do të evidentohen diferenca të pa mbledhura për taksat dhe tarifat vendore të cilat gjenerohen nëpërmjet agjentëve tatimorë (të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj), të fillojë procedurat për gjobitjen e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të marrë masa të menjëhershme për kryerjen e inspektimeve në terren në lidhje me statusin e subjekteve që kanë aplikuar për çregjistrim në QKB, për

rastet që konstatohet se këto subjekte ushtrojnë aktivitet t'u përllogariten taksat dhe tarifat vendore përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e B/OE të cilët nuk plotësojnë kriteret kualifikuese të DST-ve.

Menjëherë dhe në vijimësi

B .MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Berat në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancia e punimeve të dëmit ekonomik në vlerën **2,473,089 lekë pa TVSH,** përfituar padrejtësisht nga kontraktori "B" SHPK & OE "L" SHPK & OE "A" SHPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara në volumet e situacionuara dhe jo në përputhje me specifikimet teknike.

Menjëherë

2.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Berat në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancia e punimeve të dëmit ekonomik në vlerën **202,437.74 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga kontraktori "L" SHPK & "S" SHPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara në volumet e situacionuara dhe jo në përputhje me specifikimet teknike.

Menjëherë

3.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Berat në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancia e punimeve të dëmit ekonomik në vlerën **74,840 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga kontraktori, OE "K" SHPK & "C M" SHPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara në volumet e situacionuara.

Menjëherë

4.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Berat në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancia e punimeve të vlerës **1,144,224 lekë pa TVSH lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga shoqëria sipërmarrëse "R" SHPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara në volumet e situacionuara.

Menjëherë

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA

1.1. Rekomandim: Sektori i Pronave dhe Strehimit në bashkëpunim me Sektorin Juridik Bashkia Berat të marrin masa të menjëhershme dhe të ndjekin të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës **682,273 lekë,** si dhe të bëhet menjëherë përditësimi i kontratave të qirave për vitet në vazhdim.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE (sipas vendimit nr.22, datë 12.02.2026 përcjell me shkresën nr.975).

D.1. Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*"; shkronjat (b, c, ç) e nenit 58 të Ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*"; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*"; nenit 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "*Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë*", kontratës individuale, si dhe shkronja (k) e nenit 64, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17/12/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i **rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Berat** të vlerësojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH–së, për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024, si dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore, si vijon:

"*Vërejtje*" për 4 (katër) punonjësit, si më poshtë:

1. Znj. R, *në cilësinë e nëpunësit zbatues në Bashkinë Berat.*

2. Znj. K. S, *në cilësinë e nëpunësit zbatues në Agjencinë e Shërbimeve Publike.*

3. Znj. Th. H, *në cilësinë e nëpunësit zbatues në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujërave, Pyjeve dhe Shërbimit Veterinar.*

4. Znj. E. M, *në cilësinë e nëpunësit zbatues në Drejtorinë e Arsimit*
për parregullsitë dhe pasaktësitë e konstatuara në pasqyrat financiare në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i ndryshuar Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar

B. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADNHNISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga Bashkia Berat nuk janë ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara (borxhi) dhe për të gjithë subjektet, pasi nga të dhënave, rezultoi se :
a) Deri në datën 31.12.2024 nga mos pagesa e detyrimeve tatimore janë debitorë abonentët familjarë në vlerën 164,793,256 lekë. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025 janë paguar nga debitorët familjarë vlera 18,116,824 lekë dhe është krijuar borxh i ri në vlerën 27,638,713 lekë për abonentët familjarë. Borxhi tatimor progresiv për abonentë familjarë në datën 31.12.2025, është në vlerën **175,315,145 lekë**
b) Në lidhje me detyrimet e tatimpaguesve biznes që kanë ndaj Bashkisë Berat u konstatua se deri në datën 31.12.2024, borxhi tatimor është në vlerën 151,711,887 lekë. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025, janë paguar nga debitorët biznes detyrime të prapambetura në vlerën 6,565,550 lekë dhe është krijuar borxhi tatimor në vlerën 20,086,751 mijë lekë për abonentët e biznesit. Borxhi tatimor progresiv për abonentët privatë në datën 31.12.2025, është në vlerën **165,233,088 lekë**.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, Kreu XI nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9 ", pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, "*Për financat e qeverisjes vendore*", neni 35. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, në faqet 37-45 të Raportit të Auditimit).*
1.1. Rekomandimi: Bashkia Berat, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore deri më datën 31.12.2025 nga subjektet e biznesit debitorë në vlerën 165,233,088 lekë, nga debitorët familjarë në vlerën 175,315,146 lekë. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve. Gjithashtu Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Berat, për mos kalimin e subjekteve debitore me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

Menjëherë dhe në vijimësi.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të administruar nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve lidhur me legalizimet e ndërtimeve pa leje, si dhe listat për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezultoi se Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Dega Berat, ka përcjellë zyrtarisht listat e qytetarëve të pajisur me leje legalizimi. Detyrimi për këtë taksë deri në datën 31.12.2025 i përket 180 personave dhe është në vlerën 5,883,010 lekë.

Nga dokumentacioni i paraqitur u konstatua se nga Bashkia Berat për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitore, si dhe nuk u evidentuan raste që institucioni të jetë drejtuar ASHK-së Dega Berat, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen e veprimeve hipotekare. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 860, datë 10.12.2014, "*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*" i ndryshuar, pika 5.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 37-45, të Raportit të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Bashkia Berat, Drejtoria e Planifikimit Urban në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 180 persona me vlerë **5,883,010 lekë.**

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të administruar nga Bashkia Berat lidhur me pajisjen me autorizim/licencë të subjekteve që ushtrojnë veprimtari tregtare në fushën e hidrokarbureve dhe derivateve të tyre, u konstatuan mangësi në administrimin, evidentimin dhe përditësimin e të dhënave të subjekteve, si dhe në ndjekjen e detyrimeve financiare dhe të statusit të tyre të licencimit/autorizimit.

Nga verifikimi rezultoi se në territorin e Bashkisë Berat ushtrojnë veprimtari tregtare në fushën e hidrokarbureve **13 subjekte**, nga të cilat: **11 subjekte** rezultojnë të pajisura me licencë/autorizim; nga këto, **1 subjekt** ka detyrime të papaguara ndaj Bashkisë në vlerën **400,000 lekë (**B.Oil,); **1 subjekt** rezulton të ushtrojë veprimtari pa qenë i pajisur me licencën/autorizimin përkatës; **1 subjekt** rezulton në proces për pajisjen me autorizim.

Sa më sipër evidenton mangësi në procesin e administrimit dhe kontrollit të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në këtë sektor, veçanërisht në drejtim të verifikimit të vlefshmërisë së autorizimeve/licencave, ndjekjes së detyrimeve financiare dhe marrjes së masave administrative për subjektet që nuk përmbushin kërkesat ligjore, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, neni 35, si dhe me VKM nr. 170, datë 25.04.2002, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, Kapitullit II dhe Kapitullit III, pika 4.

Në këto kushte, Bashkia Berat nuk ka siguruar në mënyrë të plotë një administrim të rregullt dhe të përditësuar të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e hidrokarbureve, si dhe ndjekjen efektive të detyrimeve financiare dhe të respektimit të kushteve të licencimit/autorizimit.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi pajisjen me autorizim tregtimi për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, konstatohet se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve. U konstatua se në Bashkinë Berat, figurojnë 13 subjekte që ushtrojnë veprimtari tregtare në fushën e hidrokarbureve. Nga subjektet e hidrokarbureve 11 subjekte janë të pajisura me licencë, nga të cilat 1 subjekt ka detyrim të papaguar në vlerën 400,000 lekë, 1 subjekt i pa licencuar si dhe 1 subjekt në proces për pajisjen me autorizim. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar neni 35* si dhe VKM nr. 170, datë 25.04.2002 *"Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, në faqet 37-45 të Raportit të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave Transportit dhe Shërbimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave, të ndjekë të gjitha rrugët ligjore për pajisjen me autorizim të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, si dhe arkëtimin e tarifës për këtë licencë në vlerën **400,000 lekë për 1 subjekt,** konkretisht:

1- B. Oil, të arkëtohet vlera 400,000 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.2. Rekomandimi: Bashkia Berat, Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave Transportit dhe Shërbimeve në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrë masa të menjëhershme për pezullimin e subjektit, që ushtron aktivitet për tregtimin karburanti pa u pajisur me autorizim konkretisht.
1-A me NIPT J68.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2025, Bashkia Berat ka shpenzuar vlerën 44,038 mijë lekë nga të cilat për vendim dëmshpërblim page janë 9(nëntë) vendime me vlerë 10,933 mijë dhe vendime gjyqësore të tjera janë 4 (katër) vendime me vlerë 33,105 mijë lekë.
Vlera totale 44,038 mijë lekë e shpenzuar për periudhën 01.01.2025-31.12.2025 nga Bashkia Berat, për zbatimin e vendimeve gjyqësore, konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet**.**
Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprime këto në kundërshtim me UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, pika 60*. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 26-36 të Raportit të Auditimit).*
4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Berat të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen e çështjeve gjyqësore, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT